



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
“UJËSJELLËS KANALIZIME DURRES SH.A.”

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI
MBI PËRPUTHSHMËRINË & RREGULLSHMËRINË
NË
UJËSJELLËS KANALIZIME DURRES SH.A.

Prill 2023

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3-18
1.	Përshkrim i shkurtër i Raportit Përfundimtar të Auditimit	3
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	3
3.	Konkluzion i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	16
II.	HYRJA	18-20
1.	Titulli.....	18
2.	Marrësi.....	18
3.	Objektivat dhe qëllimi.....	18
4.	Identifikimi i çështjes.....	18
5.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.....	18
6.	Përgjegjësitë e audituesve.....	19
7.	Kriteret e vlerësimit.....	19
8.	Standardet e auditimit.....	19
9.	Metoda e auditimit.....	20
10.	Dokumentimi i auditimit.....	20
III.	PËRSHRIMI I AUDITIMIT.....	20-89
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.....	20
2.	Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve të auditimit.....	20
2.1	Pika 1 Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.....	21
2.2	Pika 2 Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese (Këshilli Administrimit dhe Administratori), vendimet e marra dhe zbatimi i tyre.	25
2.3	Pika 3 Mbi hartimin, miratimin dhe realizimin e programit ekonomiko-financiar	28
2.4	Pika 4 Mbi zbatimin e strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore. Zbatimi i ligjshmërisë gjatë procesit të rekrutimit dhe largimit të punonjësve nga puna	31
2.5	Pika 5 Mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë, bankë dhe blerjet me vlera të vogla (shpenzimet administrative, për automjetet, udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit, sponsorizimet, etj.)	32
2.6	Pika 6 Mbajtja e evidencës kontabile në qendër dhe në njësitë e vartësisë, respektimi i afateve për nxjerrjen dhe miratimin e bilancit nga organet drejtuese të shoqërisë, si dhe dërgimi dhe miratimi i tij në organet e vartësisë, analiza e debitorëve, kreditorëve, derdhja e detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore, etj. ndaj buxhetit të shtetit	38
2.7	Pika 7 Mbi zbatimin e ligjshmërisë në prokurimet e fondeve publike dhe ankandet, lidhjen e zbatimin e kontratave	44
IV.	GJETJET DHE REKOMANDIMET.....	89-131
	Masa Organizative	89
	Masa Shpërblim Dëmi	100
	Masa për Eliminimin e Efekteve Negative	103
V.	Lista e Dokumentacionit.....	106
VI.	Aneke.....	107-108

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Përshkrim i shkurtër i Raportit Përfundimtar të Auditimit

Mbështetur në Ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, në zbatim të projektit dhe Programit të Auditimit të miratuar nga Kryetari i KLSH-së nr.825/1 Prot., datë 03.10.2022, i ndryshuar, për periudhën nga data 01.04.2018 deri më datë 31.10.2022 si dhe zhvillimin e auditimit “Mbi Përputhshmërinë dhe Rregullshmërinë” nga data 03.10.2022 deri më datë 13.01.2023 në subjektin Ujësjetllës Kanalizime Durrës sh.a. (Këtu e tutje UK Durrës sh.a.), nga Grupi i Auditimit me përbërje:

- E.K., Përgjegjës grupi
- J. H., auditues
- K. G., auditues
- E. S., auditues

Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

Nr.	Përmbledhje	Ref.	Rëndësia	Rekomandimi
1	Nga Ujësjetllës Kanalizime Durrës sh.a. nuk është respektuar afati ligjor prej 6 muajsh nga data e njoftimit të Raportit të Auditimit, në lidhje me raportimin në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna.	2.1	E Mesme	UK Durrës sh.a., të marrë masa për njoftimin e KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, me qëllim përmirësimin e funksionimit të shoqërisë.
2	Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit për auditimin e ushtruar në Ujësjetllës Kanalizime Sh.a Durrës administruar në KLSH me nr. 520/56 prot., datë 04.12.2020, janë rekomanduar gjithsej: - 12 masa organizative, nga të cilat janë zbatuar 8 masa, , në proces zbatimi 3 masa dhe të pa zbatuara 1 masë. - 12 masa shpërblim dëmi, nga të cilat janë zbatuar 5 masa, , në proces zbatimi 7 masa. - 9 masa për eliminimin e efekteve negative, nga të cilat janë në proces zbatimi 9 masa. - 3 masa për procedura të realizuara në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik, nga të cilat janë në proces zbatimi 3 masa. 19 masa disiplinore, nga të cilat janë zbatuar 19 masa.	2.1	E Lartë	UK Durrës sh.a., të marrë masa për realizimin e plotë të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, me synim realizimin e objektivave dhe në përmbushjen e misionit të shoqërisë.
3	Në vitin 2021 uji pa të ardhura, i matur, rezulton në masën prej 35,145,971 m ³ , me një rritje prej 47.6 %, ose 11,336,320 m ³ më shumë se në vitin 2018. Nga bilanci, humbja e ujit është 73.9 % në vitet 2018 dhe 2019, 79.5 % në vitin 2020, dhe 79.2 % në vitin 2021. Në vitin 2021, sasia prej 44,386,103 m ³ ujë hyn në sistemin e UK Durrës SH.A. dhe 79.2 % e saj ose 35,145,971 m ³ ujë nuk gjeneron të ardhura për shoqërinë. Nga ana e shoqërisë është vlerësuar se 33.6 % e sasisë së ujit që hyn në sistem, ose 14,931,439 m ³ ujë/vit humbet nga lidhjet e paligjshme në rrjetin e transmetimit dhe të shpërndarjes. Gjithashtu, 35.8 % e sasisë së ujit që hyn në sistem ose 15,926,869 m ³ ujë/vit, 4humbet nga rrjedhjet në rrjetin e transmetimit dhe të shpërndarjes. Rritja vjetore e të ardhurave (faturimi total), krahasuar me një vit më parë, rezulton përkatësisht 2.3 % në vitin 2019, -0.4 % në vitin 2020, dhe 6.5 % në vitin 2021. Norma e arkëtimit është llogaritur sipas kategorisë së arkëtimit korrent dhe të prapambetur. Gjithashtu, e para ka një ulje nga 79.8 % në vitin 2018 në 54 % në vitin 2021, dhe arkëtimi i prapambetur është rritur nga 17 % në vitin 2018 në 37 % në vitin 2021. Realizimi i shpenzimeve dhe investimeve është i paqëndrueshëm,	2.3	E Lartë	Administratori i shoqërisë UK Durrës sh.a. të marrë të gjitha masat për të ngritur një sistem eficient të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar, krijimin e regjistrit të riskut dhe funksionimin e grupit të menaxhimit strategjik. Hartuesit e programit ekonomiko-financiar duhet të mbështeten në analiza të plota me bazë risku si edhe të orientuar nga prioritetet të përcaktuara më parë, me qëllim evidentimin dhe korrigjimin e shkaqeve që ndikojnë në mosrealizimin e objektivave të shoqërisë.

	përkatësisht 37 % në vitin 2018, 55 % në vitin 2019, 39 % në vitin 2020 dhe 156 % në vitin 2021. Sa më sipër, kjo ndodh se parashikimet e investimeve apo nevojat për shpenzime kryhen pa studime konkrete dhe analiza të plota me bazë risku. Kosto direkte e operimit për periudhën e auditimit ka rezultuar përkatësisht, 1,100,333,529 lekë në vitin 2018, 1,356,627,636 lekë në vitin 2019, 1,358,556,457 lekë në vitin 2020, dhe 1,596,645,895 lekë në vitin 2021. Në periudhën e auditimit, kosto mesatare direkte e operimit për njësi, për ujin e prodhuar është 35.76 lekë/m³ dhe për ujin e shitur 154.22 leke/ m³. Diferenca ndërmjet koston së shitjes dhe koston së prodhimit përbën koston shtesë joefektive në vlerën prej -118.46 leke/ m³, nga ku 20 % e saj ose 24 leke/ m³, përbën humbjen teknike të pranuar. Përsa më sipër, kjo situatë vjen kryesisht ngaqë shoqëria nuk ka organizuar dhe planifikuar mjaftueshëm burimet e saj, duke lejuar një rritje të papranueshme të ujit pa të ardhura. Planifikimi për buxhetin e shoqërisë është kryer mbi bazën e nevojave të krahasuara me një vit më parë, mbi bazën e kërkesave të veçuara, pa analiza të plota të riskut dhe të pambështetura në prioritetet konkrete dhe politika të qarta komerciale. Metodologjia e sipërcituar do të ishte efikase në rastin e humbjeve normale. Nga ana tjetër, shoqëria nuk ka regjistër risku, gjithashtu nuk është caktuar dhe nuk funksionon koordinatori i riskut dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik. Sa më sipër, shoqëria ka pësuar një humbje financiare, përkatësisht për vitin 2019 në vlerën -201,045,754 lekë, për vitin 2020 në vlerën prej -216,213,668, për vitin 2021 në vlerën prej -370,713,260 lekë, si edhe për 9/Mujorin e vitit 2022 në vlerën prej -498,412,304 lekë.			
4	Në 8 raste evidentohet copëzim fondesh, nga ku shoqëria nuk ka marrë parasysh grupin e mallrave apo shërbimeve të ngjashme, të cilat zakonisht duhet të prokurohen njëherësh, me qëllim parandalimin e shmangies të procedurave konkurruese të prokurimeve. Gjithashtu, shoqëria nuk planifikon natyrën, sasitë dhe llojet e kontratave, që do të prokurohen me këtë procedurë prokurimi, por brenda shumës totale të parashikuar realizon procedurat e prokurimit në vlerë të vogël sipas nevojës. Në vitin 2019 është kryer shërbimi i ngjashëm riparim pjesë motorike dhe xhenerike të mjeteve me targa DR B, sipas faturës nr.10, datë 23.07.2019 në vlerën prej 450,000 lekë pa TVSH, si edhe A, sipas faturës nr.110 datë 25.02.2019 në vlerën prej 777,000 lekë pa TVSH me të njëjtin operator ekonomik A.G.. Të dy procedurat së bashku rezultojnë në vlerën 1,227,000 lekë, që tejkalojnë me 227,000 lekë pragun e procedurës së prokurimit në vlerë të vogël. Në vitin 2021 është kryer shërbimi i ngjashëm riparim pjesë motorike dhe xhenerike të mjeteve kamion HOËO në vlerën prej 796,200 lekë, karroofiçina në vlerën prej 980,000 lekë, Ford Ranger në vlerën prej 469,333 lekë. Procedurat e sipërcituara së bashku rezultojnë në vlerën 2,245,533 lekë, që tejkalojnë me 1,245,533 lekë pragun e procedurës së prokurimit në vlerë të vogël. Në vitin 2022 është kryer shërbimi i ngjashëm riparim pjesë motorike dhe xhenerike mjeteve Riparim mjeti Hyunday (Gallopër), targe DR.... në vlerën prej 301,666.67 lekë, Ford Ranger me targe AA në vlerën prej 984,533, Ford Ranger AA.... në vlerën prej 690,000 lekë. Procedurat e sipërcituara së bashku rezultojnë në vlerën 1,976,199.67 lekë, që tejkalojnë me 976,199.87 lekë pragun e procedurës së prokurimit në vlerë të vogël.	2.5	E Lartë	Administratori i shoqërisë ose personi i autorizuar dhe personi përgjegjës i prokurimeve të marrin të gjitha masat që në hartimin e regjistrit të prokurimeve të parashikohen të gjitha procedurat e blerjes së mallrave, punëve dhe shërbimeve, që do të prokurohen në vlerë të vogël, me qëllim që të shmangë përdorimin e paplanifikuar dhe të parregulluar të fondeve publike

	Mjetet motorike të sipërcituara me shërbime të ngjashme, të cilat duhet të jenë të planifikueshme në mënyrë periodike nga specialistët e shërbimeve. nuk janë pjesë e linjave teknologjike dhe objekt i avarive në proceset kryesore, të cilat kërkojnë kryerjen e detyruar të riparimit, për të eliminuar defektin dhe rivënien në punë të procesit (psh. stacionet e pompimit, linjat e transmetimit, depot e ujit etj). Sa më sipër, prokurimet e sipërcituara janë kurdoherë të planifikueshme.			
5	Në 6 raste, nga dosjet e kontrolluara, operatorët ekonomikë fitues rezultojnë me 2 oferta të ndryshme për të njëjtën objekt prokurimi, njëra ofertë e paraqitur gjatë verifikimit në treg për vlerësimin e fondit limit, dhe tjetra në vlerë më të ulët, gjatë zhvillimit të procedurës elektronike të prokurimit. Në vitin 2018_Procedura e prokurimit me objekt <i>“Riparim i pompës kineze H 250 m dhe Q 100 lit/s ”</i> me numrin e referencës REF-52375-08-07-2018. Në njoftimin e llogaritjes së fondit limit nr.2397/2 prot, datë 07.08.2018, është administruar oferta e F.A. në shumën prej 647,000 lekë. Në të njëjtën kohë, sipas procesverbalit të komisionit të vlerësimit nr.2397/7 prot., datë 09.08.18, oferta e këtij operatori është konstatuar e ndryshuar dhe në vlerën më të ulët prej 590,000 lekë për të njëjtin objekt prokurimi. Procedura e prokurimit me objekt <i>“Shërbim riparim pompe centrifugale për stacionin Fushë Kuqe”</i> dhe numrin e referencës REF-78107-07-05-2018. Në njoftimin e llogaritjes së fondit limit nr.2201/2 prot., datë 05.07.2018 është prezantuar oferta e F.A. në shumën prej 760,000 lekë, e administruar nga komisioni i prokurimit. Në të njëjtën kohë, sipas procesverbalit të vlerësimit nr.2201/9 prot, datë 11.07.2018 oferta e këtij operatori është konstatuar e ndryshuar dhe në vlerën më të ulët prej 586,000 lekë. Në vitin 2019_Procedura e prokurimit me objekt <i>“Furnizim vendosje materiale elektrike të tensionit të mesëm (TM) në Fushë Kuqe”</i> me numrin e referencës REF-35875-09-13-2019. Në njoftimin e llogaritjes së fondit limit nr.2609/2 datë 13.09.2019, drejtuar Komisionit të Prokurimit në Vlerë të Vogël, është administruar si një nga 3 ofertat ajo e operatorit ekonomik H. SHPK në shumën prej 730,500 lekë. Në të njëjtën kohë, në procesverbalin e vlerësimit të komisionit të prokurimit nr.2609/6 prot.,datë 17.09.2019 oferta e H. SHPK sipas SPE është konstatuar në vlerën më të ulët prej 619,000 lekë. Procedura e prokurimit me objekt <i>“Riparim Fadrome”</i> e mjetit me targë AA ... modeli JCB 3CX, është kryer me Urdhrin e Prokurimit Nr.94/12 datë 13.02.2019. Në njoftimin e llogaritjes së fondit limit nr.94/3 datë 04.02.2019, drejtuar Komisionit të Prokurimit në Vlerë të Vogël, është administruar oferta me nr.267 prot, datë 04.02.2019 e operatorit ekonomik A.G. në shumën prej 783,100 lekë, si një nga ofertat e mara gjatë studimit të tregut. Në të njëjtën kohë, në procesverbalin e vlerësimit të komisionit të prokurimit nr.94/14 prot, datë 15.02.2019 oferta e këtij operatori është konstatuar e ndryshuar në një vlerë më të ulët prej 777,000 lekë. Në vitin 2021 Procedura e prokurimit me objekt <i>“Riparim mjeti Renault”</i> me numrin e referencës REF-90399-03-18-2021. Në njoftimin e llogaritjes së fondit limit nr.1256/5 datë 18.03.2019, drejtuar Komisionit të Prokurimit në Vlerë të Vogël, është administruar oferta me nr.1256/3 prot, datë 17.03.2021 e operatorit ekonomik F.A. shumën prej 760,000 lekë, si një nga ofertat e mara gjatë studimit të tregut. Në të njëjtën kohë, në procesverbalin e vlerësimit të komisionit të prokurimit nr.1256/9 prot, datë 19.03.2021 oferta e këtij operatori është konstatuar e ndryshuar në një vlerë më të ulët prej 710,000 lekë. Procedura e prokurimit me objekt <i>“Blerje materiale për elektropompën zhytëse Sulzer 15 kË”</i> me numrin e referencës REF-16662-12-29-2021.	2.5	E Lartë	Administratori i shoqërisë të analizojë situatën e krijuar dhe të përcaktojë shkallën e përgjegjësisë të personave përgjegjës.

	Në njoftimin e llogaritjes së fondit limit nr.6789/6 datë 23.12.2021, drejtuar Komisionit të Prokurimit në Vlerë të Vogël, është administruar oferta me nr.6789/3 prot, datë 23.12.2021 e operatorit ekonomik F.A. shumën prej 480,000 lekë, si një nga ofertat e mara gjatë studimit të tregut. Në të njëjtën kohë, në procesverbalin e vlerësimit të komisionit të prokurimit nr.6789/10 prot, datë 30.12.2021 oferta e këtij operatori është konstatuar e ndryshuar në një vlerë më të ulët prej 465,000 lekë pa TVSH. Në zbatim të pikave 1 dhe 3 të Udhëzimit Nr.11 datë 30.05.2018, të Agjencisë Prokurimit Publik, komisioni i prokurimit ka detyrimin të krahasojë ofertat e operatorëve ekonomik me fondin limit të përcaktuar më parë nga autoriteti kontraktor, me qëllim që oferta e OE të jetë sa më reale. Komisioni i prokurimit në vlerë të vogël është vënë në dijeni jo vetëm për fondin limit të objektit të prokurimit, por edhe të ofertave të administruara gjatë studimit të tregut, që rezultojnë të jenë në të njëjtën kohë edhe me ofertat e prezantuara në sistemin elektronik.			
6	Për katër vitet ushtrimore 2018, 2019, 2020 dhe 2021 bilancet nuk janë dorëzuar sipas legjislacionit në fuqi si dhe shtyrjeve me anë të akteve normative. Në analizimin e zërit Mjete Monetare vihet re që nga viti 2018 deri në vitin 2021 kemi një rënie në vlerë e cila pasqyrohet si mos arkëtim si më poshtë, duke mos dhënë arsyt përkatëse se përse vjen kjo rënie e mos arkëtimeve. Të ardhurat kryesore në bankë janë depozitimet e arkës gjatë mbylljeve ditore. Në analizimin e zërit Të drejta të Arkëtueshme dhe nënkategorisë “nga aktiviteti i shfrytëzimit” vihet re një rritje në vlerë e cila përkon me mosarkëtim në kohë të detyrimeve nga ana e debitorëve që reflektohet dhe në zërin e Mjeteve Monetare si një rënie e arkëtimeve me anë të Bankës dhe Arkës. Në analizimin e zërit të Drejta të Arkëtueshme vihet re që në nënkategorinë “<i>Ilogari të tjera të arkëtueshme</i>”, përshkrimi i llogarisë “Institucioni Financiare për t’u arkëtuar Posta, Uft, etj të drejta të cilët nuk sqarohen nëse përkojnë me të ardhurat e përfituara në muajin dhjetor dhe të mbledhura nga këto institucione për llogari të shoqërisë apo për ndonjë arsye tjetër. Në analizimin e zërit të Drejta të Arkëtueshme vihet re që në nënkategorinë “<i>Ilogari të tjera të arkëtueshme</i>”, përshkrimi i llogarisë “Garanci përmbaues privat” paraqitet një vlerë e cila në fund të periudhës 2018 paraqitet si vlerë 24,105,629 lekë, duke u shtuar në periudhën pasardhëse në vlerën 28,069,356 lekë dhe duke qëndruar si e tillë për vitet në vazhdim, duke mos dhënë arsyt përkatëse se çfarë karakterizon kjo vlerë dhe përse është e mbartur ndër vite. Në analizimin e zërit të Drejta të Arkëtueshme, në llogaritë e arkëtueshme janë të krijuar provizione për zhvlerësimin e aktiveve financiare të ndara në 3 kategori, atë të KL Familjar, KL Privat dhe KL Ente. Nga analizimi i tyre vihet re që vlera e provizionit mbetet e pandryshuar dhe nuk jepen shpjegime se klientët e përfshirë në klasifikimet e mësipërme në çfarë viti janë mbartur dhe përse janë klasifikuar si provizione dhe jo si borxh i keq. Në ato pak raste ku ndërmarrja ka humbur me anë të vendimit të gjykatës vlerë të caktuar të cilat i përkasin faturimeve që janë provizionuar për humbje, ekziston një vlerë e re e cila kalon si shpenzime të periudhës duke mos dhënë arsyt përkatëse mbi karakteristikat e vlerës. Në analizimin e zërit Detyrime Afatshkurtra dhe nënkategorisë “<i>Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit</i>” vihet re një rritje në vlerë e këtij zëri ku në të cilën janë të përfshira edhe detyrimet e mbartura nga institucionet e tjera si Ujësjiellës Kavajë, Ndërmarrja rruga si dhe OSSH, për të cilët administrata nuk ka ndjekur asnjë rrugë për likuidimin e tyre duke caktuar një rend apo një metodë të drejtë mbi likuidimin e tyre.	2.6	E Lartë	UK Durrës sh.a. gjatë hartimit të pasqyrave financiare të marrë në konsideratë Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, hartimin, miratimin dhe depozitimit e pasqyrave financiare në kohë sipas legjislacionit në fuqi si dhe të ketë parasysh likuidimin në kohë ose duke krijuar një rend mbi likuidimin e kreditorëve të cilët janë akumuluar ndër vite.

	Në analizimin e zërit Detyrime Afatgjata dhe në nënkategorinë “<i>Titujt e huamarrjes</i>” përfaqësohet nga tre kredi afatgjatat Kredia OPEC lidhur me datë 10.10.2002 në vlerën 2,672,938 USD, Kredia BEI lidhur me datë 15.04.2044 në vlerën 7,011,841 Euro si dhe Kredia IDA lidhur me datë 07.07.2003 në vlerën 5,201,310 USD, të konvertuara me kursin e ditës për vitet përkatëse ku e njëjta gjë vazhdon dhe për vitet në vijim kur principali dhe interesat nuk paguhën por njihen si detyrime ndaj Ministrisë së Financave. Në analizimin e shpenzimeve në zërin Gjopa, Penalitete, Dëmshpërblime gjendja të cilat rëndojnë buxhetin e shoqërisë duke i përdorur fondet pa efektivitet, efience dhe ekonomikitet. Në analizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve ku në të cilën shihet që shoqëria tre vitet e fundit, duke mbajtur të ardhurat në mënyrë konstante ka rritur shpenzimet dhe kur shoqëria rezulton me humbje.			
7	Gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit me objekt “Rikonstruksion në rrjetin ekzistues të qytetit të Durrësit, zona 10 dhe 13/1, Bashkia Durrës” për vitin 2021, në analizimin e hartimit të specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta u gjetën kriterë të cilat nuk ishin në proporcion me objektin e kontratës si dhe në mospërputhje me njëra tjetrën si më poshtë: <i>Shofer 4 persona, Automakinist 2 persona, Manovrator 6 persona</i>, ndërkohë kërkon që të disponohen dhe mjetet e mëposhtme si: <i>Kamion vetshkarkues 10 Copë, Mjet gjermimi me goma 2 copë autovinç 2 copë, Autobot uji 1 copë, Autopompe betoni 1 copë, Autobetoniere 2 copë Eskavator me zinxhir 2 copë, Mini eskavator 3 copë, Minifadromë 2 copë</i> që në total janë 25 mjete të kërkuara me 12 shoferë të kërkuar më sipër, të cilët janë mjete që duhen të jenë në shfrytëzim me kohë të plotë dhe që minimumi duhet të kenë nga një shofer për çdo mjet si dhe përfshirja e një numri të vogël të inxhinierëve në proporcion me vlerën dhe me zërat e punimeve në preventivin e punimeve.	2.7	E Lartë	UK Durrës sh.a., në zhvillimin e procedurave të prokurimit, veçanërisht në hartimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta, të ketë parasysh që të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve
8	Gjatë zhvillimit të Procedurës së Prokurimit me objekt “Blerje mjete për nevojat e UK Durrës sh.a.” gjatë hartimit të specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta, nuk janë cilësuar se të çfarë viti prodhimi duhet të jenë automjetet, që është minimumi mbi përllogaritjen e vlerës që mbartin ato. Gjithashtu në specifikimet teknike të “Makinë teknologjike APV vetëshkarkuese” është kërkuar kriter që për km e përshkruara të jenë jo më shumë se 251,000 km, ndërsa për të njëjtin automjet “makinë teknologjike vetëshkarkuese për pastrim pushtash e kanalizime dhe transport materialeve të veçanta” në specifikimet teknike kërkohet që në kilometrat e përshkruara të jenë jo më shumë se 150,000 km, që do të thotë për një objekt të njëjtë kërkohen specifikime teknike të ndryshme. Për automjetin “makinë teknologjike APV” me targë AE MT 93 rezultoi që është me timon në krahë të djathtë, gjë e cila duhet që të ishte e cilësuar në specifikimet teknike për vet riskun që mbartin.	2.6	E Lartë	Administratori i shoqërisë UK Durrës, të nxjerrë përgjegjësitë për komisionin e hartimit të specifikimeve teknike në lidhje me hartimin e procesverbalit mbi hartimin e specifikimeve teknike në lidhje me km e përshkruara të automjeteve dhe vitin e prodhimit si dhe për komisionin e marrjes në dorëzim të mallit, në lidhje me makinën teknologjike APV që rezultoi të jetë me timon në krahë të djathtë.
9	Sipas shkresës nr. 50/4 prot., datë 22.01.2021 është mbajtur një procesverbal nga e grupit të ndjekjes së kontratës sipas të cilit janë konfirmuar punimet e paraqitura në situacionin nr. 1 me bashkëlidhur një faturë tatimore të datës 22.01.2021 me vlerë 12,662,956 lekë me TVSH, ose 33.7 % të vlerës së kontratës. Nga analiza e zërave të situacionit dhe krahasimit të të dhënave të marra nga ditari i punimeve dhe grafikut të punimeve konfirmohet fakti se shuma e mësipërme, i është likuiduar sipërmarrësit të punimeve me volume të konsiderueshme pune të pakryera në fakt në momentin e likuidimit të tyre duke favorizuar kështu padrejtësisht zbatuesin e punimeve përmes pagesave. Gjithashtu, rezulton se volumet e punës të situacionit nr. 1, për disa zëra të ndryshëm janë nga 101 % deri në 300 % më tepër në krahasim me ato të preventivit të kontratës, në një kohë kur në nga data 07.01.2021 deri në datë 22.01.2021 nuk ka as një kërkesë dhe as miratim	2.7	E Lartë	Nga ana e UK Durrës sh.a. të merren masa për ngritjen e grupeve efektive në drejtim ndjekjes së kontratës, me qëllim shmangien e kryerjes së pagesave përmes situacioneve fiktive e që nuk paraqesin realitetin në momentin e likuidimit.

	për ndryshim projekti. Nga krahasimi mes grafikut të punimeve dhe volumeve të situacionit përfundimtar, kapaciteteve teknike të ofruar dhe të vendosura në dispozicion gjatë zbatimit të punimeve (procesverbali i fillimit të punimeve, ditari i punimeve etj.) rezulton se ka një diferencë të konsiderueshme mes volumeve të parashikuara për tu kryer me ato të situacionuara e likuiduara në vlerën 6,394,479.6 lekë me TVSH, ose gati 50 %. Konkretisht tabela argumentuese e kësaj vlere jepet në Aneksin nr. 1.1. Gjithashtu, referuar akt kontrollit nr. 2 (Aneksi nr. 1.2) i cili mban datën 22.01.2021 dhe është miratuar nga ana e mbikëqyrësit të punimeve, sipërmarrësit dhe përfaqësuesit të autorizuar të AK z. K.B rezulton se ecuria e punimeve ka qenë në masën 10 %, ose 3,125,049 lekë pa TVSH. Kështu, duke kryqëzuar informacionin e marrë nga të dhënat e ditarit të punimeve dhe tabelës krahasuese të grafikut të punimeve krijohet një dyshim i arsyeshëm mbi baza teknike se likuidimi i situacionit pjesor nr. 1 me vlerë 12,662,956.2 lekë me TVSH është kryer në kushtet e mos kryerjes së punimeve në vlerën prej të paktën 8,912,897 lekë me TVSH. Sa më sipër është në kundërshtim me Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3, Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve e lidhur sipas aktit nr. 2801 prot., datë 04.12.2020 si dhe me Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve e lidhur sipas aktit nr. 2345 prot., datë 12.05.2021.			
10	Gjatë zhvillimi të Procedurës së Prokurimit me objekt “<i>Sistemi i furnizimit me ujë të zonës Turistike Hamallaj, Faza II, Nj. Adm. Sukth, Bashkia Durrës</i>” gjatë hartimit të specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta, janë vendosur kriterë të cilat nën gjykimin e audituesve janë të ekzagjeruara dhe jo në proporcion me objektin e kontratës si më poshtë: Vendosja e licencave të mëposhtme: <i>NP.5-B Punime nëntokësore, ura e vepra arti, NP. 11-A Ndërtime për N/Stac., kab. e transform., linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë, NS. 1-A Punime për prishjen e ndërtimeve</i>, ku bazuar në VKM nr. 943 datë 28.12.2016¹ nuk janë në proporcion me objektin e kontratës si dhe me zërat dhe punimet e detajuara në preventivin e punimeve. Vendosja e kriterëve si më poshtë: <i>-Për të provuar se ka përvojën e duhur, Operatori duhet të dëshmojë se ka të punësuar mesatarisht 150 punonjës</i>, ku përvoja e duhur nuk mund të matet me numrin e personave që ka të punësuar por me realizimet e projekteve të mëparshme dhe punëve të ngjashme. <i>-Drejtuesi Teknik të ketë përvojë jo më pak se 10 vjet kriterë të cilat diskriminojnë operatorët e tjerë si dhe drejtuesit teknik të cilët anën profesionale të tyre e dëshmon licenca përkatëse që kanë.</i>	2.7	E Lartë	UK Durrës sh.a., në zhvillimin e procedurave të prokurimit, veçanërisht në hartimin e kriterëve të veçanta, të ketë parasysh që të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, përmbajtjen e tij duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve.
11	Gjatë zhvillimi të Procedurës së Prokurimit me objekt “<i>Ndërtim i rrjetit të KUZ të fshatit Shënavlash, Bashkia Durrës</i>” gjatë hartimit të specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta, janë vendosur kriterë të cilat nën gjykimin e audituesve janë të ekzagjeruara dhe jo në proporcion me objektin e kontratës si më poshtë: Vendosja e licencave të mëposhtme: <i>NP.5-B Punime nëntokësore, ura e vepra arti, NP. 11-A Ndërtime për N/Stac., kab. e transform., linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë, NS. 1-A Punime për prishjen e ndërtimeve</i>,	2.7	E Lartë	UK Durrës sh.a., në zhvillimin e procedurave të prokurimit, veçanërisht në hartimin e kriterëve të veçanta, të ketë parasysh që të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, përmbajtjen e tij duke krijuar kushte për konkurrim të

¹ Për Disa Ndryshime Dhe Shtesa Në Vendimin Nr.759, Datë 12.11.2014, Të Këshillit Të Ministrave, "Për Licencimin Profesional Të Individëve Dhe Personave Juridikë Që Do Të Ushtrijnë Veprimtari Në Fushën E Studimit E Të Projektimit Në Ndërtim Dhe Mbikëqyrjes E Kolaudimit Të Punimeve Të Zbatimit Në Ndërtim"

	ku bazuar në VKM nr. 943 datë 28.12.2016 ² nuk janë në proporcion me objektin e kontratës si dhe me zërat dhe punimet e detajuara në preventivin e punimeve. Vendosja e kriterit si më poshtë: <i>-Drejtuesi Teknik të ketë përvojë jo më pak se 10 vjet.</i> kriteret të cilat diskriminojnë operatorët e tjerë si dhe drejtuesit teknik të cilët anën profesionale të tyre e dëshmon licenca përkatëse që kanë.			paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve.
12	Gjatë zhvillimi të Procedurës së Prokurimit me objekt <i>“Përmirësim i furnizimit me ujë lagja nr.1, Vardardh, nj. Adm Sukth, Bashkia Durrës”</i> gjatë hartimit të specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta, janë vendosur kriteret të cilat nën gjykimin e audituesve janë të ekzagjeruara dhe jo në proporcion me objektin e kontratës si më poshtë: Vendosja e licencave të mëposhtme: <i>NP.5-B Punime nëntokësore, ura e vepra arti, NP. 11-A Ndërtime për N/Stac., kab. e transform., linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë, NS. 1-A Punime për prishjen e ndërtimeve, NS 9-A Punime strukturore special</i> ku bazuar në VKM nr. 943 datë 28.12.2016 ³ nuk janë në proporcion me objektin e kontratës si dhe me zërat dhe punimet e detajuara në preventivin e punimeve. Vendosja e kriterit si më poshtë: <i>-Drejtuesi Teknik të ketë përvojë jo më pak se 10 vjet</i> kriteret të cilat diskriminojnë operatorët e tjerë si dhe drejtuesit teknik të cilët anën profesionale të tyre e dëshmon licenca përkatëse që kanë.	2.7	E Lartë	UK Durrës sh.a., në zhvillimin e procedurave të prokurimit, veçanërisht në hartimin e kriterëve të veçanta, të ketë parasysh që të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, përmbajtjen e tij duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve.
13	Gjatë zhvillimi të Procedurës së Prokurimit me objekt <i>“Sistemimi i furnizimit me ujë të zonës Turistike Hamallaj, Faza II, Nj. Adm. Sukth, Bashkia Durrës”</i> gjatë hartimit të specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta, janë vendosur kriteret të cilat nën gjykimin e audituesve janë të ekzagjeruara dhe jo në proporcion me objektin e kontratës si më poshtë: Vendosja e licencës të mëposhtme: <i>NP.- 1 Punime gërmimi në tokë</i> , ku bazuar në VKM nr. 943 datë 28.12.2016 ⁴ nuk janë në proporcion me objektin e kontratës si dhe me zërat dhe punimet e detajuara në preventivin e punimeve. Vendosja e kriterëve si më poshtë: <i>Të kenë në stafin e tyre një inxhinier ndërtimi i cili gjithashtu nuk është në proporcion me objektin e kontratës, pasi do ishte e mjaftueshme përfshirja e një inxhinieri informatike ose elektronike për zhvillimin e procedurës, “Të kenë në stafin e tyre një murator, bojaxhi”</i> ku për shkak të volumit të vogël të punës që ka në lidhje me ndërtimin është i panevojshëm përfshirja e tyre si kriter për të qenë pjesëmarrës në garë, <i>“Kamion me vinç (me kapacitet mbajtës mbi 5 ton)”</i> , ku sipas specifikimeve teknike kemi të bëjmë me vendosjen e depozitave të klorit gjë që e bën të panevojshme pasjen si kriter të veçantë të kamionit me vinç vetëm për arsyen e mësipërme.	2.7	E Lartë	UK Durrës sh.a., në zhvillimin e procedurave të prokurimit, veçanërisht në hartimin e kriterëve të veçanta, të ketë parasysh që të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, përmbajtjen e tij duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve.
14	Gjatë zhvillimi të Procedurës së Prokurimit me objekt <i>“Ndërtimi i ujësjellësit të fshatrave Lalëz, Bizë, Draç dhe Shetë, Njesia Administrative Ishëm-Bashkia Durrës”</i> gjatë hartimit të specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta, janë vendosur kriteret të cilat nën gjykimin e audituesve janë të ekzagjeruara dhe jo në proporcion me objektin e kontratës si më poshtë: Mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës: - <i>Kamiona vetshkarkues kapacitet mbajtës (mbi 20 ton) – Copë 3</i> - <i>Kamiona vetshkarkues kapacitet mbajtës (mbi 13 ton) – Copë 2</i>	2.7	E Lartë	UK Durrës sh.a., në zhvillimin e procedurave të prokurimit, veçanërisht në hartimin e kriterëve të veçanta, të ketë parasysh që të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, përmbajtjen e tij duke

² Për Disa Ndryshime Dhe Shtesa Në Vendimin Nr.759, Datë 12.11.2014, Të Këshillit Të Ministrave, "Për Licencimin Profesional Të Individëve Dhe Personave Juridikë Që Do Të Ushtrojnë Veprimtari Në Fushën E Studimit E Të Projektimit Në Ndërtim Dhe Mbikëqyrjes E Kolaudimit Të Punimeve Të Zbatimit Në Ndërtim"

³ Për Disa Ndryshime Dhe Shtesa Në Vendimin Nr.759, Datë 12.11.2014, Të Këshillit Të Ministrave, "Për Licencimin Profesional Të Individëve Dhe Personave Juridikë Që Do Të Ushtrojnë Veprimtari Në Fushën E Studimit E Të Projektimit Në Ndërtim Dhe Mbikëqyrjes E Kolaudimit Të Punimeve Të Zbatimit Në Ndërtim"

⁴ Për Disa Ndryshime Dhe Shtesa Në Vendimin Nr.759, Datë 12.11.2014, Të Këshillit Të Ministrave, "Për Licencimin Profesional Të Individëve Dhe Personave Juridikë Që Do Të Ushtrojnë Veprimtari Në Fushën E Studimit E Të Projektimit Në Ndërtim Dhe Mbikëqyrjes E Kolaudimit Të Punimeve Të Zbatimit Në Ndërtim"

	- <i>Kamiona vetëshkarkues kapacitet mbajtës (mbi 8 ton) – Copë 2</i> Të cilat duke u bazuar në preventiv e punimeve dhe grafikun e punimeve, nuk ka një llogaritje të ndarjes së tyre sipas tonazhit ku në gjykimin e audituesve ndarja e tyre si më sipër sipas tonazhit përbën arsye mbi skualifikimin e O.E. të tjerë pjesëmarrës ose orientimin drejtë një O.E. fitues të paracaktuar që të përmbushë kriteret e mësipërme. Kërkesa për drejtues teknik si në rastin e: -1 (një) inxhinier hidroteknik -1 (një) inxhinier ndërtimi e cila është e ulët në proporcion me objektin e kontratës dhe volumin e punëve në grafikun dhe preventivin e punimeve, ku minimalisht duhet të ishin kërkuar nga dy inxhinier për klasifikim.			krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve.
15	Gjatë zhvillimi të Procedurës së Prokurimit me objekt <i>“Sistemimi i kanalizimeve të ujërave të ndotura të zonës turistike Hamallaj, Faza I, Njësia Administrative Sukth, Bashkia Durrës”</i> gjatë hartimit të specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta, janë vendosur kriteret të cilat nën gjykimin e audituesve janë të ekzagjeruara dhe jo në proporcion me objektin e kontratës si më poshtë: Vendosja e licencës të mëposhtme: <i>NP 2-B Ndërtimi civil dhe industrial, NP 5-B Punime nëntokësore, ura e vepra arti, NP. 11-A Ndërtime për N/Stac., kab. e transform., linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë</i> ku bazuar në VKM nr. 943 datë 28.12.2016⁵ nuk janë në proporcion me objektin e kontratës si dhe me zërat dhe punimet e detajuara në preventivin e punimeve. Vendosja e kriterëve si më poshtë: -inxhinier elektronik i cili gjithashtu nuk është në proporcion me objektin e kontratës si dhe me zërat e punimeve, <i>Të kenë në stafin e tyre, 4 Punonjës mekanik, 4 Punonjës Elektricit, 4 Punonjës Bojaxhi, 2 Punonjës Pllakashtrues</i>, ku për shkak të volumit të vogël të punës që ka në lidhje me ndërtimin është i panevojshëm përfshirja e tyre si kriter për të qenë pjesëmarrës në garë.	2.7	E Lartë	UK Durrës sh.a., në zhvillimin e procedurave të prokurimit, veçanërisht në hartimin e kriterëve të veçanta, të ketë parasysh që të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, përmbajtjen e tij duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve.
16	Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me kontratën me objekt <i>‘Ndërtimi i Ujësjiellësit të Fshatrave Lalëz, Bizë, Draç dhe Shetë Njesia Administrative Ishëm - Bashkia Durrës’</i>, rezulton se në përfundim të procedurës së prokurimit, është shpallur fitues BOE K.&N., të përfaqësuar këta nga OE K. me nr. licence për zbatim punimesh NZ. 4901/10 datë 06.06.2019 dhe me përfaqësues ligjor z. S. K. me të cilin është lidhur kontrata me Autoritetin Kontraktor e përfaqësuar nga z. K.B. me nr. 1922 prot., datë 13.09.2019 me vlerë 172,471,458.4 lekë me TVSh dhe me afat të zbatimit të punimeve 21 javë nga dita e nesërme e punës pas nënshkrimit të kontratës. Nga auditimi i dosjes teknike të kontratës, konkretisht nga krahasimi i librezës së masave, situacionit përfundimtar, projektit të miratuar me ndryshime, etj. rezultoi se i janë likuiduar tepër sipërmarrësit të punimeve shuma prej 49,755 lekë pa TVSH, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik si rrjedhojë e punimeve të situacionuara por të pakryera në fakt për 2 zëra punimesh si më poshtë: - <u>Në lidhje me zërin ‘Mbushje me material të zgjedhur të gërmuar’.</u> Sipas situacionit përfundimtar për këtë zë rezulton se është likuiduar volumi prej 1168 m³. Libreza e masave pasqyron në mënyrë analitike të njëjtin volum punimesh. Në fakt nga analiza e kësaj të fundit konstatohet se gjerësia me të cilin është gërmuar kanali në segmentin L-B D.1 750-4275 është 0.25 ml kurse gjerësia e mbushjes me këtë material është marrë 0.6 ml. Duke bërë korrigjimet rezulton se është përfituar tepër nga ana e	2.7	E Lartë	Nga ana e UK Durrës sh.a. të kërkohej në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës 49,755 lekë pa TVSH ndaj sipërmarrësit BOE K.&N. për punime të pakryera dhe/apo të kryera jo në përputhje me kërkesat e projektit por të likuiduara në kontratën e sipërmarrjes të lidhur sipas aktit me nr. 1922 prot., datë 13.09.2019 me objekt <i>‘Ndërtimi i Ujësjiellësit të Fshatrave Lalëz, Bizë, Draç dhe Shetë Njësia Administrative Ishëm - Bashkia Durrës’</i> .

⁵ Për Disa Ndryshime Dhe Shtesa Në Vendimin Nr.759, Datë 12.11.2014, Të Këshillit Të Ministrave, "Për Licencimin Profesional Të Individëve Dhe Personave Juridikë Që Do Të Ushtrijnë Veprimtari Në Fushën E Studimit E Të Projektimit Në Ndërtim Dhe Mbikëqyrjes E Kolaudimit Të Punimeve Të Zbatimit Në Ndërtim"

	sipërmarrësit të punimeve volumi prej 123.55 m³ ose shuma prej 12,355 lekë pa TVSH. - <u>Në lidhje me zërin 'F.V. Tub PE100 Ø 63mm PN 10atm'.</u> Sipas situacionit përfundimtar për këtë zë rezulton se është likuiduar volumi prej 597 ml. Ky volum sipas librezës së masave ka rezultuar nga linja në L-B D.1 5087 - 4790 (368 ml), L-B D.4 0 - 165 (113 ml) dhe L-B D.9 0 - 125 (116 ml). Në fakt referuar kronologjisë së punimeve dhe volumeve të pasqyruara për volumet e gërmimit në tokë kat. III dhe tokë e fortë rezulton se po në këto akse janë gërmuar përkatësisht gjatësitë 300 ml, 113 ml dhe 116 ml, ose 529 ml në total, pra 68 ml më pak. Duke bërë korrigjimet rezulton se është përfituar tepër nga ana e sipërmarrësit të punimeve shuma prej 37,400 lekë pa TVSH. Si përfundim, rezulton se janë përfituar tepër nga ana e sipërmarrësit të punimeve vlera prej 49,755 lekë pa TVSH si rrjedhojë e punimeve të pakryera në fakt, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e shoqërisë UK Durrës sh.a. dhe si e tillë duhet të zhdëmtohet nga ana e BOE "K.&N." në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve. Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit", i ndryshuar, Kreu III, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënparagrafi 3.2 dhe 3.3 si dhe me kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes të lidhur sipas shkresës me nr. 1925 prot., datë 13.09.2019, kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve të lidhur sipas aktit nr. 720 prot., datë 10.04.2020 si dhe Urdhrin e Titullari të AK me nr. 1298/9 prot., datë 24.05.2019 për ndjekjen e kontratës.			
17	Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me kontratën me objekt 'Përmirësimi i furnizimit me ujë Lagia Nr. 1, Vadardhë, Njësia Administrative Sukth Bashkia Durrës', rezulton se në përfundim të procedurës së prokurimit, është shpallur fitues BOE K.&L.&S., të përfaqësuar këta nga OE K. me nr. licence për zbatim punimesh NZ. 4901/12 datë 07.04.2020 dhe me përfaqësues ligjor z. S.K. me të cilin është lidhur kontrata me Autoritetin Kontraktor të përfaqësuar nga z. K.B. me nr. 1520 prot., datë 10.08.2020 me vlerë 153,273,319.4 lekë me TVSh dhe me afat të zbatimit të punimeve 200 ditë kalendarike nga dita e nesërme e punës pas nënshkrimit të kontratës. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se i janë likuiduar tepër sipërmarrësit të punimeve BOE K.&N.&S. vlera prej 336,000 lekë pa TVSH si rrjedhojë e punimeve të pa kryera në fakt dhe/ose jo të kryera sipas zërit të parashikuar në preventiv. Konkretisht kjo shumë rezulton si më poshtë: - <u>Në lidhje me zërin 'Prova në tubin'.</u> Sipas projekt-preventivit të hartuar nga ana e projektuesit rezulton se janë përfshirë në preventiv e njëkohësisht edhe në ofertën e paraqitur nga sipërmarrësi i punimeve BOE K. & L. & S. zëri për kryerjen e provës së tubit. Në fakt referuar <i>Specifikimeve Teknike</i>, Kapitulli 8, pika 8.9 <i>Përshkrimi i çmimit njësi të tubave për kanalizimet përcaktohet se:</i> "Furnizim i tubacioneve të gjitha diametrave, mbajtja, shtrirja, furnizimi i të gjitha materialeve të nevojshme, veglave, pajisjeve të kërkuara për shkrimin e tubave, fuqia punëtore, përshtatësit, bashkuesit, izoluesit, prova e tubave, sigurimi dhe instalimi i shiritave me ngjyrë, sheshimi i sipërfaqes, hekuri dhe armimi i tubave dhe të gjitha aktivitetet siç përshkruhen më sipër janë përfshirë në çmimin njësi për një metër tubacion kanalizimesh". Gjithashtu, referuar kontratës së sipërmarrjes të lidhur mes palëve sipas aktit me nr. 1520 prot., datë 10.08.2020, neni 31 Inspektimet, pika 1 <u>përcaktohet se:</u> "Kontraktori duhet të bëjë të gjitha testet dhe inspektimet e kërkuara nga dispozitat e kontratës. Kosto e këtyre testeve dhe inspektimeve duhet	2.7	E Lartë	Nga ana e UK Durrës sh.a. të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës 336,000 lekë pa TVSH ndaj sipërmarrësit BOE K. & L. & S. për punime të pakryera dhe/apo të kryera jo në përputhje me kërkesat e projektit por të likuiduara në kontratën e sipërmarrjes të lidhur sipas aktit me nr. 1520 prot., datë 10.08.2020 me objekt 'Përmirësimi i furnizimit me ujë Lagia Nr. 1, Vadardhë, Njësia Administrative Sukth Bashkia Durrës'.

	të financohet tërësisht nga Kontraktori brenda çmimit të kontratës”. Për rrjedhojë rezultojnë se është përfituar tepër nga ana e sipërmarrësit të punimeve shuma 336,000 lekë pa TVSH. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu II, neni 7, Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënparagrafët 3.2 dhe 3.3, Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve e lidhur sipas aktit nr. 1521 prot., datë 10.08.2020 si dhe Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve e lidhur sipas aktit nr. 1653/8 prot., datë 11.05.2021.			
18	Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me kontratën me objekt ‘Rikonstruksion i rrjetit të ujësjellësit Shkafane dhe Lagjet Muzhaq Kulls, nj. adm. Ishëm, Bashkia Durrës’, rezultojnë se në përfundim të procedurës së prokurimit, është shpallur fitues BOE G. & L., të përfaqësuar këta nga OE G. me nr. licence për zbatim punimesh NZ.7351/4 datë 15.06.2020 dhe me përfaqësues ligjor z. K. A. me të cilin është lidhur kontrata me Autoritetin Kontraktor e përfaqësuar nga z. K. B. me nr. 3011 prot., datë 24.12.2020 me vlerë 37,500,594.41 lekë me TVSH dhe me afat të zbatimit të punimeve 90 ditë kalendarike nga dita e nesërme e punës pas nënshkrimit të kontratës sipas grafikut të hartuar nga projektuesi. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultojnë se i janë likuiduar tepër sipërmarrësit të punimeve BOE G. & L. vlera prej 404,900 lekë pa TVSH si rrjedhojë e punimeve të pa kryera në fakt dhe/ose jo të kryera sipas zërit të parashikuar në preventiv. Konkretisht kjo shumë rezultojnë si më poshtë: - Në lidhje me zërin ‘F.V. Tub PE100 RC Ø 50 mm PN 16 atm’. Sipas situacionit përfundimtar për këtë zë rezultojnë se është likuiduar vëllimi prej 3369 ml. Sipas librezës së masave pasqyrohet në mënyrë analitike vëllimi prej 924 ml linear për situacionin e parë dhe 2429 ml për situacionin e dytë (559 ml + 1867 ml), ose 3350 ml në total. Në fakt nga krahasimi i vëllimeve të situacionit përfundimtar dhe librezave të masave rezultojnë një diferencë me situacionin tepër në sasinë prej 19 ml. Duke bërë llogaritjet rezultojnë se është përfituar padrejtësisht vlera prej 20,900 lekë pa TVSH (19 ml x 1,100 lekë/ml). - Në lidhje me zërin ‘Prova në tubin’ Sipas projekt-preventivit të hartuar nga ana e projektuesit rezultojnë se janë përfshirë në preventiv e njëkohësisht edhe në ofertën e paraqitur nga sipërmarrësi i punimeve BOE G.& L. zëri për kryerjen e provës së tubit. Në fakt, referuar kontratës së sipërmarrjes të lidhur mes palëve sipas aktit me nr. 3011 prot., datë 24.12.2021, neni 31 Testimet dhe Inspektimet, <u>përcaktohet se</u>: “Kontraktori duhet të bëjë të gjitha testet dhe inspektimet e kërkuara nga dispozitat e kontratës. Kosto e këtyre testeve dhe inspekteve duhet të financohet tërësisht nga Kontraktori brenda çmimit të kontratës”. Për rrjedhojë rezultojnë se është përfituar tepër nga ana e sipërmarrësit të punimeve shuma 384,000 lekë pa TVSH e likuiduar për kryerjen e testimit të tubacioneve. - Në lidhje me zërin ‘Shtresë stabilizanti t=20 cm’ Sipas situacionit përfundimtar rezultojnë vëllimi prej 4238.4 m² për lagjen Muzhaq dhe 1890.6 m² për Fshatin Shkafane. Librezat e masave pasqyrojnë po të njëjtat vëllime të shprehura në mënyrë analitike. Në fakt referuar dokumentacionit fotografik të ndodhur në dosje nuk rezultojnë asnjë rast i vetëm i përdorimit të këtij materiali përgjatë aksit të linjës së realizuar. Për rrjedhojë rezultojnë se nuk dokumentohen punime në shumën prej 2,758,050 lekë pa TVSH.	2.7	E Lartë	Nga ana e UK Durrës sh.a. të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës 404,900 lekë pa TVSH ndaj sipërmarrësit BOE G. & L. për punime të pakryera dhe/apo të kryera jo në përputhje me kërkesat e projektit por të likuiduara në kontratën e sipërmarrjes të lidhur sipas aktit me nr. 3011 prot., datë 24.12.2020 me objekt ‘Rikonstruksion i rrjetit të ujësjellësit Shkafane dhe Lagjet Muzhaq Kulls, nj. adm. Ishëm, Bashkia Durrës’.

	Si përfundim, rezulton se janë përfutur tepër nga ana e sipërmarrësit të punimeve vlera 404,900 lekë pa TVSH e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e shoqërisë UK Durrës sh.a. dhe si e tillë duhet të zhdëmtohet nga ana e BOE “G. & L.” në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve si dhe njëkohësisht nuk dokumentohet kryerja e punimeve me tre zëra në vlerën 2,758,050 lekë pa TVSH. Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu II, neni 7, Kreu II Kërkesa Themelore, neni 12, Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, <u>ku përcaktohet se</u>: Pika 8.1, Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3, Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar e konkretisht Kreu II, Pika 3, Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve e lidhur sipas aktit nr. 2801 prot., datë 04.12.2020 si dhe me Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve e lidhur sipas aktit nr. 2345 prot., datë 12.05.2021.			
19	Në 63 raste të blerjeve emergjente, gjithsej në vlerën prej 3,180,666 lekë, shoqëria ka përdorur procedurën e blerjeve shpresore kur blerjet nuk kanë qenë në kushtet e emergjencës, dmth. në kushtet e ndodhjes të një ngjarje të rastit, ngjarje e cila nuk mund të parashikohej në fillim të vitit, për kë arsye këto shpenzime janë konsideruar pa efektivitet ekonomik. Në vitin 2018, në 19 procedura emergjence, konkretisht “Blerje aparate fotografike, Blerje bojë për lyerje zyre, Blerje brava dhe aksesori, Blerje brava të jashtme për repartin mekanik, Blerje brava durali, Blerje brava për sektorin e shërbimeve, Blerje brava sekrete, Blerje brava për degën teknike, Blerje brava komplet dhe dryna 38 mm, Blerje dekorime festime, Blerje doreze dere, Blerje libra dorëzimi, Blerje regjistër korrespondence A3, Drejtim dhe lyerje dere kolone mjeti, Kolaudim për objektin “Rikonstruksion sheshi në Impiantin e Trajtimin të Ujërave të Ndotura”, Kolaudim “Rehabilitim i linjës së furnizimit të Depos Shkallë”, Mobilje për mbajtje dokumentesh, Ndërrim parakolpi dhe parafango, Profile alumini dopio xham dhe mentesha”, shpenzime me efekt negativ financiar, gjithsej në vlerën prej 508,621 lekë. Në vitin 2020, në 17 procedura emergjence, konkretisht, “Blerje adeziv dhe pecikllaz për tabela sinjalizuese, Blerje alkool dhe xhel dezinfektues, Blerje aparat sapuni, Blerje bexha për personelin, Blerje bojë për lyerje, Blerje higjienizues, Blerje higjienizues dhe maska, Blerje letër me logon e UK Durrës sh.a. , Blerje libër dorëzimi, Blerje libreza uji, Blerje maska pa valvul, Blerje motor sharre, Blerje ngrohëse elektrike për zyra, Blerje tavolinë zyre me xham, Blerje zarfesh, Drejtim llamarine dhe lyerje mjeti”, shpenzime me efekt negativ financiar, gjithsej në vlerën prej 902,043 lekë. -Në vitin 2021, në 16 procedura emergjence, konkretisht “Blerje kalendari, Blerje zarfa me logo, Blerje karroce betoni me gome, Blerje letër A4 me koke, Blerje Bexhe personeli, Blerje Kondicioneri, Veshje të nevojshme për mbarëvajtjen e punës, çizme xhaketa shiu, Libër protokolli, libër dorëzimi, Blerje gardh kopshti, karrige, tavoline alumin-druri, Set kostume pune, Blerje blloqe urdhër pune, Blerje adeziv makine, Blerje kondicioner për nevoja të UK Durrës sh.a. (2cope), Monitor për sallën mbledhjeve Blerje karrige, Blerje komodinash me celes”, shpenzime me efekt negativ financiar, gjithsej në vlerën prej 1,186,082 lekë. Në vitin 2022, në 11 raste, konkretisht “Blerje materiale kangjella hekuri për zyrën e Arshivës, Siguracion TPL për mjetin me targe AA7327E, Përkthime për procedurën mbi kufirin e lartë monetar “Blerje materiale hidraulike”, Blerje mandate arkëtimi, Përkthime për procedurën mbi	2.7	E Lartë	Administratori i shoqërisë të analizojë situatën e krijuar dhe të përcaktojë shkallën e përgjegjësisë të personave përgjegjës. Gjithashtu, administratori duhet të sigurojë që të përfshijë në rregulloret apo manualët përkatëse klasifikimin e rasteve emergjente sipas natyrës së proceseve kryesore të aktivitetit të shoqërisë, me qëllim parandalimin e rasteve abuzive në shpenzimin e fondeve publike.

	kufirin e larte monetar "Blerje materiale dhe pajisje elektrike, vegla, pajisje mekanike", Blerje adesiv dhe baneri per veshjen e zyrës se Sukthit, Blerje makine grirëse per letra, Blerje detergjente, Blerje dosje kartoni per arshivën, Blerje karrige per nevojat e UK Durrës sh.a. , Blerje vetratë + dere per ambientet e UK Durrës sh.a. ". Autoriteti Kontraktor ka përdorur procedurën e blerjeve shkresore në raste emergjente kur blerjet nuk kanë qenë në kushtet e emergjencës, në vlerën gjithsej prej 583,920 lekë , dhe se këto shpenzime konsiderohen pa efektivitet.			
20	Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me kontratën me objekt 'Përmirësimi i furnizimit me ujë Lagia Nr. 1, Vadardhë, Njësia Administrative Sukth Bashkia Durrës', rezulton se Në përfundim të procedurës së prokurimit, është shpallur fitues BOE K. & L. & S., të përfaqësuar këta nga OE K. me nr. licence për zbatim punimesh NZ. 4901/12 datë 07.04.2020 dhe me përfaqësues ligjor z. S. K. me të cilin është lidhur kontrata me Autoritetin Kontraktor e përfaqësuar nga z. K. B. me nr. 1520 prot., datë 10.08.2020 me vlerë 153,273,319.4 lekë me TVSh dhe me afat të zbatimit të punimeve 200 ditë kalendarike nga dita e nesërme e punës pas nënshkrimit të kontratës. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton <u>Në lidhje me zërin 'F.V derë metalike'</u>. Nga verifikimi në terren i punimeve rezultoi se dyert metalike të vendosura ishin të një cilësie shumë të dobët duke mos siguruar kështu një investim të qëndrueshëm e duke bërë që fondet e shpenzuara për këtë zë në masën prej 1,339,800 lekë pa TVSH të konsiderohen si të përdoruara pa efektivitet efikasitet dhe ekonomicitet. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit", i ndryshuar, Kreu II, neni 7, Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit", Kreu II, Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nën pikat 3.2 dhe 3.3, Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve e lidhur sipas aktit nr. 1521 prot., datë 10.08.2020 si dhe Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve e lidhur sipas aktit nr. 1653/8 prot., datë 11.05.2021.	2.7	E Lartë	Nga ana e UK Durrës sh.a. të merren masa për ngritjen e grupeve efektive në drejtim ndjekjes së kontratës, me qëllim shmangien e kryerjes së punimeve jo cilësore dhe/apo në kundërshtim me specifikimet teknike të kërkuara si dhe shmangien e përdorimit pa efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet të fondeve të shoqërisë..
21	Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me kontratën me objekt 'Ndërtimi i Ujësjellësit të Fshatrave Lalëz, Bizë, Draç dhe Shetë Njesia Administrative Ishëm - Bashkia Durrës', rezulton se në përfundim të procedurës së prokurimit, është shpallur fitues BOE K. & N., të përfaqësuar këta nga OE K. me nr. licence për zbatim punimesh NZ. 4901/10 datë 06.06.2019 dhe me përfaqësues ligjor z. S. K. me të cilin është lidhur kontrata me Autoritetin Kontraktor e përfaqësuar nga z. K. B. me nr. 1922 prot., datë 13.09.2019 me vlerë 172,471,458.4 lekë me TVSh dhe me afat të zbatimit të punimeve 21 javë nga dita e nesërme e punës pas nënshkrimit të kontratës. Nga auditimi i dosjes teknike të kontratës, konkretisht nga krahasimi i librezës së masave, situacionit përfundimtar, projektit të miratuar me ndryshime, etj. rezultoi se sipas dokumentacionit fotografik të ndodhur në dosjen teknike të zbatimit nuk dokumentohen në asnjë rast të vetëm kryerja e punimeve për <u>transportin e materialit të gërmuar, mbushjes me rërë</u> si dhe <u>mbushjes me zhavorr</u> për linjën e dërgimit si dhe linjave të shpërndarjes (shuma prej 8,464,526 lekë pa TVSH për linjën e dërgimit, shuma prej 6,378,512 lekë pa TVSH për linjën e shpërndarjes Lalëz dhe Bizë, shuma prej 4,533,929 lekë pa TVSH për linjën e shpërndarjes në Drac si dhe shuma prej 4,133,966 për linjën e shpërndarjes në Shete). Në total	2.7	E Lartë	Nga ana e UK Durrës sh.a. të merren masa për ngritjen e një grupi pune me specialistë të fushës ⁶ me qëllim kryerjen e sondazheve përfaqësuese në terren për të verifikuar zbatueshmërinë e projekt – preventivit të kontratës, konkretisht zbatueshmërisë së zërave për transportin e materialit të gërmuar, mbushjes me rërë si dhe mbushjes me zhavorr për të cilat nuk konfirmohet kryerja e tyre në shumën prej 23,510,933 lekë pa TVSH . Në rast të konstatimit të punimeve të pakryera nga ato të përfshira në situacionin përfundimtar, të kërkohej arkëtimi i dëmit përkatës.

⁶ Jo punonjës të përfshirë në procesin e ndjekjes së kontratës.

	rezulton se vetëm për këta dy zëra nuk dokumentohen punime të kryera në vlerën totale prej 23,510,933 lekë pa TVSH. Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënparagrafi 3.2 dhe 3.3 si dhe me kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes të lidhur sipas shkresës me nr. 1925 prot., datë 13.09.2019, kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve të lidhur sipas aktit nr. 720 prot., datë 10.04.2020 si dhe Urdhrin e Titullari të AK me nr. 1298/9 prot., datë 24.05.2019 për ndjekjen e kontratës.			
22	: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me kontratën me objekt ‘Rikonstruktion i rrjetit të ujësjellësit Shkafane dhe Lagjet Muzhaq Kulls, nj. adm. Ishëm, Bashkia Durrës’, rezulton se në përfundim të procedurës së prokurimit, është shpallur fitues BOE G. & L., të përfaqësuar këta nga OE G. me nr. licence për zbatim punimesh NZ.7351/4 datë 15.06.2020 dhe me përfaqësues ligjor z. K. A. me të cilin është lidhur kontrata me Autoritetin Kontraktor të përfaqësuar nga z. K. B. me nr. 3011 prot., datë 24.12.2020 me vlerë 37,500,594.41 lekë me TVSH dhe me afat të zbatimit të punimeve 90 ditë kalendarike nga dita e nesërme e punës pas nënshkrimit të kontratës sipas grafikut të hartuar nga projektuesi. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se: • <u>Në lidhje me zërin ‘Shtresë stabilizanti t=20 cm’</u> Sipas situacionit përfundimtar rezulton volumni prej 4238.4 m² për lagjen Muzhaq dhe 1890.6 m² për Fshatin Shkafane. Librezat e masave pasqyrojnë po të njëjtat volume të shprehura në mënyrë analitike. Në fakt referuar dokumentacionit fotografik të ndodhur në dosje nuk rezulton asnjë rast i vetëm i përdorimit të këtij materiali përgjatë aksit të linjës së realizuar. Për rrjedhojë rezulton se nuk dokumentohen punime në shumën prej 2,758,050 lekë pa TVSH.	2.7	E Lartë	Nga ana e UK Durrës sh.a. të merren masa për ngritjen e një grupi pune me specialistë të fushës me qëllim kryerjen e sondazheve përfaqësuese në terren për të verifikuar zbatueshmërinë e projekt – preventivit të kontratës, konkretisht zbatueshmërisë së zërit <i>Shtresë stabilizanti t=20 cm</i>, për të cilin referuar dokumentacionit fotografik, nuk konfirmohet kryerja e tyre në shumën prej 2,758,050 lekë pa TVSH. Në rast të konstatimit të punimeve të pakryera nga ato të përfshira në situacionin përfundimtar, të kërkohet arkëtimi i dëmit përkatës.

Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit

Ujësjellës Kanalizime Durrës sh.a., në përgjithësi ka zbatuar kuadrin rregullator, por janë konstatuar edhe shmangie të cilat kanë ndikuar në performancën financiare të shoqërisë. Nuk ndiqen si duhet marrëdhëniet me punonjësit sa i takon kontratës kolektive të punës. Detyrimet afatshkurtra kanë tendencë rritje, kryesisht për pagesat e energjisë elektrike, por edhe ndaj operatorëve ekonomikë, efektet e të cilave do të vështirësojnë më tej performancën financiare. Likuidimet realizohen me mungesë dokumentacioni dhe kontrolli i brendshëm nuk është në nivelin e duhur sa i takon qarkullimit të bazës materiale, shpenzimit të karburanteve etj. Ka mangësi në proceset e prokurimit, për realizimin e tyre me ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet.

Opinioni i Auditimit

1. Opinion për auditimin e përputhshmërisë:

Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së Ujësjellës Kanalizime Durrës sh.a., sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave dhe marrëveshjeve që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve të UK Durrës sh.a., gjatë ushtrimit të aktivitetit përkatës.

“Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e Shoqërisë UK Durrës sh.a., janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, të

cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinionit të kualifikuar të përputhshmërisë.”

II. Baza për opinionin e përputhshmërinë.

Në kemi audituar veprimtarinë e subjektit “Ujësjetllës Kanalizime Durrës sh.a.” në zbatim të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ISSAI 4000 dhe ISSAI 100, paragrafi 42.

Auditimi u krye në përputhje me kërkesat e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë të KLSH-së si dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit të zbatueshme për Institucionet Supreme të Auditimit (ISSAI-s); me parimet ISSAI-P1, “Deklarata e Limës”; ISSAI P-10, “Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t”, si dhe ISSAI P-12, ISSAI P-20, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin përputhshmërisë, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 4000 “Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë”. Në i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 27, datë 20.04.2018, të Kryetarit të KLSH-së.

Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë në institucionet publike, KLSH është e pavarur nga UK Durrës sh.a. dhe përgjegjësitë janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Në besojmë së dëshmitë e evidencës së auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për sigurimin e bazës për opinionin tonë. Auditimi ynë përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e transaksioneve. Procedurat janë përzgjedhur mbështetur gjithashtu mbi gjykimin profesional të audituesit. Gjithashtu, në besojmë së dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit. Shoqëria ka krijuar detyrime ndaj të tretëve deri më datë 31.12.2021, me vlerë **4,587,088,072** lekë e cila përbën efekt negativ financiar për buxhetin e UK Durrës sh.a..

Gjithashtu shoqëria ka përdorur pa Ekonomicitet, Eficence dhe Efektivitet Fondet Publike në shumën **30,789,489** lekë pa TVSH.

Gjatë realizimit të procedurave të auditimit janë konstatuar mos realizime punimesh me dëm ekonomik me vlerë **790,655** lekë pa TVSH.

III. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjet nën auditim:

Menaxhimi i UK Durrës sh.a. është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjithë bazën ligjore dhe rregullatorë në fuqi. Drejtimi është përgjegjës për hartimin dhe miratimin e buxhetit dhe të pasqyrave të llogaridhënies vjetore në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar dhe funksionimin e kontrollit të brendshëm efektiv, për të mundësuar përgatitjen e tyre pa gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

IV. Përgjegjësia e Audituesve të KLSH-së:

Përgjegjësia e auditimit është të shprehë një opinion bazuar në rezultatet e auditimit të kryer, për të marrë siguri të arsyeshme, që veprimtaria e UK Durrës sh.a., në të gjitha aspektet, është pa gabime dhe anomali materiale. Audituesit e KLSH-së nëpërmjet auditimit të realizuar në këtë institucion krijuan bindjet, të cilat do të shprehen në opinionin e grupit të auditimit mbi shkallën e zbatueshmërisë nga subjekti, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (*kriteret e auditimit të*

përputhshmërisë), Objektivi ynë lidhet me *dhënien e sigurisë së arsyeshme* mbi përputhshmërinë e aktivitetit të UK Durrës sh.a., me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuara, administrative si dhe mbi përdorimin e duhur dhe eficient të burimeve financiare e administrative të institucionit. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Për këtë audituesit e KLSH, aplikojnë gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese nëpërmjet të cilës, audituesit identifikojnë çështjet më të rëndësishme që trajtohen në Raportin Përfundimtar të auditimit.

II. HYRJJA

Titulli: Raport Përfundimtar i auditimit “Mbi përputhshmërinë dhe Rregullshmërinë” në UK Durrës sh.a., për periudhën e aktivitetit nga data 01.04.2018 deri më datë 31.10.2022.

Raporti Përfundimtar i auditimit është i strukturuar në gjashtë kapituj. Në kapitullin e parë të Raportit Përfundimtar trajtohet një përmbledhje ekzekutive dhe në vazhdimësi me kapitullin e dytë, atë të hyrjes janë trajtuar çështjet e objektivave dhe qëllimi i auditimit, përgjegjësitë e strukturave drejtuese dhe të audituesve, kriteret, identifikimi i çështjeve, etj. Në vijim, kapitulli i tretë është përshkrimi i auditimit, në të cilin trajtohet një informacion i përgjithshëm mbi subjektin e audituar dhe vazhdon me trajtimin e rezultateve të auditimit për secilin prej drejtimeve të auditimit. Në kapitullin e katërt janë gjetjet dhe rekomandimet të strukturuar sipas llojit të tyre janë vendosur në kreun e katërt. Raporti Përfundimtar ka në kreun e pestë anekse dhe mbyllet me kreun VI-Lista e dokumenteve të auditimit.

Marrësi: Ujësja Kanalizime Durrës sh.a., z. S. K. me detyrë Administrator.

Objektivat dhe qëllimi: Në objektivat dhe qëllimet e auditimit përfshihet vlerësimi objektiv i evidencave, dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion, për të përcaktuar nëse të dhënat e raportuara për periudhën objekt auditimi përputhen me kriteret përkatëse të kuadrit rregullator. Objektivi i Auditimit është dhënia e opinionit nëse UK Durrës sh.a., në të gjithë aspektet materiale, aktiviteti ekonomik dhe financiar, transaksionet dhe informacioni janë në përputhje ose jo me dispozitat ligjore dhe rregulloret përkatëse.

Qëllimi i këtij auditimi përputhshmërie dhe rregullshmërie është evidentimi i devijimit nga standardet e pranuar dhe shkeljes së parimeve të ligjshmërisë, të menaxhimit financiar me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga ana e subjektit të audituar.

Auditimi i përputhshmërisë dhe i rregullshmërisë i ndërmarrë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, ka për qëllim promovimin e qeverisjes së mirë në sektorin publik duke marrë parasysh rrezikun e mashtrimit në lidhje me përputhshmërinë (*sipas ISSAI 400, p 18*).

Me auditimin e përputhshmërisë, duhet të përcaktohet niveli i zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi lidhur me realizimin e proceseve dhe aktiviteteve të institucionit.

Identifikimi i çështjes: Raporti Përfundimtar mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike dhe financiare të UK Durrës sh.a. për periudhën 01.04.2018 - 31.10.2022, ka identifikuar sipas kriterëve specifikë të vlerësimit, shqyrtimin dhe vlerësimin e fushave në vijim:

Zbatimin i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Rregullshmëria e shpenzimeve me arkë, bankë dhe blerjet me vlera të vogla (shpenzimet administrative për automjetet, udhëtime e dieta brenda dhe jashtë vendit, sponsorizime etj.).

Zbatimi i ligjshmërisë në prokurimet e fondeve publike dhe ankandet, lidhjen e zbatimit e kontratave.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese: Strukturat drejtuese kanë për detyrë që të përgjigjen për

garantimin e sistemeve të përshtatshme dhe efektive të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator përkatës.

Strukturat drejtuese janë përgjegjëse për realizimin e objektivave dhe zbatimin e përgjegjësi të caktuara në kuadrin ligjor dhe rregullator, për të menaxhuar fondet publike në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet.

Strukturat drejtuese, duhet të orientojnë strukturat e institucionit, për përmirësimin e furnizimit me ujë dhe kanalizimet.

Përgjegjësitë e audituesve: Audituesit e KLSH janë përgjegjës për dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni përputhen apo jo, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e aplikuar si: rregullat, ligjet, politikat, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord, ku mund të përmendim si burim të këtyre kriterëve: standarde, ligje, vendime të Këshillit të Ministrave, rregullore, buxhete, kontrata, marrëveshje, instrumente të tjerë që përmbajnë rregulla se si duhet të menaxhohen transaksionet dhe zbatohen buxhetet, etj.; shpreh nëpërmjet opinionit të auditimit, duke respektuar Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI, si dhe kodin e etikës me qëllim që të arrihet niveli i arsyeshëm i sigurisë për dhënien e opinionit, në mënyrë që të merren veprime korrigjuese si dhe të identifikojë personat përgjegjës për veprimet e tyre.

Kriteret e vlerësimit: Kriteret e vlerësimit të përdorura në këtë auditim e kanë burimin në legjislacionin bazë e dytësor, në dispozita të tjera si dhe kuadrin rregullator përkatës sipas çështjeve të auditimit:

- Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Ligji nr.8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”;
- Ligji Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar;
- Ligji nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i procedurës civile në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 ”Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar;
- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, si dhe akte të tjera të fushës së ndërtimit dhe urbanistikës;
- VKM nr. 63, datë 27.1.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”;
- VKM nr. 864, date 23.07.2010 “Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridikë, publikë”;
- VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, VKM nr. 918 datë 29.12.2014 “Për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë elektronike”; - - VKM nr. 1304, datë 11.12.2009 “Për miratimin e modelit të rregullores ‘Për furnizimin me ujë dhe kanalizimet në zonën e shërbimit të ujësjellës kanalizimeve’;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik”; Rregullorja e brendshme dhe rregullore të tjera të funksionimit të institucionit, etj.

Standardet e auditimit: Auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranura të kuadrit ligjor, rregullator dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit. Raporti Përfundimtar i auditimit është hartuar në përputhje me kërkesat e Rregullores së Procedurave të Auditimit në KLSH, mbështetur në:

- Ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Kodi etik i KLSH dhe Rregullorja e Brendshme.
- ISSAI 100- Parimet themelore të auditimit të sektorit publik;
- ISSAI 400-Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë;
- ISSAI 4000-Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”;
- ISSAI 1500 (ISA 500)- Objektivi i audituesit është të hartojë dhe të kryejë procedurat e auditimit në mënyrë të tillë që të mundësojë marrjen e evidencës së mjaftueshme për të nxjerrë konkluzione të arsyeshme në të cilin do të bazojë opinionin e tij;
- Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve;
- Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë”; si dhe në praktikat më të mira të fushës.

Metodat e auditimit: Audituesit e KLSH, mbi bazën e evidencave të kërkuara dhe të vëna në dispozicion, intervistave, takimeve dhe konsultave me nëpunësit e UK Durrës sh.a., kanë përgatitur dokumentacionin e mjaftueshëm të auditimit, si rezultat i kuptimit të qartë të kriterëve të përdorura, të fushë-veprimit të auditimit, të gjykimeve, të përfundimeve të arritura, programin e auditimit dhe natyrën, kohën, shtrirjen dhe rezultatet e procedurave të kryera; si dhe konkluzioneve lidhur me to. Në këtë mënyrë, dokumentimi i auditimit është kryer nëpërmjet letrave të punës, shënimeve, pyetësorëve, të finalizuar me akt konstatimet dhe observacionet e subjektit, të cilat kanë shërbyer si bazë për hartimin e këtij Raporti Përfundimtar.

Dokumentimi i auditimit: Është kryer bazuar në kërkesat e manualit të auditimit të përputhshmërisë, në standardet ndërkombëtare të auditimit (ISAI), për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet dhe kërkesat ligjore dhe rregullatore.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

III.1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.

Shoqëria Ujësjiellës Kanalizime Durrës furnizohet me ujë nga 3 burime me ngritje mekanike si më poshtë:

Stacioni Fushë- Kuqe, me 7 puse nëntokësore, nga ku me nëpërmjet linjës së transmetimit DN 700 CE e dërgon ujin nëpërmjet 12 elektro/pompa, për në qytetin e Durrësit në një distancë prej 40 km.

Stacioni Fushë Milot, me 6 puse nëntokësore, nga ku nëpërmjet linjës së transmetimit DN 700 GRP, e dërgon ujin me 8 elektropompa, për në qytetin e Durrësit në një distancë prej 54 km.

Fushë Krujë, me 5 puse nëntokësore dhe nëpërmjet linjës së transmetimit DN 500 CE e dërgon ujin me 4 elektropompa për në qytetin e Shijakut në një distancë prej 18 km.

Vendosja në punë e burimit të ri Fushë Milot, në Qershor të vitit 2019, ka përmirësuar me ujë në zonat e shërbimit. Në të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë janë instaluar 48 depo uji me kapacitet total grumbullimi prej 37,500 m3.

Gjatësia totale e rrjetit të ujësjiellësit është rreth 985 km, nga ku 730 km rrjet shpërndarës dhe 255 km rrjet transmetimi.

III.2. Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve të auditimit:

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe

evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet e rëndësishme profesionale të bëra në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, u përgatit Raporti Përfundimtar i Auditimit.

III.2.1. Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Nga auditimi konstatohet që:

1. Titulli i gjetjes:	Mos respektim afati për zbatim rekomandimesh
Situata:	Nga Ujësjiellës Kanalizime Durrës sh.a. nuk është respektuar afati ligjor prej 6 muajsh nga data e njoftimit të Raportit të Auditimit, në lidhje me raportimin në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna.
Kriteri:	Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, pika 2.
Ndikimi:	Realizimi i rekomandimeve ndihmon shoqërinë UK Durrës sh.a. të arrijë objektivat dhe të përmbush misionin.
Shkaku	Mos respektimi i legjislacionit të KLSH.
Rëndësia:	E mesme
1.1 Rekomandimi:	UK Durrës sh.a., të marrë masa për njoftimin e KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, me qëllim përmirësimin e funksionimit të shoqërisë.

Sa i përket masave organizative, pas verifikimit mbi zbatimin e rekomandimeve situata paraqitet si më poshtë:

Janë në proces zbatimi rekomandimet nr. **11.1 dhe 12.1:**

11.1 Rekomandimi: Këshilli i Administrimit dhe Administratori i UK Durrës sh.a., të ngrejë një grup pune për analizimin e situatës, evidentimin e përgjegjësisë dhe marrjen e masave përkatëse. Nga grupi i punës të identifikohen të gjitha kontratat jo reale, të ç’regjistrohen nga sistemi i faturimit, të vlerësohet efekti financiar i tyre në vite, duke reflektuar dhe në pasqyrat financiare të raportuara, si dhe të merren masa për mospërsëritjen e këtyre praktikave.

- Me urdhrin e brendshëm nr. 2654 Prot., datë 04.09.2020 janë marrë masat mbi regjistrimin dhe saktësimin e të dhënave personale dhe adresën në kontratën e ujit si dhe me urdhrin nr. 3541 Prot., datë 03.12.2020 janë marrë masat për procesin e verifikimit të kontratave me plan tarifar aforfe dhe me tarifë shërbimi. Nga verifikimi i kryer nga grupi i auditimit, numri i abonentëve të pajisur me matës përkatës është rritur dhe numri i abonentëve që janë me tarifë aforfe është në ulje.

12.1 Rekomandimi: Administratori i shoqërisë të marrë të gjitha masat e nevojshme duke ngritur grupe pune me specialistë të fushës për krijimin e regjistrimit të aktiveve dhe ndarjen e tyre në artikuj të veçantë me qëllim paraqitjen me besueshmëri dhe saktësi si dhe uljen e riskut të menaxhimit të tyre.

- Me anë të urdhrit nr. 695 Prot. datë 24.02.2020 “ Për përgatitjen dhe dërgimin e dokumentacionit për shpronësim dhe regjistrimin e pasurive të paluajtshme të shoqërisë”, kanë dalë certifikatat e pasurive për disa nga objektet e Bashkisë Durrës.

Është zbatuar plotësisht rekomandimi nr. **6.1**:

6.1 Rekomandimi: Punonjësit e ngarkuar me urdhrin nr. 2109/2 prot, datë 07.08.2017 të Drejtorit të Përgjithshëm për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm, të marrin masa për zbatimin e rekomandimeve, që kanë rezultuar të pazbatuara dhe në proces, si dhe të kërkojnë në rrugë administrative duke ndjekur të gjitha shkallët e gjyqimit për arkëtimin e vlerave me pasojë financiare për shoqërinë UK Durrës sh.a..

-Me urdhrin nr. 2786/2 Prot. datë 17.09.2020 është kërkuar zbatimi i rekomandimit ku është arkëtuar vlera prej 22,162 lekësh.

Nuk është zbatuar rekomandim nr. **7.1**

7.1. Rekomandimi: Në vazhdimësi, UK Durrës sh.a., të ndjekë rendin kronologjik në likuidimin e detyrimeve ndaj operatorëve ekonomikë, duke shmangur riskun e krijimit të situatave me pasojë dëm ekonomikë për shoqërinë, të ardhura si pasojë e mosrespektimit të afateve të pagesës, sipas kushteve kontraktuale.

- Nga verifikimi i llogarisë së furnitorëve shihet që akoma ka Operatorë Ekonomik të pa likuiduar dhe të mbartur në vite dhe duke mos i likuiduar ato sipas rekomandimit të mësipërm.

Sa i përket masave shpërblim dëmi, pas verifikimit mbi zbatimin e rekomandimeve situata paraqitet si më poshtë:

Janë në proces zbatimi rekomandimet nr. **2.1, 3.1, 4.1, 5.1, 9.1, 10.1,**

2.1 Rekomandimi: Të kërkohej në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, **arkëtimi i vlerës prej 528,320 lekë**, përkatësisht nga shoqëria “L. VII” sh.p.k. si rrjedhojë e mos përfundimit të punimeve sipas kushteve të kontratës.

- Nga verifikimi kryer nga grupi i auditimit është hapur proces gjyqësor dhe çështja është akoma e papërfunduar.

3.1 Rekomandimi: Të kërkohej në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, **arkëtimi i vlerës prej 1,567,691 lekë**, përkatësisht nga shoqëria “S.T. A.” sh.p.k., si rrjedhojë e mos dorëzimit të mallit sipas kushteve të kontratës së rënë dakord midis palëve.

- Nga verifikimi kryer nga grupi i auditimit është hapur proces gjyqësor dhe çështja është akoma e papërfunduar.

4.1 Rekomandimi: Të kërkohej në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, **arkëtimi i vlerës prej 773,760 lekë**, përkatësisht nga shoqëria “I. O.” sh.p.k. si rrjedhojë e mos dorëzimit të mallit sipas kushteve të kontratës së rënë dakord midis palëve.

- Nga verifikimi kryer nga grupi i auditimit është hapur proces gjyqësor dhe çështja është akoma e papërfunduar.

5.1 Rekomandimi: Të kërkohej në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, **arkëtimi i vlerës prej 2,502,000 lekë**, përkatësisht nga shoqëria “S. & C. C.” sh.p.k. dhe grupit të marrjes në dorëzim, ku ky i fundit ka marrë mallin në dorëzim, por nuk është vërtetuar dhe provuar se malli është konform specifikimeve teknike të kërkuara.

- Nga verifikimi kryer nga grupi i auditimit është hapur proces gjyqësor dhe çështja është akoma e papërfunduar.

9.1 Rekomandimi: Të kërkohet në mënyrë ligjore duke ndjekur të gjitha shkallët administrative, **arkëtimi i vlerës 936,575 lekë** nga operatori ekonomik “L. VII” sh.a.. Kjo vlerë është përfituar në mënyrë të padrejtë nga ky operator ekonomik, pasi nuk ka zbatuar afatin maksimal të realizimit të kontratës.

- Nga verifikimi kryer nga grupi i auditimit është hapur proces gjygjësore dhe çështja është akoma e papërfunduar.

10.1 Rekomandimi: Të kërkohet në mënyrë ligjore duke ndjekur të gjitha shkallët administrative, arkëtimi i vlerës **189,861 lekë** nga operatori ekonomik “I.” shpk. Kjo vlerë është përfituar në mënyrë të padrejtë nga ky operator ekonomik, pasi nuk ka zbatuar afatin maksimal të realizimit të kontratës.

- Nga verifikimi kryer nga grupi i auditimit është hapur proces gjygjësore dhe çështja është akoma e papërfunduar.

Është zbatuar plotësisht rekomandimi nr **1.1:**

1.1 Rekomandimi: Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, **arkëtimi i vlerës prej 161,467 lekë**, përkatësisht nga shoqëria “P. I.” sh.p.k. si rrjedhojë e dorëzimit të mallit me 10 ditë vonesë.

Sa i përket masave për eliminimin e efekteve negative, pas verifikimit mbi zbatimin e rekomandimeve situata paraqitet si më poshtë:

Janë në proces zbatimi rekomandimet nr. **2.1, 3.1, 4.1, 5.1, 6.1, 7.1, 8.1, 9.1:**

2.1 Rekomandimi: Nga Administratori i shoqërisë, si dhe Këshilli i Administrimit të UK Durrës sh.a., të merren masa për të analizuar shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorim me efektivitet dhe ekonomikitet të fondeve publike **në vlerën prej 308,997 lekë**, vlerë e cila ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në procedurën e prokurimit të zhvilluar me objekt: “Rikonstruksion sheshi në ambientet e Impiantit të trajtimit të ujërave të ndotur”, si dhe të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, në mënyrë që të parandalohen raste të tilla në të ardhmen.

3.1 Rekomandimi: Nga Administratori i shoqërisë, si dhe Këshilli i Administrimit të UK Durrës sh.a., të merren masa për të analizuar shkaqet, arsyet e mungesës së dokumentimit të procesit të marrjes së mallit në dorëzim, në **vlerën prej 2,878,850 lekë**, vlerë e cila ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në procedurën e zhvilluar me objekt: “Lidhja e objekteve me rrjetin e ri, Lagja Nr. 13, Durrës”, si dhe të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, në mënyrë që të parandalohen raste të tilla në të ardhmen.

4.1 Rekomandimi: Nga Administratori i shoqërisë, si dhe Këshilli i Administrimit të UK Durrës sh.a. të merren masa për të analizuar shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorim me efektivitet dhe ekonomikitet të fondeve publike në vlerën 3,031,800 lekë, vlerë e cila ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në procedurën e prokurimit të zhvilluar me objekt: “Blerje pjesë këmbimi për automjete”, si dhe të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, në mënyrë që të parandalohen raste të tilla në të ardhmen.

5.1 Rekomandimi: Këshilli i Administrimit të analizojë në mënyrë të detajuar rastet e largimit nga puna, si dhe krijimin e detyrimeve të shtuara përmbarimore, duke evidentuar përgjegjësitë individuale, humbje të cilat janë në vlera të konsiderueshme, si dhe në të ardhmen të merren masa për ndjekjen me përgjegjësi të procedurave gjyqësore për dëmshpërblimet, që vijnë si rezultat i zgjidhjes së kontratës së punësimit pa shkaqe të arsyeshme.

6.1 Rekomandimi: Nga Këshilli i Administrimit të shqyrtohet vlera **267,600 lekë** e cila përbën efekt financiar negativ për UK Durrës sh.a., duke evidentuar përgjegjësitë, si dhe të merren vendimet përkatëse, në mënyrë që të parandalohen raste të tilla në të ardhmen.

7.1 Rekomandimi: Nga Këshilli i Administrimit të shqyrtohet vlera **5,476,440 lekë**, e cila përfaqëson diferencën ndërmjet tarifave përmbare më të paguara nga UK Durrës sh.a. dhe arkëtimit të kësaj tarife nga debitorët, pasi kjo vlerë përbën efekt financiar negativ për shoqërinë, si dhe të vlerësojë nëse kjo mënyrë arkëtimi është e përshtatshme për aplikim ose jo në të ardhmen.

8.1 Rekomandimi: Nga Titullari i UK Durrës sh.a., të shqyrtohet vlera **3,635,799 lekë** e cila përbën efekt financiar negativ për shoqërinë, e ardhur si pasojë e mosrakordimit me sistemin GPS dhe mungesën e kontrollit, si dhe të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren masat përkatëse, në mënyrë që të parandalohen raste të tilla në të ardhmen.

9.1 Rekomandimi: Nga Titullari institucionit dhe nga mbikqyrësat e punimeve të merren masa që në të ardhmen të eliminohen praktika të tilla për sa i përket kontratave të cilat janë sipërmarrje nga BOE, me qëllim që pagesat të kryhen në përputhje me % e zërave të punimeve të përcaktuara në kontratën e bashkëpunimit, për arsye se veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mund të çojnë në shmangie të detyrimeve tatimore.

- Përsa i përket gjetjeve të mësipërme të cilat konkludohen si fenomene, janë marrë masat nga ana e administratorit dhe janë diskutuar shkaqet nga Këshilli i Administrimit, duke përmirësuar gjendjen e institucionit dhe duke tërhequr vëmendjen personave përgjegjës mbi gjetjet e mësipërme.

Sa i përket procedurave të realizuara në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik, pas verifikimit mbi zbatimin e rekomandimeve situata paraqitet si më poshtë:

Janë në proces zbatimi rekomandimet nr. **1.1, 2.1, 3.1:**

1.1 Rekomandimi: AK të marrë masa për rritjen e efikasitetit në shpenzimet publike, duke zhvilluar procedura prokurimi në përmbushje të kriterëve ligjorë, kapaciteteve ekonomike, financiare dhe profesionale, në përzgjedhjen e ofertës më të mirë ekonomike në përputhje me nenin 53/3 të LPP, duke siguruar që Autoriteti Kontraktor të pranojë oferta të cilat janë të përballueshme, të qëndrueshme, të pakushtëzuara dhe të plotësimit të nevojave të saj. Titullari i AK të marrë masa që t'i kushtojë vëmendjen e duhur institucionale procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit nga komisionet e vlerësimit të ofertave, i dokumentacionit ligjor dhe administrativ i operatorëve ekonomik dhe ofertave të ofertuesve, miratimit të raporteve përmbledhëse, në përputhje me frymën së Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

2.1 Rekomandimi: Nga Titullari i UK Durrës sh.a të analizohet situata e krijuar në lidhje me zhvillimin e procedurave nën vlerën 800,000 lekë, pasi në rastin e blerje të mallrave dhe pajisjeve hidraulike ato e kanë kaluar në total këtë vlerë në vitin 2017. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren masat përkatëse, në mënyrë që të parandalohen raste të tilla në të ardhmen.

3.1 Rekomandimi: Nga UK Durrës sh.a., të merren masa për zhvillimin e procedurave standarde të prokurimit publik, të cilat janë objekt i Ligji Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, për përftimin e shërbimeve të kërkuara, me qëllim rritjen e konkurrencës dhe efektivitetit, si dhe mirëpërdorimin e fondeve publike.

- Sipas urdhrit nr. 2786 Prot. datë 17.09.2020 “Për zbatimin e detyrave funksionale” si dhe nga riorganizimi i sektorit janë marrë masat për uljen e dukurive të mësipërme dhe në përmirësimin e gjendjes së institucionit.

2. Titulli i gjetjes:	Rekomandime të cilat akoma nuk janë finalizuar.
Situata:	Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit për auditimin e ushtruar në Ujësjellës Kanalizime Durrës sh.a. administruar në KLSH me nr. 520/56 prot., datë 04.12.2020, janë rekomanduar gjithsej: - 12 masa organizative, nga të cilat janë zbatuar 8 masa, në proces zbatimi 3 masa dhe të pa zbatuara 1 masë. - 12 masa shpërblim dëmi, nga të cilat janë zbatuar 6 masa, në proces zbatimi 6 masa. - 9 masa për eliminimin e efekteve negative, nga të cilat janë në proces zbatimi 9 masa. - 3 masa për procedura të realizuara në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik, nga të cilat janë në proces zbatimi 3 masa. - 19 masa disiplinore, nga të cilat janë zbatuar 19 masa.
Kriteri:	Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15, germa “j”.
Efekti/Ndikimi:	Realizimi i rekomandimeve ndihmon shoqërinë UK Durrës sh.a. të arrijë objektivat dhe të përmbush misionin.
Shkaku	Nga ana e shoqërisë ka pasur përpjekje për realizimin e rekomandimeve, por nuk ka arritur t’i realizojë plotësisht.
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandimi:	UK Durrës sh.a., të marrë masa për realizimin e plotë të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, me synim realizimin e objektivave dhe në përmbushjen e misionit të shoqërisë.

Sa më sipër është mbajtur *Akt konstatimi nr.1* , datë 13.01.2023

Përsa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacion me shkresë nr.825/12 prot, datë 15.03.2023 “Kthim përgjigje Projekt Raporti” nga z. S. K., ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

Referuar rekomandimit pika 1.1 për arkëtimin e vlerës në mënyrë ligjore ndaj subjektit P.I. shpk, ju kemi vënë në dispozicion mandate arkëtimin e vlerës nga ana e subjektit. Pra vlera prej 161,467 lekë është arkëtuar nga ana e shoqërisë.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit të KLSH –së:

Në lidhje me observacionin e bërë nga ana e përfaqësuesit të subjektit z. S. K., është marrë në konsideratë dhe janë bërë ndryshimet përkatëse në Raportin Përfundimtar.

II.2.2 Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese (Këshilli Administrimit dhe Administratori), vendimet e marra dhe zbatimi i tyre.

UK Durrës sh.a. është një shoqëri me kapital 100% shtetëror, e regjistruar në datën 05.10.1994, e cila vepron në zbatim të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar dhe me dy nivele të sistemit të administrimit.

Riorganizimi i shoqërisë dhe statuti i ri është ndryshuar në zbatim të VKM Nr.04, datë 20.05.2016, ku sistemi i administrimit ka kaluar me një nivel, me këshill administrimi, si dhe aksionarë Bashkia Durrës, Bashkia Shijak, Bashkia Krujë, Bashkia Vorë dhe Bashkia Kurbin.

Në zbatim të VKM datë 11.05.2022 “Politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë, të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura” sistemi i administrimit ka kaluar me dy nivele dhe përbërja e aksionarëve është vendosur 51 % Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), dhe pjesa tjetër Bashkia Durrës, Bashkia Kavajë, Bashkia Shijak, Bashkia Krujë dhe Bashkia Rrogozhinë, sipas pjesëmarrjes në kapitalin e shoqërisë.

Asambleja e Aksionarëve

Kompetencat e Asamblesë janë të sanksionuara në ligjin nr. 9901 date 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, dhe në statutin e UK Durrës sh.a.

Përbërja e asamblesë në periudhën e auditimit është treguar si më poshtë:

Bashkia Durrës 76.4 %, Bashkia Shijak 11.6 %, Bashkia Krujë 6.8 %, Bashkia Vorë 2.8 % dhe Bashkia Kurbin 2.4 %.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, konstatohet se për periudhën objekt auditimi, nga asambleja janë marrë gjithsej 26 vendime, të cilat janë pasqyruar sipas viteve si më poshtë:

VITI 2018

Gjatë vitit janë marrë gjithsej 7 vendime, nga të cilat 6 prej tyre janë miratimi i pasqyrave financiare, miratimi i raportit të ecurisë vjetor, për vitin 2017, si edhe miratimi i ekspertit kontabël i autorizuar dhe audituesit ligjor për 6/mujorin dhe vitin 2018:

Në Vendimi nr. 8, datë 21.12.2018 është miratuar si më poshtë:

- Plani operacional financiar i vitit 2019;

- Shpërblimi i punonjësve mbi pagë në vlerën prej 7,000 lekë dhe fondi i shpërblimit në vlerën gjithsej 4,739,000 lekë;

- Organigrama e re për vitin 2019;

- Rritja e numrit të punonjësve të UK Durrës sh.a. nga 675 në 699 punonjës për vitin 2019;

- Rritja e fondit për blerjet në vlerë të vogël për vitin 2019 nga 20 mil lekë në 25 mil lekë.

Sa më sipër, nevoja për rritjen e numrit të punonjësve të shoqërisë është mbështetur nga burimi i ri i ujit Fushë-Milot dhe impianti i ri i trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura në Gjirin e Lalëzit.

VITI 2019

Gjatë vitit janë marrë gjithsej 6 vendime, nga të cilat miratimi i pasqyrave financiare, miratimi i raportit të ecurisë vjetor, për vitin 2018, si edhe miratimi i audituesit ligjor për 6/mujorin për vitin 2019, ndryshimet e statutit të shoqërisë, rritjen e numrit të punonjësve, si edhe rritjen e pagës minimale të punonjësve të shoqërisë, emërimet e këshillit drejtues dhe të administratorit, miratimi i planit operacional për vitin 2020, etj.

Në Vendimin e datës 21.01.2019 është miratuar rritja e pagës minimale në 26,000 lekë, sipas VKM Nr.809, datë 26.12.2018.

Me rritjen e pagës minimale është rritur fondi i pagave të personelit në vlerën prej 2,323,938 lekë dhe nga ky efekt janë përfshirë 92 punonjës.

Në Vendimin Nr. 4/1 datë 17.05.2019 është miratuar, në zbatim të plotë me VKM Nr.63 datë 27.01.2016, rikonfirmimi i anëtarëve të këshillit drejtues dhe të administratorit të shoqërisë, gjithashtu është miratuar shtimi i 34 punonjësve, duke rritur numrin e punonjësve në 733.

Në Vendimin e datës 30.12.2019 është miratuar rregullorja e rekrutimit të personelit etj.

VITI 2020

Gjatë vitit janë marrë gjithsej 6 vendime, nga të cilat miratimi i pasqyrave financiare, miratimi i raportit të ecuresë vjetor, miratimi i eksperteve kontabël për vitin 2019, miratimin e planit operacional për vitin 2021, ndryshimin e strukturës etj.

Në Vendimin Nr.4/3 datë 30.09.2020 është miratuar limiti i një overdrafti në bankat e nivelit të dytë, në limitin deri në shumën 100,000,000 lekë, për shkak të rritjes së çmimit të energjisë elektrike dhe rritjes së konsumit të saj me shtimin e burimit të ujit Fushë-Milot.

VITI 2021

Gjatë vitit janë marrë gjithsej 4 vendime, nga të cilat miratimi i pasqyrave financiare, miratimi i eksperteve kontabël për vitin 2020, miratimin e planit operacional për vitin 2022, ndryshimin e strukturës miratimin e ndryshimit të planit operacional për vitin 2021 etj.

Në Vendimin Nr.2 datë 26.05.2021 është miratuar rishikimi i planit operacional për vitin 2021, Në rishikimin e planit të sipërcituar është kërkuar rritja e numrit të punonjësve me 25 punonjës dhe përkatësisht 22 roje dhe 3 punonjës për nevoja të sektorëve të tjerë me kohë të plotë duke filluar nga 1 Qershor-31 Dhjetor 2021.

Në Vendimin Nr.4 datë 29.12.2021 është miratuar plani operacional për vitin 2022, rregullorja e brendshme, struktura dhe ndryshimi i numrit të punonjësve, në total 791.

VITI 2022

Gjatë vitit janë marrë gjithsej 3 vendime, rikonfirmimi në detyrë i anëtarëve të këshillit administrativ, deri në përfundimin e procesit të riorganizimit të shoqërisë sipas VKM nr.302 datë 11.05.2022. miratimin e pasqyrave financiare dhe raportit të ecuresë për vitin 2021 etj.

Në Vendimin Nr.3, datë 31.08.2022 është miratuar lirimi nga detyra e Z. S. K., administratorit dhe anëtarit të këshillit administrativ aktual për shkak të procesit të riorganizimit të shoqërisë, dhe komandimi deri në 31.12. 2022 i z. K. B. si administrator i saj.

Këshilli Administrativ

Në sistemin e administrimit me 1 nivel, këshilli administrativ kryen funksionin e administrimit dhe të mbikëqyrjes së bashku. Kompetencat e tij janë parashikuar në statutin e shoqërisë dhe janë në pajtim me kërkesat e Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar. Këshilli Administrativ është i përbërë nga 3 anëtar, ku njëri prej të cilëve zgjidhet kryetar. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, për periudhën objekt auditimi, nga Këshilli Administrativ janë marrë 25 vendime.

Administratori

Administratori i shoqërisë, drejton dhe përfaqëson shoqërinë lidhur me vënien në zbatim të politikave tregtare, Siguron mbajtjen dhe administrimin e duhur të librave dhe dokumenteve të kontabilitetit të shoqërisë. Kujdeset për përgatitjen dhe nënshkrimin e pasqyrave financiare vjetore, bilancin dhe raportin e performancës. Administratori zgjidhet nga këshilli administrativ i shoqërisë. Detyrat dhe përgjegjësitë e administratorit përcaktohen në statutin e Shoqërisë në përputhje me ligjin nr.9901, date 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”. Administratori është përfaqësuesi dhe drejtuesi ekzekutiv i shoqërisë.

Administratori i shoqërisë përgjigjet për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të shoqërisë nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në mënyrë të ligjshme me efektivitet dhe efikasitet.

Për periudhën e auditimit, administrator i shoqërisë ka qenë z. S. K. (16.10.2013-31.08.2022), Gjatë auditimit të dokumentacionit, të vënë në dispozicion, në periudhën gjatë veprimtarisë së shoqërisë nga ana e administratorit janë nxjerrë rreth 90 urdhra administrativ për mbarëvajtjen e aktivitetit.

II.2.3 Mbi hartimin, miratimin dhe realizimin e programit ekonomiko-financiar

Në zbatim të pikës 3 të programit të auditimit Nr.825/1 prot, datë 03.10.2022, i ndryshuar, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Planifikimi Operacional dhe Financiar i UK Durrës sh.a. për vitet 2018-2022;
- Raportime vjetore të UK Durrës sh.a. për treguesit kryesor për vitet 2018-9/ muji 2022;
- Relacione dhe raportime për planifikimin e buxhetit të UK Durrës sh.a. nga drejtoritë përkatëse;
- Regjistrat e prokurimeve të UK Durrës sh.a. për vitet 2018-2022 etj;

Shoqëria është pajisur me Liçensë, datë 23.09.2021 nga Komisioni Kombëtar Rregullator i Ujit, e rinovuar, për kryerjen e aktiviteteve si prodhimi, transporti, shpërndarja dhe furnizimi me ujë të pijshëm, instalimin e ujëmatësve, instalimin e pikëlidhjeve me rrjetin e shpërndarjes, azhurnimin e rrjetit të ujësjellës dhe kanalizimeve, largimin e ujërave të ndotura, trajtimin e ujërave të ndotura, shitjen e ujit me autobot. etj.

Shoqëria mbulon zonat e shërbimit të saj Bashkinë Durrës (Durrës, Ishëm, Katundi i Ri, Manës, Rrashbull, Sukth), Bashkinë Shijak (Shijak, Maminas, Gjepalaj, Xhafzotaj), Bashkinë Vorë (Prezë), Bashkinë Krujë (Bubq), Bashkinë Kurbin (Fushë Kuqe).

Gjatësia totale e rrjetit të ujësjellësit UK Durrës sh.a. është rreth 985 km, nga ku 730 km rrjet shpërndarës dhe 255 km rrjet transmetimi.

Shoqëria UK Durrës furnizohet me ujë nga 3 burime me ngritje mekanike si më poshtë:

-Stacioni Fushë- Kuqe, me 7 puse nëntokësore, nga ku me nëpërmjet linjës së transmetimit DN 700 CE e dërgon ujin nëpërmjet 12 elektro/pompa, për në qytetin e Durrësit në një distancë prej 40 km.

-Stacioni Fushë- Milot, me 6 puse nëntokësore, nga ku nëpërmjet linjës së transmetimit DN 700 GRP, e dërgon ujin me 8 elektropompa, për në qytetin e Durrësit në një distancë prej 54 km.

-Fushë -Krujë, me 5 puse nëntokësore dhe nëpërmjet linjës së transmetimit DN 500 CE e dërgon ujin me 4 elektropompa për në qytetin e Shijakut në një distancë prej 18 km.

Vendosja në punë e burimit të ri Fushë Milot, në Qershor të vitit 2019, ka dyfishuar orarin e shërbimit me ujë në zonat e shërbimit. Në të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë janë instaluar 48 depo uji me kapacitet total grumbullimi prej 37,500 m³.

Shoqëria ofron shërbimin e grumbullimit të ujërave të ndotura për qytetin e Durrësit dhe një pjesë të zonës Gjiri Lalzit.

Gjatësia totale e tubacioneve të kanalizimeve është rreth 240 km. Në zonën e qytetit kemi rrjet miks të ujërave të ndotura, ndërsa në zonën e plazhit nga Ura Dajlanit-Përroi Agait ka tubacione të ndara për kanalizimet dhe për ujërat e shiut.

Shoqëria zotëron 2 impiante trajtimi të ujërave të ndotura (ITUN), i pari, Impianti Vrrine me kapacitet 250,000 banorë, i cili përpunon dhe trajton ujërat e ndotura të zonës së qytetit, që grumbullohen nga 13 stacione pompimi, dhe i dyti, ITUN Gjiri i Lalzit, me kapacitet 15,000 banorë, që përpunon dhe trajton ujërat e ndotura të zonës turistike Gjiri i Lalzit të cilat grumbullohen me 4 stacione pompimi.

Nga auditimi rezulton si më poshtë:

3. Titulli i gjetjes:	Parregullsi në hartimin e programit ekonomik dhe financiar të shoqërisë.
Situata:	Rritja e ujit pa të ardhura e papranueshme. Në vitin 2021 uji pa të ardhura, i matur, rezulton në masën prej 35,145,971 m³, me një rritje prej 47.6 %, ose 11,336,320 m³ më shumë se në vitin 2018. Nga bilanci, humbja e ujit është 73.9 % në vitet 2018 dhe 2019, 79.5 % në vitin 2020, dhe 79.2 % në vitin 2021. Në vitin 2021, sasia prej 44,386,103 m³ ujë hyn në sistemin e UK Durrës SH.A. dhe 79.2 % e saj ose 35,145,971 m³ ujë nuk gjeneron të ardhura për shoqërinë. Nga ana e shoqërisë është vlerësuar se 33.6 % e sasisë së ujit që hyn në sistem, ose 14,931,439 m³ ujë/vit humbet nga lidhjet e paligjshme në rrjetin e transmetimit dhe të shpërndarjes. Gjithashtu, 35.8 % e sasisë së ujit që hyn në sistem ose 15,926,869 m³ ujë/vit, humbet nga rrjedhjet në rrjetin e transmetimit dhe të shpërndarjes. Rritja e ujit pa të ardhura tregon se, një pjesë e madhe e “klientëve”, por që zyrtarisht nuk janë të tillë dhe që realisht marrin ujë nga sistemi nuk faturohen dhe nuk e paguajnë atë. Shoqëria UK Durrës SH.A., për periudhën objekt auditimi, është karakterizuar nga një paqëndrueshmëri e lartë financiare. Rritja vjetore e të ardhurave (faturimi total), krahasuar me një vit më pare, rezulton përkatësisht 2.3 % në vitin 2019, -0.4 % në vitin 2020, dhe 6.5 % në vitin 2021. Norma e arkëtimit është llogaritur sipas kategorisë së arkëtimit korrent dhe të prapambetur. Gjithashtu, e para ka një ulje nga 79.8 % në vitin 2018 në 54 % në vitin 2021, dhe arkëtimi i prapambetur është rritur nga 17 % në vitin 2018 në 37 % në vitin 2021. Realizimi i shpenzimeve dhe investimeve është i paqëndrueshëm, përkatësisht 37 % në vitin 2018, 55 % në vitin 2019, 39 % në vitin 2020 dhe 156 % në vitin 2021. Sa më sipër, kjo ndodh se parashikimet e investimeve apo nevojat për shpenzime kryhen pa studime konkrete dhe analiza të plota me bazë risku. Kosto direkte e operimit për periudhën e auditimit ka rezultuar përkatësisht, 1,100,333,529 lekë në vitin 2018, 1,356,627,636 lekë në vitin 2019, 1,358,556,457 lekë në vitin 2020, dhe 1,596,645,895 lekë në vitin 2021. Në periudhën e auditimit, kosto mesatare direkte e operimit për njësi, për ujin e prodhuar është 35.76 lekë/m³ dhe për ujin e shitur 154.22 leke/ m³. Diferenca ndërmjet koston së shitjes dhe koston së prodhimit përbën koston shtesë joefektive në vlerën prej -118.46 leke/ m³, nga ku 20 % e saj ose 24 leke/ m³, përbën humbjen teknike të pranuar. Përsa më sipër, kjo situatë vjen kryesisht ngaqë shoqëria nuk ka organizuar dhe planifikuar mjaftueshëm burimet e saj, duke lejuar një rritje të papranueshme të ujit pa të ardhura. Planifikimi për buxhetin e shoqërisë është kryer mbi bazën e nevojave të krahasuara me një vit më pare, mbi bazën e kërkesave të veçuara, pa analiza

	të plota të riskut dhe të pambështetura në prioritetet konkrete dhe politika të qarta komerciale. Metodologjia e sipërcituar do të ishte efikase në rastin e humbjeve normale. Nga ana tjetër, shoqëria nuk ka regjistër risku, gjithashtu nuk është caktuar dhe nuk funksionon koordinatori i riskut dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik. Sa më sipër, shoqëria ka pësuar një humbje financiare, përkatësisht për vitin 2019 në vlerën -201,045,754 lekë, për vitin 2020 në vlerën prej -216,213,668, për vitin 2021 në vlerën prej -370,713,260 lekë, si edhe për 9/Mujorin e vitit 2022 në vlerën prej -498,412,304 lekë.
Kriteri:	Neni 8⁷, pika 8, shkronjat a) dhe b) të Ligjit Nr.10 296, datë 08.07.2010, Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, i ndryshuar; Neni 10⁸, pika 2 e Ligjit Nr.10 296, datë 08.07.2010, Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, i ndryshuar.
Efekti/Ndikimi:	Objektiva të perealizuara. Parashikimi jorealit i treguesve të performancës dhe humbje financiare e shoqërisë.
Shkaku	Mungesa e veprimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit në fushën e planifikimit dhe zbatimit të buxhetit.
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandimi:	Administratori i shoqërisë UK Durrës sh.a. të marrë të gjitha masat për të ngritur një sistem eficient të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar, krijimin e regjistratit të riskut dhe funksionimin e grupit të menaxhimit strategjik. Hartuesit e programit ekonomiko-financiar duhet të mbështeten në analiza të plota me bazë risku si edhe të orientuar nga prioritetet të përcaktuara më parë, me qëllim evidentimin dhe korrigjimin e shkaqeve që ndikojnë në mosrealizimin e objektivave të shoqërisë.

Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi z. S. K. në cilësinë Nëpunësit Autorizues.

Sa më sipër është mbajtur *Akt konstatimin Nr. 3* datë 13.01.2023.

Përsa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacion me shkresë nr.184/57 prot, datë 13.03.2023 mbi projekt-raportin e KLSH ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

Sa i përket caktimit të Grupit të Menaxhimit Strategjik, referuar dhe në interpretim të nenit 27 të Ligjit Nr.10 296, datë 08.07.2010, Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, i ndryshuar, GMS ekziston në shoqëri dhe kryen raportime periodike pranë Këshillit të Administrimit. Gjithashtu, referuar nenit 10 të ligjit të sipërcituar koordinatori i menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe

⁷ Titullarët e njësive publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto kompetenca kryesore:

a) Miratimin e politikave dhe monitorimin e objektivave të njësive publike që ata drejtojnë, të planeve strategjike e vjetore, përfshirë strategjinë e menaxhimit të riskut dhe të plan-veprimeve për arritjen e objektivave.

b) Ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik të njësive publike, në përputhje me kërkesat e nenit 27 të këtijligji.

⁸ Në përmbushje të përgjegjësisë së tij, nëpunësi autorizues mund të delegojë disa prej detyrave të veta për koordinimin e menaxhimit financiar dhe kontrollin dhe koordinimin e riskut, punonjëseve pjesë e strukturës së financës.

koordinator i riskut është NA . Në interpretim të këtij neni funksionet e koordinatorit të riskut kryhen nga Administratori.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit të KLSH –së:

Nga auditimi, për periudhën objekt auditimi, në kundërshtim me nenin 27 të Ligjit Nr.10 296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, nuk rezulton një vendimarrje nga ana e GMS. Nuk rezulton që Grupi të mbledhet periodikisht, nuk ka minuta takimi dhe vendime apo raporte të tij.

Shoqëria nuk ka një plan të minimizimit të riskut, i cili duhet të jetë pjesë e monitorimit nga ana e GMS për rishikimin e menaxhimit të riskut, në mënyrë që Grupi Menaxhimit Strategjik të dallojë nëse ndryshon profili i riskut gjatë kohës.

Menaxhimi i riskut duhet të mundësojë vendimarrjen cilësore, parashikimin më të mirë dhe optimizimin e burimeve në dispozicion, që kanë të bëjnë me prioritetet dhe shmangien e problemeve të ardhshme që mund të shfaqen gjatë punës për arritjen e objektivave të vendosura.

Sa më sipër, nga auditimi nuk rezulton korrespondencë ndërmjet koordinatorit të riskut dhe strukturave menaxhuese për identifikimin e risqeve, që shqetësojnë shoqërinë.

Programet e punës nuk përfshijnë risqet e proceseve.

Për arsyet, sa më sipër, sistemi i MFK nuk është implementuar në një nivel të ulët dhe sistemi i menaxhimit financiar dhe kontrollit nuk funksionon mjaftueshëm.

Nga ana tjetër, planifikimi për buxhetin e shoqërisë kryhet mbi bazën e nevojave të krahasuara me një vit më parë, pa analiza të plota të riskut dhe të pambështetura në politika të qarta. Kjo do të ishte e mjaftueshme në rastin kur të gjithë klientët që realisht marrin ujën nga sistemi do të paguanin.

Por, në rastin e një situate të rëndë, me rritje të lartë të ujit pa të ardhura, investimet dhe nevojat për shpenzime do të duhet të mbështeten me analiza risku dhe prioritetet të qarta, në mënyrë që të ndihmojë shoqërinë për planifikimin e indikatorëve sa më real të performancës.

Për këto arsye, sa më sipër, observacioni juaj nuk pranohet.

II.2.4 Mbi zbatimin e strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore. Zbatimi i ligjshmërisë gjatë procesit të rekrutimit dhe largimit të punonjësve nga puna

-Për vitin 2018, Ujësjellës Kanalizime Durrës sh.a. ka parashikuar në buxhet për zërin *shpërblime dhe ndihma ekonomike* vlerën prej 7.000.000 lekë nga të cilat janë ezauruar vlera prej 6.814.000 lekë ose 97.3 % në zërat si më poshtë :

Viti 2018	Ndihma Ekonomike	Shpërblim Pensioni	Shpërblim	Shpërblim fund viti	Shpërblim lindje	Totali Vjetor
Vlera në Lekë	790.000	707.000	225.000	4.739.000	353.000	6.814.000

-Për vitin 2019, Ujësjellës Kanalizime Durrës sh.a. ka parashikuar në buxhet për zërin *shpërblime dhe ndihma ekonomike* vlerën prej 10.000.000 lekë nga të cilat janë ezauruar vlera prej 1.937.000 lekë ose 19.37 % në zërat si më poshtë :

Viti 2019	Ndihma ekonomike	Shpërblim pensioni	Shpërblim lindje	Totali vjetor
Vlera ne leke	550.000	1.087.000	300.000	1.937.000

Përsa i përket orëve jashtë orarit zyrtar të punës, në buxhetin e vitit 2019, Shoqëria ka parashikuar një vlerë prej 1.900.406 Lekë nga të cilat gjatë vitit kalendarik 2019 ka ezauruar vlerën prej

1.337.650 Lekë ose 70.4 %, kjo për punonjës të cilët kanë punuar jashtë orarit zyrtar të punës gjatë avarive në sistemin e shpërndarjes së ujit të pijshëm.

-Për vitin 2020, Ujësjellës Kanalizime Durrës sh.a. ka parashikuar në buxhet për zërin *shpërblime dhe ndihma ekonomike* vlerën prej 2.500.000 lekë nga të cilat janë ezauruar vlera prej 2.266.000 lekë ose 90.64 % në zërat si më poshtë:

Viti 2019	Ndihma ekonomike	Shpërblim pensioni	Shpërblim lindje	Totali vjetor
Vlera ne leke	390.000	1.526.000	350.000	2.266.000

Përsa i përket orëve jashtë orarit zyrtar të punës, në buxhetin e vitit 2020 Shoqëria ka parashikuar një vlerë prej 4.000.000 Lekë nga të cilat gjatë vitit kalendarik 2020 ka ezauruar vlerën prej 1.802.061 Lekë ose 45.05% kjo për punonjës të cilët kanë punuar jashtë orarit zyrtar të punës gjatë avarive në sistemin e shpërndarjes së ujit të pijshëm apo edhe avarive në sistemin e kanalizimeve.

-Për vitin 2021, Ujësjellës Kanalizime Durrës sh.a. ka parashikuar në buxhet për zërin *shpërblime dhe ndihma ekonomike* vlerën prej 3.500.000 leke nga të cilat janë ezauruar vlera prej 3.152.000 leke ose 90.06 % në zërat si më poshtë:

Viti 2019	Ndihma ekonomike	Shpërblim pensioni	Shpërblim lindje	Totali vjetor
Vlera ne leke	885.000	2.067.000	200.000	3.152.000

Përsa i përket orëve jashtë orarit zyrtar të punës, në buxhetin e vitit 2021 Shoqëria ka parashikuar një vlerë prej 3.000.000 Lekë nga të cilat gjatë vitit kalendarik 2021 ka ezauruar vlerën prej 1.897.544 Lekë ose 63.25% kjo për punonjës të cilët kanë punuar jashtë orarit zyrtar të punës gjatë avarive në sistemin e shpërndarjes së ujit të pijshëm apo edhe avarive në sistemin e kanalizimeve.

Përsa i përket rekrutimit të punonjësve në shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Durrës, publikimi i vendeve të reja të punës afishohet në faqen zyrtare të shoqërisë dhe ku më tej zhvillohet procedura duke u bazuar në ligjin mbi Nr.7961, datë 12.7.1995 i ndryshuar.

II.2.5 Mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë, bankë dhe blerjet me vlera të vogla (shpenzimet administrative, për automjetet, udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit, sponsorizimet, etj.)

Prokurimet në vlerë të vogël (përfshirë blerjet emergjente) janë parashikuar gjithsej në regjistrat e prokurimeve:

nr.2916/6 prot, datë 01.12.2017, për vitin 2018 në vlerën prej 20,000,000 lekë pa tvsh;
nr.3088/4 prot, datë 28.11.2018, për vitin 2019 në vlerën prej 25,000,000 lekë pa tvsh;
nr.3454 prot, datë 04.12.2019, për vitin 2020 në vlerën prej 30,000,000 lekë pa tvsh;
nr.3480 prot, datë 27.11.2020, për vitin 2021 në vlerën prej 30,000,000 lekë pa tvsh;
dhe nr.6483/1 prot, datë 02.12.2021, në vitin 2022 në vlerën prej 25,754,451 lekë pa tvsh (25,000,000 lekë toptan dhe procedura të parashikuara 754,451 lekë), ku gjithsej arrin vlerën prej **130,754,451 lekë** pa TVSH).

Prokurimet në vlerë të vogël+emergjencën janë realizuar gjithsej në vlerën **96,259,397 lekë**, përkatësisht për vitin 2018 në vlerën prej 19,897,344 lekë, për vitin 2019 në vlerën prej 23,470,591 lekë, në vitin 2020 në vlerën prej 19,615,089 lekë, në vitin 2021 në vlerën prej 23,396,447 lekë, dhe në 9/mujorin e vitit 2022 në vlerën prej 9,879,926 lekë.

Nga auditimi është konstatuar si më poshtë:

4. Titulli i gjetjes:	Parregullsi në parashikimin e prokurimit në vlerë të vogël.
Situata:	Në 8 raste evidentohet copëzim fondesh, nga ku shoqëria nuk ka marrë parasysh grupin e mallrave apo shërbimeve të ngjashme, të cilat zakonisht duhet të prokurohen njëherësh, me qëllim parandalimin e shmangies të procedurave konkurruese të prokurimeve. Gjithashtu, shoqëria nuk planifikon natyrën, sasinë dhe llojet e kontratave, që do të prokurohen me këtë procedurë prokurimi, por brenda shumës totale të parashikuar realizon procedurat e prokurimit në vlerë të vogël sipas nevojës. Në vitin 2019 është kryer shërbimi i ngjashëm riparim pjesë motorike dhe xhenerike të mjeteve me targa DR..., sipas faturës nr.10, datë 23.07.2019 në vlerën prej 450,000 lekë pa TVSH, si edhe AA ..., sipas faturës nr.110 datë 25.02.2019 në vlerën prej 777,000 lekë pa TVSH me të njëjtin operator ekonomik A. G. Të dy procedurat së bashku rezultojnë në vlerën 1,227,000 lekë, që tejkalojnë me 227,000 lekë prapun e procedurës së prokurimit në vlerë të vogël. Në vitin 2021 është kryer shërbimi i ngjashëm riparim pjesë motorike dhe xhenerike të mjeteve kamion HOËO në vlerën prej 796,200 lekë, karroofiçina në vlerën prej 980,000 lekë, Ford Ranger në vlerën prej 469,333 lekë. Procedurat e sipërcituara së bashku rezultojnë në vlerën 2,245,533 lekë, që tejkalojnë me 1,245,533 lekë prapun e procedurës së prokurimit në vlerë të vogël. Në vitin 2022 është kryer shërbimi i ngjashëm riparim pjesë motorike dhe xhenerike mjeteve Riparim mjeti Hyunday (Galloper), targa DR.... në vlerën prej 301,666.67 lekë, Ford Ranger me targa AA...në vlerën prej 984,533, Ford Ranger AA..... në vlerën prej 690,000 lekë. Procedurat e sipërcituara së bashku rezultojnë në vlerën 1,976,199.67 lekë, që tejkalojnë me 976,199.87 lekë prapun e procedurës së prokurimit në vlerë të vogël. Mjetet motorike të sipërcituara me shërbime të ngjashme, të cilat duhet të jenë të planifikueshme në mënyrë periodike nga specialistët e shërbimeve. nuk janë pjesë e linjave teknologjike dhe objekt i avarive në proceset kryesore, të cilat kërkojnë kryerjen e detyruar të riparimit, për të eliminuar defektin dhe rivënien në punë të procesit (psh. stacionet e pompimit, linjat e transmetimit, depot e ujit etj). Sa më sipër, prokurimet e sipërcituara janë kurdoherë të planifikueshme.
Kriteri:	Nenin 56 ⁹ , pika 2, e Vendimit Nr.285 datë 19.05.2021; Pika 3 ¹⁰ të Udhëzimit Nr.03, datë 08.01.2018
Efekti/Ndikimi:	Copëzimi fondeve apo ndarja e kontratave

⁹ Autoriteti Kontraktor planifikon natyrën, sasinë dhe llojet e kontratave, që do të prokurohen me këtë procedurë prokurimi.

Në asnjë rast, autoriteti kontraktor në momentin e planifikimit të nevojave të tij, nuk duhet të përdorë procedurën e prokurimit me vlerë të vogël, si mundësi për të pjestuar vlerën e kontratës për shmangien nga procedurat e prokurimit.

¹⁰ Kjo procedurë do të përdoret për blerjen e një grup mallrash, kryerjen e shërbimeve apo punëve të ngjashme, që kanë të njëjtin funksion kryesor apo që kanë të njëjtin emërtim në planin e shpenzimeve.

Shkaku	Nuk kuptohet dhe zbatohet kuadri ligjor dhe rregullator
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandimi:	Administratori i shoqërisë ose personi i autorizuar dhe personi përgjegjës i prokurimeve të marrin të gjitha masat që në hartimin e regjistrit të prokurimeve të parashikohen të gjitha procedurat e blerjes së mallrave, punëve dhe shërbimeve, që do të prokurohen në vlerë të vogël, me qëllim që të shmangë përdorimin e paplanifikuar dhe të parregulluar të fondeve publike.

5. Titulli i gjetjes:	Parregullsi gjatë blerjeve në rastet emergjente.
Situata:	Në 63 raste të blerjeve emergjente, gjithsej në vlerën prej 3,180,666 lekë, shoqëria ka përdorur procedurën e blerjeve shkresore kur blerjet nuk kanë qenë në kushtet e emergjencës, d.mth. në kushtet e ndodhjes të një ngjarje të rastit, ngjarje e cila nuk mund të parashikohej në fillim të vitit, për kë arsye këto shpenzime janë konsideruar pa efektivitet ekonomik. Në vitin 2018, në 19 procedura emergjente, konkretisht: Blerje aparate fotografike, blerje bojë për lyerje zyre, blerje brava dhe aksesori, blerje brava të jashtme për repartin mekanik, blerje brava durali, blerje brava për sektorin e shërbimeve, blerje brava sekrete, blerje brava për degën teknike, blerje brava komplet dhe dryna 38 mm, blerje dekorime festime, blerje doreze dere, blerje libra dorëzimi, blerje regjistër korrespondence A3, drejtim dhe lyerje dere kolone mjeti, Kolaudim për objektin <i>“Rikonstruktion sheshi në Impiantin e Trajtimit të Ujërave të Ndotura”</i>, Kolaudim <i>“Rehabilitim i linjës së furnizimit të Depos Shkallë”</i>, Mobilje për mbajtje dokumentesh, Ndërrim parakolpi dhe parafango, Profile alumini dopio xham dhe mentesha, shpenzime me efekt negativ financiar, gjithsej në vlerën prej 508,621 lekë. Në vitin 2020, në 17 procedura emergjente, konkretisht, Blerje adeziv dhe pecikllaz për tabela sinjalizuese, Blerje alkool dhe xhel dezinfektues, Blerje aparat sapuni, Blerje bexha për personelin, Blerje bojë për lyerje, Blerje higjienizues, Blerje higjienizues dhe maska, Blerje letër me logon e UK Durrës sh.a. , Blerje libër dorëzimi, Blerje libreza uji, Blerje maska pa valvul, Blerje motor sharre, Blerje ngrohëse elektrike për zyra, Blerje tavolinë zyre me xham, Blerje zarfesh, Drejtim llamarine dhe lyerje mjeti, shpenzime me efekt negativ financiar, gjithsej në vlerën prej 902,043 lekë. -Në vitin 2021, në 16 procedura emergjente, konkretisht Blerje kalendari, blerje zarfa me logo, blerje karroce betoni me gome, blerje letër A4 me koke, blerje bexhe personeli, blerje kondicioneri, veshje të nevojshme për mbarëvajtjen e punës, çizme xhaketa shiu, libër protokolli, libër dorëzimi, blerje gardh kopshti, karrige, tavoline alumin-druri, set kostume pune, blerje blloqe urdhër pune, blerje adeziv makine, blerje kondicioner për nevoja të UK Durrës sh.a. komodinash me celes, shpenzime me efekt negativ financiar, gjithsej në vlerën prej 1,186,082 lekë.

	Në vitin 2022, në 11 raste, konkretisht blerje materiale kangjella hekuri për zyrën e Arshivës, siguracion TPL për mjetin me targe AE, përkthime për procedurën mbi kufirin e larte monetar "Blerje materiale hidraulike", blerje mandate arkëtimi, përkthime për procedurën mbi kufirin e larte monetar "Blerje materiale dhe pajisje elektrike, vegla, pajisje mekanike", Blerje adesiv dhe baneri për veshjen e zyrës së Sukthit, blerje makine grirëse për letra, blerje detergjente, blerje dosje kartoni për arshivën, blerje karrige për nevojat e UK Durrës sh.a. , blerje vetratë +dere për ambientet e UK Durrës sh.a. Autoriteti Kontraktor ka përdorur procedurën e blerjeve shkresore në raste emergjente kur blerjet nuk kanë qenë në kushtet e emergjencës, në vlerën gjithsej prej 583,920 lekë , dhe se këto shpenzime konsiderohen pa efektivitet.
Kriteri:	Në kundërshtim me Udhëzimin Nr.3 ¹¹ , datë 08.01.2018, të Agjencisë Prokurimeve Publike, i ndryshuar me Udhëzimin Nr.05, datë 25.06.2021 të APP.
Efekti/Ndikimi:	Kryerja e shpenzimeve pa efektivitet ekonomik, në vlerën prej 3,180,666 lekë , në procedurat e blerjeve, që nuk janë në kushte emergjente.
Shkaku	Nuk kuptohet dhe zbatohet kuadri ligjor dhe rregullator.
Rëndësia:	E Lartë.
Rekomandimi:	Administratori i shoqërisë të analizojë situatën e krijuar dhe të përcaktojë shkallën e përgjegjësisë të personave përgjegjës. Gjithashtu, administratori duhet të sigurojë që të përfshijë në rregulloret apo manualët përkatëse klasifikimin e rasteve emergjente sipas natyrës së proceseve kryesore të aktivitetit të shoqërisë, me qëllim parandalimin e rasteve abuzive në shpenzimin e fondeve publike.

6. Titulli i gjetjes:	Parregullsi në procesin e vlerësimit të prokurimit
Situata:	Në 6 raste, nga dosjet e kontrolluara, operatorët ekonomikë fitues rezultojnë me 2 oferta të ndryshme për të njëjtën objekt prokurimi, njëra ofertë e paraqitur gjatë verifikimit në treg për vlerësimin e fondit limit, dhe tjetra në vlerë më të ulët, gjatë zhvillimit të procedurës elektronike të prokurimit. Në vitin 2018_Procedura e prokurimit me objekt “Riparim i pompës kineze H 250 m dhe Q 100 lit/s ” me numrin e referencës REF-52375-08-07-2018. Në njoftimin e llogaritjes së fondit limit nr.2397/2 prot, datë 07.08.2018, është administruar oferta e F. A. në shumën prej 647,000 lekë. Në të njëjtën kohë, sipas procesverbalit të komisionit të vlerësimit nr.2397/7 prot., datë 09.08.18, oferta e këtij operatori është konstatuar e ndryshuar dhe në vlerën më të ulët prej 590,000 lekë për të njëjtin objekt prokurimi. Procedura e prokurimit me objekt “Shërbim riparim pompe centrifugale për stacionin Fushë Kuqe” dhe numrin e referencës REF-78107-07-05-2018.

¹¹ Përfshirë, për blerjen e mallrave, apo kryerjen e shërbimeve nga autoriteti kontraktor, vlera e përlogaritur e të cilave gjatë gjithë vitit kalendarik është në kufijtë e procedurës së prokurimit në vlerë të vogël, në rast të krijimit të situatës emergjente, autoriteti kontraktor mund të përdorë procedurën e prokurimit në vlerë të vogël në formë shkresore, sipas formularit standard Nr. 4, në një vlerë deri 100,000 lekë gjatë gjithë vitit.

Në njoftimin e llogaritjes së fondit limit nr.2201/2 prot., datë 05.07.2018 është prezantuar oferta e F. A. në shumën prej 760,000 lekë, e administruar nga komisioni i prokurimit. Në të njëjtën kohë, sipas procesverbalit të vlerësimit nr.2201/9 prot, datë 11.07.2018 oferta e këtij operatori është konstatuar e ndryshuar dhe në vlerën më të ulët prej 586,000 lekë.

Në vitin 2019_Procedura e prokurimit me objekt “Furnizim vendosje materiale elektrike të tensionit të mesëm (TM) në Fushë Kuqe” me numrin e referencës REF-35875-09-13-2019.

Në njoftimin e llogaritjes së fondit limit nr.2609/2 datë 13.09.2019, drejtuar Komisionit të Prokurimit në Vlerë të Vogël, është administruar si një nga 3 ofertat ajo e operatorit ekonomik HTM SHPK në shumën prej 730,500 lekë. Në të njëjtën kohë, në procesverbalin e vlerësimit të komisionit të prokurimit nr.2609/6 prot., datë 17.09.2019 oferta e HTM SHPK sipas SPE është konstatuar në vlerën më të ulët prej 619,000 lekë.

Procedura e prokurimit me objekt “Riparim Fadrome” e mjetit me targë AA 125 AB modeli JCB 3CX, është kryer me Urdhrin e Prokurimit Nr.94/12 datë 13.02.2019.

Në njoftimin e llogaritjes së fondit limit nr.94/3 datë 04.02.2019, drejtuar Komisionit të Prokurimit në Vlerë të Vogël, është administruar oferta me nr.267 prot, datë 04.02.2019 e operatorit ekonomik A. G. në shumën prej 783,100 lekë, si një nga ofertat e mara gjatë studimit të tregut. Në të njëjtën kohë, në procesverbalin e vlerësimit të komisionit të prokurimit nr.94/14 prot, datë 15.02.2019 oferta e këtij operatori është konstatuar e ndryshuar në një vlerë më të ulët prej 777,000 lekë.

Në vitin 2021 Procedura e prokurimit me objekt “Riparim mjeti Renault” me numrin e referencës REF-90399-03-18-2021.

Në njoftimin e llogaritjes së fondit limit nr.1256/5 datë 18.03.2019, drejtuar Komisionit të Prokurimit në Vlerë të Vogël, është administruar oferta me nr.1256/3 prot, datë 17.03.2021 e operatorit ekonomik Of E.F. A. shumën prej 760,000 lekë, si një nga ofertat e mara gjatë studimit të tregut. Në të njëjtën kohë, në procesverbalin e vlerësimit të komisionit të prokurimit nr.1256/9 prot, datë 19.03.2021 oferta e këtij operatori është konstatuar e ndryshuar në një vlerë më të ulët prej 710,000 lekë.

Procedura e prokurimit me objekt “Blerje materiale për elektropompën zhytëse Sulzer 15 kE” me numrin e referencës REF-16662-12-29-2021.

Në njoftimin e llogaritjes së fondit limit nr.6789/6 datë 23.12.2021, drejtuar Komisionit të Prokurimit në Vlerë të Vogël, është administruar oferta me nr.6789/3 prot, datë 23.12.2021 e operatorit ekonomik E.F. A. shumën prej 480,000 lekë, si një nga ofertat e mara gjatë studimit të tregut. Në të njëjtën kohë, në procesverbalin e vlerësimit të komisionit të prokurimit nr.6789/10 prot, datë 30.12.2021 oferta e këtij operatori është konstatuar e ndryshuar në një vlerë më të ulët prej 465,000 lekë pa TVSH.

Në zbatim të pikave 1 dhe 3 të Udhëzimit Nr.11 datë 30.05.2018, të Agjencisë Prokurimit Publik, komisioni i prokurimit ka detyrimin të krahasojë ofertat e operatorëve ekonomik me fondin limit të përcaktuar më parë nga autoriteti kontraktor, me qëllim që oferta e OE të jetë sa më reale.

	Komisioni i prokurimit në vlerë të vogël është vënë në dijeni jo vetëm për fondin limit të objektit të prokurimit, por edhe të ofertave të administruara gjatë studimit të tregut, që rezultojnë të jenë në të njëjtën kohë edhe me ofertat e prezantuara në sistemin elektronik.
Kriteri:	Në kundërshtim me pikën 3 ¹² të nenit 63, të VKM Nr.914, datë 29.12.2014, i ndryshuar, dhe në kundërshtim me pikën 4, neni 79 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021
Efekti/Ndikimi:	Deformim i konkurrencës.
Shkaku	Nuk kuptohet dhe zbatohet kuadri ligjor dhe rregullator.
Rëndësia:	E Lartë.
Rekomandimi:	Administratori i shoqërisë të analizojë situatën e krijuar dhe të përcaktojë shkallën e përgjegjësisë të personave përgjegjës.

Për sa më sipër, ngarkohen me përgjegjësi:

- znj. A.B., me cilësinë e anëtarit të komisionit të prokurimeve në vlerë të vogël.
- znj. D. B., me cilësinë e anëtarit të komisionit të prokurimeve në vlerë të vogël.
- z. D.SH. , me cilësinë e anëtarit të komisionit të prokurimeve në vlerë të vogël.
- z. G.S., me cilësinë e anëtarit të komisionit të prokurimeve në vlerë të vogël.
- znj. T.S., me cilësinë e anëtarit të komisionit të prokurimeve në vlerë të vogël..

Sa më sipër është mbajtur *Akt konstatimin Nr. 4* datë 13.01.2023.

Përsa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacion me shkresë nr.184/57 prot, datë 13.03.2023 mbi projekt-raportin e KLSH ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

Lidhur me ekzistencën e 2 ofertave të ndryshme për të njëjtën operator ekonomik dhe objekt prokurimi ju parashtrojmë pyetjet si më poshtë:

Së pari, ju shpjegoni se oferta e paraqitur në SPE e “enkriptuar”, kur “dekriptohet” nuk është e njëjtë me vlerën e që operatori ekonomik ka paraqitur gjatë përlllogaritjes së fondit limit. Në rast se do të dihej vlera fikse me të cilën do të ofertojë OE në sistem në momentin e zhvillimit të procedurës ç’farë kuptimi ka “enkriptimi”i vlerës në sistem, kur kjo i është bërë e ditur komisionit dhe grupit të përlllogaritjes së fondit limit?

Së dyti, si duhet të veprojë komisioni i vlerësimit të ofertave për OE , të cilët kanë dhënë një nga tre ofertat në treg për llogaritjen e fondit limit dhe në sistemin elektronik një ofertë ndryshe, për arsyet që mund të dijë vetëm OE, a duhet t’i skualifikojë ato? Kush është baza ligjore?

Së treti, cila është përgjegjësia dhe si duhet të veprojë komisioni në këto raste, meqenëse në asnjë rast të refuzimit të ofertave të parashikuara, nuk përmendet krahasimi i ofertave të përlllogaritjeve të fondit limit me ofertat e ngarkuara në SPE?

Qëndrimi i Grupit të Auditimit të KLSH –së:

Teknikisht, vlerat me të cilat konkurrojnë operatorët ekonomikë janë vlera të “enkriptuara”, që do të thotë që nuk mund të bëhen të ditura para datës së caktuar për hapjen dhe pranimin e ofertave, dhe kjo për arsyen e vetme të ruajtjes së transparencës.

¹² Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vetëm një ofertë, me përjashtim të rasteve kur kërkohen oferta alternative.

Nga auditimi është konstatuar se operatorët ekonomikë fitues rezultojnë me nga 2 oferta të administruara nga autoriteti prokurues për të njëjtën objekt prokurimi, njëra ofertë e paraqitur gjatë verifikimit në treg për saktësimin e fondit limit, dhe tjetra e ndryshuar dhe më e ulët, gjatë zhvillimit të procedurës elektronike të prokurimit.

Në fakt, komisioni i prokurimit në vlerë të vogël është njohur jo vetëm me fondin limit të objektit të prokurimit, por edhe me ofertat e operatorëve, në këtë rast operatorët fitues, të administruara bashkëngjitur procesverbalit të vlerësimit të fondit limit, të cilat rezultojnë pothuajse në një kohë me ofertat e prezantuara në SPE.

Në të njëjtën kohë, meqenëse ofertat e prezantuara nga operatorët fitues në sistemin elektronik rezultojnë në një vlerë më të ulët, cila do qoftë arsyeja, kjo ka sjellë deformimin e procesit të krahasimit të ofertave me fondin limit, për arsye se baza krahasuese ka ndryshuar me ndryshimin e ofertës së operatorëve të sipërcituar.

Detyrimi i krahasimit të ofertave me fondin limit, nga ana e komisionit të vlerësimit, është parashikuar në zbatim të pikave 1 dhe 3 të Udhëzimit Nr.11 datë 30.05.2018, të Agjencisë Prokurimit Publik, ku komisioni i prokurimit ka detyrimin të krahasojë ofertat e operatorëve ekonomik me fondin limit të përcaktuar më parë nga autoriteti kontraktor, me qëllim që oferta e OE të jetë sa më reale.

Fakti që ofertat e operatorëve fitues janë administruar në të njëjtën kohë, nuk i japi të drejtë subjektit të audituar që të mendojnë se ofertat e prezantuara për llogaritjen e fondit limit janë në një funksion orientues dhe si të tilla nuk kanë të bëjnë me ofertën e prezantuar në SPE.

Sa më sipërm, jemi të mendimit se ekzistenca e 2 ofertave të sipërpërmendura, bie në kundërshtim me pikën 3 të nenit 63, të VKM Nr.914, datë 29.12.2014, i ndryshuar, dhe në kundërshtim me pikën 4, neni 79 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, për pasojë ka shkaktuar deformimin e vlerësimit dhe të konkurrencës në procesin e prokurimit.

Për këto arsye, sa më sipër, observacioni juaj nuk pranohet.

II.2.6. Mbajtja e evidencës kontabile në qendër dhe në njësitë e vartësisë, respektimi i afateve për nxjerrjen dhe miratimin e bilancit nga organet drejtuese të shoqërisë, si dhe dërgimi dhe miratimi i tij në organet e vartësisë, analiza e debitorëve, kreditorëve, derdhja e detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore, etj. ndaj buxhetit të shtetit.

Me anë të Vendimit nr.6/1 datë 21.06.2019 Asambleja e Aksionarëve Ujësjetllës Kanalizime Durrës sh.a. vendosi:

- Miratimin e pasqyrave Financiare të Shoqërisë për vitin 2018 së bashku me dokumentacionin përkatës.
- Miratimin e Raportit të ecurisë së shoqërisë për vitin 2019.

Nuk është kryer përcaktimi i fitimit/humbjes të Shoqërisë të realizuar gjatë vitit financiar 2018 si dhe alokimin e tyre si dhe Vendimi i sipërcituar mban firmën e vetme të Kryetarit të Bashkisë Durrës dhe jo Bashkive të tjera Aksionare të Shoqërisë.

Me anë të Vendimit nr.3/2 datë 30.07.2020 Asambleja e Aksionarëve Ujësjetllës Kanalizime Durrës sh.a. vendosi:

- Miratimin e pasqyrave Financiare të Shoqërisë për vitin 2019 së bashku me dokumentacionin përkatës.
- Miratimin e Raportit të ecurisë së shoqërisë për vitin 2020.

Nuk është kryer përcaktimi i fitimit/humbjes të Shoqërisë të realizuar gjatë vitit financiar 2019 si dhe alokimin e tyre si dhe Vendimi i sipërcituar mban firmën e vetme të Kryetarit të Bashkisë Durrës, të Kryetarit të Bashkisë Shijak dhe jo Bashkive të tjera Aksionare të Shoqërisë.

Me anë të Vendimit nr.3 datë 09.12.2021 Asambleja e Aksionarëve Ujësjiellës Kanalizime Durrës sh.a. vendosi:

- Miratimin e pasqyrave Financiare të Shoqërisë për vitin 2020 së bashku me dokumentacionin përkatës.
- Miratimin e Raportit të ecurisë së shoqërisë për vitin 2021.

Nuk është kryer përcaktimi i fitimit/humbjes të Shoqërisë të realizuar gjatë vitit financiar 2019 si dhe alokimin e tyre si dhe në Vendimin i sipërcituar mungon firma e Kryetarit të Bashkisë Krujë.

Me anë të Vendimit nr.2 datë 25.07.2022 Asambleja e Aksionarëve Ujësjiellës Kanalizime Durrës sh.a. vendosi:

- Miratimin e pasqyrave Financiare të Shoqërisë për vitin 2021 së bashku me dokumentacionin përkatës.
- Miratimin e Raportit të ecurisë së shoqërisë për vitin 2022.

Nuk është kryer përcaktimi i fitimit/humbjes të Shoqërisë të realizuar gjatë vitit financiar 2019 si dhe alokimin e tyre si dhe në Vendimin i sipërcituar mban firmën e vetme të Kryetarit të Bashkisë Durrës, të Kryetarit të Bashkisë Shijak dhe jo Bashkive të tjera Aksionare të Shoqërisë.

Për sa më sipër:

Për katër vitet ushtrimore 2018, 2019, 2020 dhe 2021 bilancet nuk janë dorëzuar sipas legjislacionit në fuqi si dhe shtyrjeve me anë të akteve normative.

Për marrjen e vendimeve të mësipërme për shkak të rëndësisë që kanë sipas VKM nr. 63, datë 27.01.2019 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura” neni 10, pika 2, ku cilësohet që duhet të jenë të pranishëm minimumi 30% e anëtarëve përfshirë dhe kryetarin e asamblesë, në vendimin nr.6.1 datë 21.06.2019, nuk përmbushet ky kriter dhe vendimi i marrë është i pavlefshëm.

• Pasqyra e Pozicionit Financiar

(në lekë)

Pasqyra e Pozicionit Financiar

Me ndarje në afatshkurtër dhe afatgjatë

	2021	2020	2019	2018
AKTIVET				
Aktive afatgjatë				
Aktive afatgjatë materiale	10,321,237,551	9,786,936,099	6,881,636,243	3,872,233,080
Aktive afatgjatë materiale për investim				
Aktive të tjera (përshtetshme)				
Totali i aktiveve afatgjatë	10,321,237,551	9,786,936,099	6,881,636,243	3,872,233,080
Aktive afatshkurtra				
Inventarë dhe aktive biologjike afatshkurtra	381,483,568	345,011,798	282,908,918	229,696,051
Llogari të arkëtueshme tregtare dhe llogari të tjera të arkëtueshme	1,837,915,575	1,604,790,489	1,400,057,247	1,210,991,892
Tatim fitimi i parapaguar	10,052,540	10,052,540	7,577,412	

Mjete monetare dhe ekuivalente me to	79,228,915	63,696,644	85,911,078	123,062,513
<i>Aktive te tjera (përshkruaj)</i>				
	2,308,680,598	2,023,551,471	1,776,454,655	1,563,750,456
Totali i aktiveve afatshkurtra	2,308,680,598	2,023,551,471	1,776,454,655	1,563,750,456
TOTALI I AKTIVEVE	12,629,918,149	11,810,487,570	8,658,090,899	5,435,983,536
DETYRIMET DHE KAPITALI				
Kapitali dhe Rezervat				
Kapitali i nënshkruar dhe primi i kapitalit	446,968,000	446,968,000	446,968,000	446,968,000
<i>Rezerva rivlerësimi</i>	393,558,936	399,303,392	399,303,392	514,229,468
Fitime/(humbje) te mbartura	(2,154,332,291)	(1,901,116,984)	(1,360,692,138)	(1,520,714,968)
Fitim /(humbja) e vitit	(535,176,680)	(258,959,762)	(540,424,846)	160,022,829
	(1,848,982,036)	(1,313,805,354)	(1,054,845,592)	(399,494,670)
Shuma te njohura direkt ne kapital ne lidhje me aktivet e mbajtur për shitje				
Totali i kapitalit qe i takon pronareve njësisë ekonomike	(1,848,982,036)	(1,313,805,354)	(1,054,845,592)	(399,494,670)
Interesa jo-kontrollues				
Totali i kapitalit	(1,848,982,036)	(1,313,805,354)	(1,054,845,592)	(399,494,670)
Detyrime afatgjata				
Huamarje	449,656,351	588,323,581	728,222,498	870,846,566
Detyrime financiare te tjera	7,502,940,646	6,914,610,913	4,273,474,581	1,254,725,423
Detyrime për përfitime pensionesh				
Detyrime tatimore te shtyra	33,341,382	33,341,382	33,341,382	33,341,382
Provizione				
Te ardhura te shtyra				
<i>Detyrime te tjera (përshkruaj)</i>				
Totali i detyrimeve afatgjata	7,985,938,379	7,536,275,876	5,035,038,461	2,158,913,371
Detyrime afatshkurtra				
Llogari te pagueshme tregtare dhe llogari te tjera te pagueshme (sind , kryqi,fum,paga sig)	4,805,405,468	4,119,507,654	3,337,850,630	2,508,960,273
Detyrime ndaj klientëve për kontratat e ndërtimit				
Huamarje	1,686,544,923	1,467,625,924	1,339,229,502	1,156,396,650
Detyrime financiare te tjera				
Detyrime për tatimin aktual	1,011,414	883,470	817,898	11,207,913
Provizione				
Te ardhura te shtyra				
<i>Detyrime te tjera (përshkruaj)</i>				
	6,492,961,805	5,588,017,048	4,677,898,030	3,676,564,836
Detyrimet e përfshira ne grupet e nxjerrjes jashtë përdorimit te klasifikuara si te mbajtura për shitje ne përputhje me SNRF5				
Totali i detyrimeve afatshkurtra	6,492,961,805	5,588,017,048	4,677,898,030	3,676,564,836
Detyrime totale	14,478,900,184	13,124,292,924	9,712,936,491	5,835,478,207
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT	12,629,918,149	11,810,487,570	8,658,090,899	5,435,983,536

Në analizimin e zërit Mjete Monetare vihet re që nga viti 2018 deri në vitin 2021 kemi një rënie në vlerë e cila pasqyrohet si mos arkëtim si më poshtë, duke mos dhënë arsytet përkatëse se përse vjen kjo rënie e mos arkëtimeve. Të ardhurat kryesore në bankë janë depozitimet e arkës gjatë mbylljeve ditore.

(në lekë)

	2018	2019	2020	2021
Arka	0	0	0	0
Banka	123,062,513	85,911,078	63,696,644	79,228,914

Në analizimin e zërit të drejta të Arkëtueshme dhe nënkategorisë “nga aktiviteti i shfrytëzimit” vihet re një rritje në vlerë e cila përkon me mosarkëtim në kohë të detyrimeve nga ana e debitorëve që reflektohet dhe në zërin e Mjeteve Monetare si një rënie e arkëtimeve me anë të Bankës dhe Arkës.

(në lekë)

	2018	2019	2020	2021
Klientë për mallra produkte	1,075,264,242	1,188,393,834	1,302,068,622	1,422,625,151
Llogari të tjera të arkëtueshme	135,727,650	211,663,413	302,721,867	415,290,424
Parapagime tatim fitimi	0	7,577,412	10,052,540	10,052,540
TOTAL	1,210,991,892	1,407,634,659	1,614,843,029	1,847,968,115

Në analizimin e zërit të Drejta të Arkëtueshme vihet re që në nënkategorinë “llogari të tjera të arkëtueshme”, përshkrimi i llogarisë “Institucioni Financiare për t’u arkëtuar Posta, Uft, etj...” paraqitet si më poshtë:

(në lekë)

2018	2019	2020	2021
6,510,311	3,367,478	8,972,863	6,133,946

të drejta të cilët nuk sqarohen nëse përkojnë me të ardhurat e përfituara në muajin dhjetor dhe të mbledhura nga këto institucione për llogari të shoqërisë apo për ndonjë arsye tjetër.

- Në analizimin e zërit të Drejta të Arkëtueshme vihet re që në nënkategorinë “llogari të tjera të arkëtueshme”, përshkrimi i llogarisë “Garanci përmbartues privat” paraqitet një vlerë e cila në fund të periudhës 2018 paraqitet si vlerë 24,105,629 lekë, duke u shtuar në periudhën pasardhëse në vlerën 28,069,356 lekë dhe duke qëndruar si e tillë për vitet në vazhdim, duke mos dhënë arsyet përkatëse se çfarë karakterizon kjo vlerë dhe përse është e mbartur ndër vite.
- Në analizimin e zërit të Drejta të Arkëtueshme, në llogaritë e arkëtueshme janë të krijuar provizione për zhvlerësimin e aktiveve financiare të ndara në 3 kategori, atë të KL Familjar, KL Privat dhe KL Ente. Nga analizimi i tyre vihet re që vlera e provizionit mbetet e pandryshuar dhe nuk jepen shpjegime se klientët e përfshirë në klasifikimet e mësipërme në çfarë viti janë mbartur dhe përse janë klasifikuar si provizione dhe jo si borxh i keq. Në ato pak raste ku ndërmarrja ka humbur me anë të vendimit të gjykatës vlerë të caktuar të cilat i përkasin faturimeve që janë provizionuar për humbje, ekziston një vlerë e re e cila kalon si shpenzime të periudhës duke mos dhënë arsyet përkatëse mbi karakteristikat e vlerës.
- Në analizimin e zërit Detyrime Afatshkurtra dhe nënkategorisë “Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit” vihet re një rritje në vlerë e këtij zëri si më poshtë:

2018	2019	2020	2021
2,491,044,349	3,316,984,265	3,889,208,219	4,587,089,072

ku në të cilën janë të përfshira edhe detyrimet e mbartura nga institucionet e tjera si Ujësjiellës Kavajë, Ndërmarrja rruga si dhe OSSH, për të cilët administrata nuk ka ndjekur asnjë rrugë për likuidimin e tyre duke caktuar një rend apo një metodë të drejtë mbi likuidimin e tyre.

Në analizimin e zërit Detyrime Afatgjata dhe në nënkategorinë “Titujt e huamarrjes” përfaqësohet nga tre kredi afatgjatat Kredia OPEC lidhur me datë 10.10.2002 në vlerën 2,672,938 USD, Kredia BEI lidhur me datë 15.04.2004 në vlerën 7,011,841 Euro si dhe Kredia IDA lidhur me datë 07.07.2003 në vlerën 5,201,310 USD, të konvertuara me kursin e ditës për vitet përkatëse.

Inst	Dt.Kontrat	Shuma	Fcy	Afati	Fillimi Ripages	Norma Interesit	Penaliteti	Kësti Mesatar (Principal 6-M)
OPEC	10.10.2002	2,672,938.24	USD	20 vjet	2007	2.75%	2.25% mbi detyrimin e pashlyer	90,000
BEI	15.04.2004	7,011,841.75	EUR	24 vjet	2013	Ne varësi të transhit të disbursimit si edhe mbi detyrimin e pashlyer	Ne varësi të transhit të disbursimit si edhe mbi detyrimin e pashlyer	250,423
IDA	07.07.2003	5,201,310.58	USD	20 vjet	2013	1.5%	0.00%	260,066

Për vitin 2018:

	Projektet	Vlera e disbursuar e sistemuar	princip al i paguar	Stoku	Detyrimet e Prapambetura te UK Durrës deri me 31.12.2018			Penalitetet me 31.12.2018	Totali i Detyrimit te UK Durrës sh.a. ndaj Ministrisë me 31.12.2017
					Interes	Principal	Total I Detyrimit		
EUR	BEI- Infrastruktura Ujore Bashkiake	7,011,841	0.00	7,011,841	1,027,287	2,300,160	3,327,448	198,449	3,525,898.52
USD	IDA-Projekti Bashkiak I Furnizimit me Ujë dhe kanalizime	5,201,310	0.00	5,201,310	653,220	3,120,786	3,774,007	0.00	3,774,007.26
USD	OPEC- Rehabilitimi I Furnizimit me Ujë	2,672,938	160,000	2,512,938	695,300	1,910,000	2,605,300	309,898	2,915,199.50

Për vitin 2019:

	Projektet	Vlera e disbursuar	Princip al i paguar	Stoku	Detyrimet e Prapambetura te UK Durrës deri me 31.12.2019			Penalitetet me 31.12.2019	Totali i Detyrimit te UK Durrës sh.a. ndaj Ministrisë me 31.12.2019
					Interes	Principal	Total I Detyrimit		
EUR	BEI- Infrastruktura Ujore Bashkiake	7,011,841	0.00	7,011,841	1,145,595	2,801,006	3,946,602.06	270,954	4,217,556
USD	IDA-Projekti Bashkiak I Furnizimit me Ujë dhe kanalizime	5,201,310	0.00	5,201,310	732,661	3,640,917	4,373,578	0.00	4,373,578
USD	OPEC- Rehabilitimi I Furnizimit me Ujë	2,672,938	160,000	2,512,938	764,406	2,090,000	2,854,406	371,955	3,226,362

Për vitin 2020:

	Projektet	Vlera e disbursuar	princip al i paguar	Stoku	Detyrimet e Prapambetura te UK Durrës deri me 31.12.2020			Penalitetet me 31.12.2020	Totali i Detyrimit te UK Durrës sh.a. ndaj Ministrisë me 31.12.2020
					Interes	Principal	Total I Detyrimit		
EUR	BEI- Infrastruktura Ujore Bashkiake	7,011,841	0.00	7,011,841	1,263,902	3,301,852	4,565,755	355,977	4,921,733.27
USD	IDA-Projekti Bashkiak i Furnizimit me Ujë dhe kanalizime	5,201,310	0.00	5,201,310	812,101	4,161,048	4,973,150	0.00	4,973,150.38
USD	OPEC- Rehabilitimi i Furnizimit me Ujë	2,672,938	160,000	2,512,938	833,512.54	2,270,000	3,103,512	439,873	3,543,385.91

E njëjta gjë vazhdon dhe për vitet në vijim kur principali dhe interesat nuk paguhen por njihen si detyrime ndaj Ministrisë së Financave.

Në analizimin e shpenzimeve në zërin Gjoha, Penalitete, Dëmshpërblime gjendja është si më poshtë:

2018	2019	2020	2021
32,712,574	30,831,122	11,667,280	20,479,365

të cilat rëndojnë buxhetin e shoqërisë duke i përdorur fondet pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet.

- Në analizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve situata paraqitet si më poshtë:

	2018	2019	2020	2021
Të ardhura	1,488,996,751	1,310,967,281	1,354,533,826	1,374,618,204
Shpenzime	1,319,073,404	1,851,392,127	1,613,493,588	1,909,794,884
Diferenca	169,923,347	-540,424,846	-258,959,762	-535,176,680

ku në të cilën shihet që shoqëria tre vitet e fundit, duke mbajtur të ardhurat në mënyrë konstante ka rritur shpenzimet dhe kur shoqëria rezulton me humbje.

7. Titulli i gjetjes:	Anomali në përmbajtjen, hartimin dhe miratimin e pasqyrave financiare
Situata:	Për katër vitet ushtrimore 2018, 2019, 2020 dhe 2021 bilancet nuk janë dorëzuar sipas legjislacionit në fuqi si dhe shtyrjeve me anë të akteve normative. Në analizimin e zërit Mjete Monetare vihet re që nga viti 2018 deri në vitin 2021 kemi një rënie në vlerë e cila pasqyrohet si mos arkëtim si më poshtë, duke mos dhënë arsyt përkatëse se përse vjen kjo rënie e mos arkëtimeve. Të ardhurat kryesore në bankë janë depozitimet e arkës gjatë mbylljeve ditore. Në analizimin e zërit Të drejta të Arkëtueshme dhe nënkategorisë “nga aktiviteti i shfrytëzimit” vihet re një rritje në vlerë e cila përkon me mosarkëtim në kohë të detyrimeve nga ana e debitorëve që reflektohet dhe në zërin e Mjeteve Monetare si një rënie e arkëtimeve me anë të Bankës dhe Arkës. Në analizimin e zërit të Drejta të Arkëtueshme vihet re që në nënkategorinë “llogari të tjera të arkëtueshme”, përshkrimi i llogarisë “Institucioni Financiare për t’u arkëtuar Posta, Uft, etj të drejta të cilët nuk sqarohen nëse përkojnë me të ardhurat e përfituara në muajin dhjetor dhe të mbledhura nga këto institucione për llogari të shoqërisë apo për ndonjë arsye tjetër. Në analizimin e zërit të Drejta të Arkëtueshme vihet re që në nënkategorinë “llogari të tjera të arkëtueshme”, përshkrimi i llogarisë “Garanci përmbaues privat” paraqitet një vlerë e cila në fund të periudhës 2018 paraqitet si vlerë 24,105,629 lekë, duke u shtuar në periudhën pasardhëse në vlerën 28,069,356 lekë dhe duke qëndruar si e tillë për vitet në vazhdim, duke mos dhënë arsyt përkatëse se çfarë karakterizon kjo vlerë dhe përse është e mbartur ndër vite. Në analizimin e zërit të Drejta të Arkëtueshme, në llogaritë e arkëtueshme janë të krijuar provizione për zhvlerësimin e aktiveve financiare të ndara

	në 3 kategori, atë të KL Familjar, KL Privat dhe KL Ente. Nga analizimi i tyre vihet re që vlera e provizionit mbetet e pandryshuar dhe nuk jepen shpjegime se klientët e përfshirë në klasifikimet e mësipërme në çfarë viti janë mbartur dhe përse janë klasifikuar si provizione dhe jo si borxh i keq. Në ato pak raste ku ndërmarrja ka humbur me anë të vendimit të gjykatës vlerë të caktuar të cilat i përkasin faturimeve që janë provizionuar për humbje, ekziston një vlerë e re e cila kalon si shpenzime të periudhës duke mos dhënë arsytet përkatëse mbi karakteristikat e vlerës. Në analizimin e zërit Detyrime Afatshkurtra dhe nënkategorisë “<i>Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit</i>” vihet re një rritje në vlerë e këtij zëri ku në të cilën janë të përfshira edhe detyrimet e mbartura nga institucionet e tjera si Ujësjiellës Kavajë, Ndërmarrja rruga si dhe OSSH, për të cilët administrata nuk ka ndjekur asnjë rrugë për likuidimin e tyre duke caktuar një rend apo një metodë të drejtë mbi likuidimin e tyre. Në analizimin e zërit Detyrime Afatgjata dhe në nënkategorinë “<i>Titujt e huamarrjes</i>” përfaqësohet nga tre kredi afatgjatat Kredia OPEC lidhur me datë 10.10.2002 në vlerën 2,672,938 USD, Kredia BEI lidhur me datë 15.04.2004 në vlerën 7,011,841 Euro si dhe Kredia IDA lidhur me datë 07.07.2003 në vlerën 5,201,310 USD, të konvertuara me kursin e ditës për vitet përkatëse ku e njëjta gjë vazhdon dhe për vitet në vijim kur principali dhe interesat nuk paguhën por njihen si detyrime ndaj Ministrisë së Financave. Në analizimin e shpenzimeve në zërin Gjoha, Penalitete, Dëmshpërblime gjendja të cilat rëndojnë buxhetin e shoqërisë duke i përdorur fondet pa efektivitet, efience dhe ekonomikitet. Në analizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve ku në të cilën shihet që shoqëria tre vitet e fundit, duke mbajtur të ardhurat në mënyrë konstante ka rritur shpenzimet dhe kur shoqëria rezulton me humbje.
Kriteri:	Ligji nr. 10 296, datë 08.07.2010, i ndryshuar “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”. Ligj Nr. 25/2018 Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare. Nr. 9920, Datë 19.5.2008 Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë i Ndryshuar.
Ndikimi/Efekti:	Pengon në arritjen e qëllimit dhe objektivave të shoqërisë.
Shkaku:	Keqmenaxhim i të ardhurave, moslikuidimi i kreditorëve dhe krijimi i gjendjes debitoare nga mos arkëtimi në kohë i të ardhurave.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	UK Durrës sh.a. gjatë hartimit të pasqyrave financiare të marrë në konsideratë Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, hartimin, miratimin dhe depozitimit të pasqyrave financiare në kohë sipas legjislacionit në fuqi si dhe të ketë parasysh likuidimin në kohë ose duke krijuar një rend mbi likuidimin e kreditorëve të cilët janë akumuluar ndër vite.

Për sa më sipër, ngarkohen me përgjegjësi:
 z. S. K. në cilësinë e Administratorit të shoqërisë
 z. D.Gj. në cilësinë e Drejtorit Tregtar
 znj. J.H., në cilësinë e përgjegjëses së financës

Sa më sipër është mbajtur *Akt konstatimi nr.02* , datë 13.01.2023

II.2.7 Mbi zbatimin e ligjshmërisë në prokurimet e fondeve publike dhe ankandet, lidhjen e zbatimit e kontratave.

Bazuar në pikën nr.2 të programit të auditimit “ Mbi zbatimin e ligjshmërisë në prokurimet e fondeve publike dhe ankandet, lidhjen dhe zbatimin e kontratave”, pas marrjes së informacionit nga nëpunësit si dhe pas verifikimit të sistemit, UK Durrës sh.a. për periudhën nën auditim 2018-2021 ka zhvilluar procedurat e mëposhtme të prokurimit me vlerë të lartë, ndarë sipas viteve:

Për vitin **2018** janë zhvilluar **26** Procedura Prokurimi, në total me vlerë investimi **436,553,744** lekë pa TVSH.

Për vitin **2019** janë zhvilluar **38** Procedura Prokurimi, në total me vlerë investimi **1,088,023,340** lekë pa TVSH.

Për vitin **2020** janë zhvilluar **10** Procedura Prokurimi, në total me vlerë investimi **778,416,784** lekë pa TVSH.

Për vitin **2021** janë zhvilluar **21** Procedura Prokurimi, në total me vlerë investimi **617,798,075** lekë pa TVSH.

Për vitin **2022**, deri më 31.10.2022 janë zhvilluar 6 Procedura Prokurimi, në total me vlerë investimi **35,573,288** lekë pa TVSH.

Fondi i parashikuar për tu investuar në total për 5 vitet e mësipërme është **4,285,072,765** lekë pa TVSH dhe vlera totale e realizuar për 4 vite është **4,177,816,680** lekë pa TVSH, pra është realizuar **97.4%** e fondit të parashikuar për tu investuar, e ndarë në vite si më poshtë:

Për vitin 2018 është realizuar **96.7%** të fondit të parashikuar për tu investuar;

Për vitin 2019 është realizuar **90.7%** të fondit të parashikuar për tu investuar;

Për vitin 2020 është realizuar **95.4%** të fondit të parashikuar për tu investuar;

Për vitin 2021 është realizuar **97.1%** të fondit të parashikuar për tu investuar;

Për vitin 2022 është realizuar **94%** të fondit të parashikuar për tu investuar.

Bazuar në tre kriteret e përzgjedhjes me bazë riskun, të procedurave të prokurimit u bë përzgjedhja si më poshtë:

	Procedura e Prokurimit	Fondi Limit	Vlera e kontratës	Operatori Ekonomik	Data e lidhjes së kontratës
2019	"Rikonstrukcion i rrjetit të ujësjellësit Mulliri Bullgarit dhe 4 Rrugët e Shijakut, Bashkia Shijak	64,699,750	63,939,970	A..A shpk	17.04.2019
	Sistemi i matjes, kontrollit, komandimit në distancë dhe sistemi i klorifikimit automatik	72,059,000	69,921,411	"S." shpk & "I.& "A.shpk	03.06.2019
	Ndërtimi i ujësjellësit të fshatrave Lalëz, Bizë, Draç dhe Shetë, Njesia Administrative Ishëm-Bashkia Durrës	180,414,265	143,726,215	"K." shpk & "N." shpk – 143,726,215 lekë	13.09.2019
	Sistemimi i kanalizimeve të ujërave të ndotura të zonës turistike Hamallaj, Faza I, Njesia Administrative Sukth, Bashkia Durrës	82,111,600	79,915,686	"2." shpk	13.09.2019

2020	Blerje mjete për nevojat e UK Durrës sh.a.”	19,840,000	19,600,000	M.M shpk	05.03.2020
	Rikonstruksion i rrjetit të ujësjellësit Shkafane dhe Lagjet Muzhaq Kulls, nj. adm. Ishëm, Bashkia Durrës		37,500,594	BOE G. & L.	24.12.2020
	Sistemimi i furnizimit me ujë të zonës Turistike Hamallaj, Faza II, Nj. Adm. Sukth, Bashkia Durrës	133,470,441	130,146,289	B. shpk & H. shpk & L. shpk	07.08.2020
2021	Rikonstruksion në rrjetin ekzistues të qytetit të Durrësit, zona 10 dhe 13/1, Bashkia Durrës	399,962,820	393,558,684	A. shpk	25.03.2021
	Ndërtim i rrjetit të KUZ të fshatit Shënavlash, Bashkia Durrës	364,498,645	352,017,419	E. & 2.	24.03.2021
	Përmirësim i furnizimit me ujë lagja nr.1, Vardardh, nj. Adm Sukth, Bashkia Durrës	131,441,922	127,727,766	K.” shpk & “S.” shpk & “L.” shpk	10.08.2021

1. Mbi auditimin e procedurave të prokurimit si më poshtë:

- Rikonstruksion në rrjetin ekzistues të qytetit të Durrësit, zona 10 dhe 13/1, Bashkia Durrës 2021

Përshkrimi i procedurës

Sipas kontratës me firmën projektuese Invictus, është bërë gati projekti me objekt “Rikonstruksion në rrjetin ekzistues të qytetit të Durrësit, zona 10 dhe 13/1, Bashkia Durrës”, që përfshin ndërtimin e rrjetit shpërndarës dhe instalimin e pushtave shpërndarëse për instalim matësash. Fondi limit i investimit të mësipërm është 399,962,820 lekë pa TVSH dhe Projekti aktualisht është në fazë përfundimi të punimeve.

Përmbledhja e procedurës në tabelë

Procedura e Prokurimit "Rikonstruksion në rrjetin ekzistues të qytetit të Durrësit, zona 10 dhe 13/1, Bashkia Durrës"		
Urdhër Prokurimi nr.3494/4 prot, date 07.12.2020		
1.Lloji i Procedurës se Prokurimit Procedurë e hapur pune	2. Njesia e prokurimit Znj.A. B. z. B. M. z. G. S.	3. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave Sipas Urdhrit nr. 984/6, date 26.03.2020 z. G. D. (Kryetar) znj. F. K. (Anëtar) z. D. S. (Anëtar)
4. Komisioni i Hartimit të Specifikimeve Teknike z. L. F. z. A. K.		
5. Fondi Limit (pa tvsh) 399.962.820 leke	6. Oferta Fituese (pa tvsh) 393,558,684 lekë	7. Diferenca me fondin Limit (pa tvsh) 6,404,136 lekë
8. Data e hapjes se ofertave 08.01.2021	9. Burimi i Financimit Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomikë 1. “K.K.”shpk – 263,634,182 lekë pa TVSH 2. “B.” shpk 391,045,145 lekë pa tvsh 3. A. shpk 393,558,684 lekë pa tvsh
11. Ankimime	12. Përgjigje e ankesës nga AK	13. Përgjigje ankesës nga KPP
b.Zbatimi i Kontratës se Punimeve/Shërbimeve/Mallrave		
14. Lidhje e kontratës Nr.1494 Prot. date 25.03.2021	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 472,270,421 leke me TVSH	16. Grupi i punës për ndjekjen e kontratës z. L. F. z. E. K. z. A. P.

17. Situacioni përfundimtar/fature malli/shërbimi Situacion nr.1 14,487,930 lekë me tvsh Situacion nr.2 26,869,754 lekë me tvsh Situacion nr.3 12,857,688 lekë me tvsh Situacion nr.4 41,762,018 lekë me tvsh Situacion nr.5 72,533,485 lekë me tvsh	18. Afati i kontratës ne dite. Afati i realizimit 540 Ditë	19. Zgjatja e kontratës me dite
--	--	--

Sipas Urdhrit nr. 3494/1 Prot. datë 03.12.2020, z. L. F. dhe z. A. K. urdhërohen të hartojnë në mënyrë të detajuar specifikimet teknike si dhe kërkesat për kualifikimin e operatorëve ekonomik. Gjatë auditimit të specifikimeve teknike, grupi i auditimit vëren kriteret teknike të cilat janë në mospërputhje me njëra tjetrën:

O.E. duhet të ketë të punësuar si staf teknik:

Shofer 4 persona

Automakinist 2 persona

Manovrator 6 persona, ndërkohë kërkon që të disponohen dhe mjetet e mëposhtme si:

Kamion vetëshkarkues 10 copë

Mjet gjermimi me goma 2 copë

autovinç 2 copë

Autobot uji 1 copë

Autopompe betoni 1 copë

Autobetoniere 2 copë

Eskavator me zinxhir 2 copë

Mini eskavator 3 copë

Minifadromë 2 copë që në total janë 25 mjete të kërkuara me 12 shoferë të kërkuar më sipër, të cilët janë mjete që duhen të jenë në shfrytëzim me kohë të plotë dhe që minimumi duhet të kenë nga një shofer për çdo mjet.

Kriteret e vendosura në preventiv mendojmë që janë të paargumentuar, diskriminues, përtej domosdoshmërive dhe krejtësisht jashtë nevojave duke u bërë kështu shkak për krijimin e kushteve të mungesës së një konkurrence të lirë e të ndershme.

Nga sa më sipër rezulton se nuk është argumentuar numri i stafit inxhinierik të përdorur dhe përse është kërkuar vetëm 1 inxhinier hidroteknik dhe 1 inxhinier elektrik ku vlera e procedurës së kryer si dhe preventivi në fjalë është kërkon më shumë angazhime të të paktën dy inxhinierëve të mësipërm.

Gjithashtu për shkak të vlerës së lartë të prokurimit si dhe të madhësisë së projektit kërkesa për 1 Inxhinier hidroteknik, 1 inxhinier elektrik është e ulët.

8. Titulli i gjetjes:	Vendosja e kriterëve të veçanta jo në përputhje me objektin e kontratës dhe jo në përputhje me njëra tjetrën.
Situata:	Gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit me objekt “Rikonstruksion në rrjetin ekzistues të qytetit të Durrësit, zona 10 dhe 13/1, Bashkia Durrës” për vitin 2021, në analizimin e hartimit të specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta u gjetën kriteret të cilat nuk ishin në proporcion me objektin e kontratës si dhe në mospërputhje me njëra tjetrën si më poshtë: <i>Shofer 4 persona</i> <i>Automakinist 2 persona</i>

	Manovrador 6 persona, ndërkohë kërkon që të disponohen dhe mjetet e mëposhtme si: Kamion vetëshkarkues 10 copë Mjet gjurmimi me goma 2 copë autovinç 2 copë Autobot uji 1 copë Autopompe betoni 1 copë Autobetoniere 2 copë Eskavator me zinxhir 2 copë Mini eskavator 3 copë Minifadromë 2 copë që në total janë 25 mjete të kërkuara me 12 shoferë të kërkuar më sipër, të cilët janë mjete që duhen të jenë në shfrytëzim me kohë të plotë dhe që minimumi duhet të kenë nga një shofer për çdo mjet si dhe përfshirja e një numri të vogël të inxhinierëve në proporcion me vlerën dhe me zërat e punimeve në preventivin e punimeve.
Kriteri:	Neni 23 “ <i>Specifikimet Teknike</i> ”, Ligji nr.9643 datë 20.11.2006 “ <i>Për Prokurimin Publik</i> ”, i ndryshuar.
Ndikimi/Efekti:	Pengon konkurrencën e drejtë
Shkaku:	Hartimi i specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta diskriminuese.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	UK Durrës sh.a., në zhvillimin e procedurave të prokurimit, veçanërisht në hartimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta, të ketë parasysh që të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve.

Për sa më sipër, ngarkohen me përgjegjësi hartuesit e specifikimeve teknike:
z. L. F. dhe z. A. K.

Sa më sipër është mbajtur Akt konstatimi nr.05 , datë 13.01.2023

Përsa është trajtuar në këtë pjesë të P/Raportit të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacion me shkresë nr.825/12 prot, datë 15.03.2023 “Observacion mbi Akt Konstatimin Nr.05 datë 13.01.2023 në lidhje me procedurën e prokurimit “*Rikonstruksion në rrjetin ekzistues të qytetit të Durrësit, zona 10 dhe 13/1, Bashkia Durrës*” nga z. S. K., ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

Referuar Ligjit nr. 9643 dt. 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, Neni 23 “*Specifikimet teknike*” grupi i specifikimeve teknike ka hartuar specifikimet duke u mbështetur në objektin e kontratës si dhe punimeve që do të kryhen. Me shkresën nr. 3494/2 Prot., datë 04.12.2020 grupi i specifikimeve teknike në zbatim të përcaktimeve të pikës 2, të nenit 28, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, ku parashikohet se: “*Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës...., ku më pas vazhdohet me të njëjtën përmbajtje si në fazën e projekt raportit.*”

Qëndrimi i Grupit të Auditimit të KLSH –së:

Në lidhje me observacionin e bërë nga ana e z. S. K., grupi i auditimit pas analizimit të

observacionit mban të njëjtin qëndrim mbi gjetjen duke cituar dhe njëherë se në grafikun e punimeve, nuk mund të kërkohej pajisja me 10 kamion vetëshkarkuese dhe në po të njëjtën kohë kërkohej 4 shoferë, përfshirë dhe rastin kur nuk punojnë paralelisht. Vendosija e kriterëve të tilla si dhe ato të shprehura në gjetje përbëjnë arsye mbi shkualifikimin e operatorëve të tjerë si dhe dyshime mbi paracaktimin e O.E. fitues në garë.

Për këto arsye, sa më sipër, observacioni juaj nuk pranohet

- **Zhvillimi i Procedurës "Blerje mjete për nevojat e UK Durrës sh.a."**

Përshkrimi i procedurës

Blerja e katër automjeteve Pick up, 1 Makinë teknologjike vetëshkarkuese për pastrim të rrjetit të kanalizimeve dhe një makinë teknologjike APV vetëshkarkuese, për nevojat e UK Durrës sh.a.

Fondi Limit

Fondi limit në vlerën: 19,840,000 lekë (pa TVSH).

Përmbledhja e procedurës në tabelë

Procedura e Prokurimit "Blerje mjete për nevojat e UK Durrës sh.a."		
Urdhër Prokurimi nr.984/4 prot, date 26.02.2020		
1.Lloji i Procedurës së Prokurimit Procedurë e hapur pune	2. Njesia e prokurimit Znj.A. B. z. B. M. znj. D. B.	3. Komisioni i Vleresimit të Ofertave Sipas Urdhrit nr. 984/6, date 26.03.2020 z. M. H. (Kryetar) z. O. K. (Anëtar) z. D. Gj. (Anëtar)
4. Komisioni i Hartimit të Specifikimeve Teknike z. L. F. z. G. D.		
5. Fondi Limit (pa tvsh) 19,840,000 lekë	6. Oferta Fituese (pa tvsh) 19,600,000 lekë	7. Diferenca me fondin Limit (pa tvsh) 240,000 lekë, ose 1.2 %
8. Data e hapjes së ofertave 27.04.2020	9. Burimi i Financimit Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomikë 1. "M. M." 19,600,000 lekë pa tvsh
11. Ankimime	12. Përgjigje e ankesës nga AK	13. Përgjigje ankesës nga KPP
b.Zbatimi i Kontratës së Punimeve/Shërbimeve/Mallrave		
14. Lidhje e kontratës Nr.483 Prot. date 05.03.2020	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 23,520,000 lekë me TVSH	16. Grupi i ndjekjes së kontratës z. G. D. z. L. F. z. I. K.
17. Situacioni përfundimtar/fature malli/shërbimi	18. Afati i kontratës në ditë. Afati i realizimit 15 Ditë	19. Zgjatja e kontratës në ditë

Sipas Urdhrit nr. 3469/1 Prot. datë 12.12.2019, z. L. F. dhe z. G. D. urdhërohen të hartojnë në mënyrë të detajuar specifikimet teknike si dhe kërkesat për kualifikimin e operatorëve ekonomik. Gjatë auditimit të specifikimeve teknike, grupi i auditimit vëren kriteret teknike të cilat të çojnë drejt produkteve specifike të paracaktuara si në rastin e përshkrimit të cilindratave, fuqisë, gjatësisë, lartësisë të cilët janë fikse dhe nuk janë përdorur termat e tjerë ose ekuivalente me to.

Në rastin e hartimit të specifikimeve teknike për “Makinë teknologjike vetëshkarkuese për pastrim pusetash e kanalizime dhe transport materialesh të veçanta” dhe “Makinë teknologjike APV vetëshkarkuese” nuk janë cilësuar se të çfarë viti prodhimi duhet të jenë që është minimumi mbi përlllogaritjen e vlerës që mbartin ato. Gjithashtu në specifikimet teknike të “Makinë teknologjike APV vetëshkarkuese” është kërkuar kriter që për km e përshkruara të jenë jo më shumë se 251,000 km, ndërsa për të njëjtin automjet “makinë teknologjike vetëshkarkuese për pastrim pusetash e kanalizime dhe transport materialesh të veçanta” në specifikimet teknike kërkohet që në kilometrat e përshkruara të jenë jo më shumë se 150,000 km, që do të thotë për një objekt të njëjtë kërkohen specifikime teknike të ndryshme. Gjatë verifikimeve të dy automjeteve të mësipërme nuk tregohet dhe origjina e tyre, vërtetësia mbi kilometrat e përshkruara si dhe mbajnë të stampuara logot e një kompanie e cila operon në tregun shqiptar dhe për automjetin “makinë teknologjike APV” me targë AE....rezultoi që është me timon në krahë të djathtë, gjë e cila duhet që të ishte e cilësuar në specifikimet teknike për vet riskun që mbartin. Bazuar në situatën e mësipërme rezulton se kriteret e vendosura, jo vetëm që nuk lidhen me ndonjë domosdoshmëri konkrete të AK për sa i takon mjetit të kërkuar, por për më tepër ato diktojnë haptazi dhe në mënyrë të detajuar OE fitues përmes detajimit të parametrave teknikë të mjetit të kërkuar.

Nisur nga sa më sipër, në gjykim të Grupit të Auditimit arrihet një konkluzion mbështetur në një dyshim të arsyeshëm e mbi baza dokumentare se procedura e prokurimit është realizuar në kushtet e paracaktimit të fituesit M. M. duke shkaktuar kështu përdorimin pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet të fondeve në shumën 19,600,000 lekë pa TVSH prej si rrjedhojë e shmangies së konkurrencës së lirë e të ndershme mes operatorëve ekonomikë, trajtimit jo të barabartë të OE pjesëmarrës si dhe mbi të gjitha mungesës së integritetit, besimit publik dhe transparencës.

9. Titulli i gjetjes:	Vendosja e kriterëve dhe specifikimeve teknike që të drejtojnë rreth një produkti të caktuar (O.E. fitues)
Situata:	Gjatë zhvillimi të Procedurës së Prokurimit me objekt “ <i>Blerje mjete për nevojat e UK Durrës sh.a.</i> ” gjatë hartimit të specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta, nuk janë cilësuar se të çfarë viti prodhimi duhet të jenë automjetet, që është minimumi mbi përlllogaritjen e vlerës që mbartin ato. Gjithashtu në specifikimet teknike të “Makinë teknologjike APV vetëshkarkuese” është kërkuar kriter që për km e përshkruara të jenë jo më shumë se 251,000 km, ndërsa për të njëjtin automjet “makinë teknologjike vetëshkarkuese për pastrim pusetash e kanalizime dhe transport materialesh të veçanta” në specifikimet teknike kërkohet që në kilometrat e përshkruara të jenë jo më shumë se 150,000 km, që do të thotë për një objekt të njëjtë kërkohen specifikime teknike të ndryshme. Për automjetin “makinë teknologjike APV” me targë AE MT 93 rezultoi që është me timon në krahë të djathtë, gjë e cila duhet që të ishte e cilësuar në specifikimet teknike për vet riskun që mbartin.
Kriteri:	Neni 23 “ <i>Specifikimet Teknike</i> ”, Ligji nr.9643 datë 20.11.2006 “ <i>Për Prokurimin Publik</i> ”, i ndryshuar.
Ndikimi/Efekti:	Pengon konkurrencën e drejtë
Shkaku:	Hartimi i specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta diskriminuese.
Rëndësia:	E lartë

Rekomandimi:	Administratori i shoqërisë UK Durrës, të nxjerrë përgjegjësitë për komisionin e hartimit të specifikimeve teknike në lidhje me hartimin e procesverbalit mbi hartimin e specifikimeve teknike në lidhje me km e përshkruara të automjeteve dhe vitin e prodhimit si dhe për komisionin e marrjes në dorëzim të mallit, në lidhje me makinën teknologjike APV që rezultoi të jetë me timon në krahë të djathtë.
---------------------	--

Sa më sipër është mbajtur *Akt konstatimi nr.06*, datë 13.01.2023

Përsa është trajtuar në këtë pjesë të P/Raportit të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacion me shkresë nr.825/12 prot, datë 15.03.2023 “Observacion mbi Akt Konstatimin Nr.06 datë 13.01.2023 në lidhje me procedurën e prokurimit “*Blerje mjete për nevojat e UK Durrës sh.a.*” nga z. S. K., ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

Mbi rekomandimin e kthimit të mjeteve është e pamundur nga ana e A.K. të ndjekë këtë rekomandim:

Së pari hartimi i kriterëve kualifikuesë është bërë nga persona të cilët janë specialist të fushës dhe si të tillë, kanë hartuar kriteret referuar nenit 23 “Specifikimet Teknike:

Së dyti agjencia e prokurimeve publike në rastet kur hartuesit e specifikimeve vendosin kriteret të cilat nuk janë në përputhje me LPP dërgon rekomandime në lidhje me kriteret të cilat rishikohen nga AK, në rastin konkret për kilometrat e mjeteve nuk ka pasur rekomandime të APP, pasi nga AK është vënë një max kilometrash që duhet të ketë mjete, kriter i cili nuk mund të quhet diskriminues pasi AK i vendos specifikimet referuar nenit 23.

Gjithashtu në rast se do të kishte pasur konfuzion, kërkesat për sqarim apo ankesa në lidhje me kriteret, O.E. të interesuar kanë pasur drejtë të dërgojnë kërkesa për sqarim apo ankesa sipas parashikimeve ligjore.

Viti prodhimit të mjeteve nuk është specifikuar nga grupi i specifikuesve, gjë që hap me shumë diapazonin e konkurrimit, çka do të thotë ofertuesit mund të kenë mjete të çdo viti mjafton që të jetë sipas specifikimeve të kërkuara që i nevojiten autoriteti kontraktor për të kryer proceset e punës.

Për më tepër në rast se bëhet fjalë për përcaktimin e vitit të prodhimit çfarë ndryshimi do të kishte për O.E. pjesëmarrës?

Qëndrimi i Grupit të Auditimit të KLSH –së:

Në lidhje me observacionin e bërë nga ana e hartuesve të specifikimeve teknike z. S. K., grupi i auditimit pas analizimit të observacionit mban të njëjtin qëndrim mbi gjetjen duke cituar dhe njëherë se nuk mund të cilësohet vlera e një automjeti në rastin kur nuk është cilësuar viti i prodhimit. Në rastin kur citohet nga grupi i specifikimeve teknike që vendosja e vitit të prodhimit si kriter, hap më shumë diapazonin e konkurrimit, grupi i auditimit mendon të kundërtën. Për sa i përket pyetjes së fundit, përgjigja nga grupi i auditimit është se një automjet me specifikime të njëjta teknike i vitit 2020 nuk ka të njëjtën vlerë me atë të vitit 2000.

Për këto arsye, sa më sipër, observacioni juaj nuk pranohet.

• **Zhvillimi i Procedurës ‘Rikonstruksion i rrjetit të ujësjellësit Shkafane dhe Lagjet Muzhaq Kulls, nj. adm. Ishëm, Bashkia Durrës’**

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se projekti është hartuar nga ana e punonjësve të UK Durrës sh.a. duke parashikuar një vlerë punimesh prej 41,993,956 lekë me TVSH. Objekti i kësaj Veprë Teknike është rehabilitimi i tubacionit furnizues të depos së fshatit Shkallë, pra zëvendësimi pjesor i linjës që furnizon me ujë këtë zonë. Ndërhyrja në këto zonat bëhet për të:

- *Furnizuar me ujë zonat e banuara;*
- *Përmirësuar e orarit të furnizimit me ujë;*
- *Përmirësimin e sasisë së ujit për frymë;*
- *Përmirësimin e cilësisë së ujit;*
- *Eliminimi i humbjeve dhe ndotjeve të ujit në rrjet;*
- *Prerjen e lidhjeve të paligjshme dhe lidhjen e kontratave të reja konform modelit të ERRU-së*

Nga auditimi i dokumentacionit të mësipërm konstatohet se projekti i miratuar nga ana e Titullarit të AK nuk është shoqëruar me përfshirjen në preventiv të të gjitha zërave të nevojshëm për realizimin e tij. Konkretisht rezulton se nuk janë përfshirë zëra si rërë mbi dhe nën tub apo zhavorr.

Historiku i zbatimit të punimeve

Në përfundim të procedurës së prokurimit, është shpallur fitues BOE G. & L., të përfaqësuar këta nga OE G. me nr. licence për zbatim punimesh NZ.7351/4 datë 15.06.2020 dhe me përfaqësues ligjor z. K. A. me të cilin është lidhur kontrata me Autoritetin Kontraktor e përfaqësuar nga z. K. B. me nr. 3011 prot., datë 24.12.2020 me vlerë 37,500,594.41 lekë me TVSh dhe me afat të zbatimit të punimeve 90 ditë kalendarike nga dita e nesërme e punës pas nënshkrimit të kontratës sipas grafikut të hartuar nga projektuesi.

Për mbikëqyrjen e punimeve është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me BOE D.&I. të përfaqësuar nga D. me nr. licence për mbikëqyrje dhe kolaudim punimesh MK.1676/9 datë 01.03.2021, me përfaqësues ligjor z. V.T. sipas aktit me nr. 2801 prot., datë 04.12.2020 me vlerë të kontratës 972,261.57 lekë me TVSH.

Për kolaudimin e punimeve është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi sipas shkresës me nr. 2345 prot., datë 12.05.2021 me OE H.C. e përfaqësuar nga z. E.Q. me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK.3730 datë 30.03.2021 me vlerë të kontratës 145,892 lekë me TVSH. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se objekti është pajisur me leje ndërtimi nr. 14068-20/2 prot, datë 06.01.2021 dhe po në datë 07.01.2021 është konsideruar edhe data e fillimit të punimeve, duke përfutur kështu, nga afati fillestar, një shtyrje prej 13 ditësh kalendarike. Në vijim në datë 07.01.2021 është bërë akti i dorëzimit të sheshit, njoftimi i fillimit të punimeve nga sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi, akti i piketimit si dhe procesverbalit përkatësi i fillimit të punimeve. Sipas shkresës nr. 1700 prot., datë 06.04.2021 është bërë njoftimi i mbikëqyrësit për përfundimin e punimeve, kjo pas njoftimit të sipërmarrësit në po të njëjtën datë. Punimet janë kolauduar sipas aktit përkatës me nr. 2402 prot., datë 17.05.2021 dhe janë marrë në dorëzim sipas certifikatës me nr. 2402/1 prot., datë 17.05.2021.

10. Titulli i gjetjes:	Likuidim i zërave të situacionuar por të pakryer në fakt në momentin e likuidimit të tyre.
Situata:	Sipas shkresës nr. 50/4 prot., datë 22.01.2021 është mbajtur një procesverbal nga e grupit të ndjekjes së kontratës sipas të cilit janë konfirmuar punimet e paraqitura në situacionin nr. 1 me bashkëlidhur një faturë tatimore të datës 22.01.2021 me vlerë 12,662,956 lekë me TVSH, ose 33.7 % të vlerës së kontratës.

Nga analiza e zërave të situacionit dhe krahasimit të të dhënave të marra nga ditari i punimeve dhe grafikut të punimeve konfirmohet fakti se shuma e mësipërme, i është likuiduar sipërmarrësit të punimeve me volume të konsiderueshme pune të pakryera në fakt në momentin e likuidimit të tyre duke favorizuar kështu padrejtësisht zbatuesin e punimeve përmes pagesave. Gjithashtu, rezulton se volumet e punës të situacionit nr. 1, për disa zëra të ndryshëm janë nga 101 % deri në 300 % më tepër në krahasim me ato të preventivit të kontratës, në një kohë kur në nga data 07.01.2021 deri në datë 22.01.2021 nuk ka as një kërkesë dhe as miratim për ndryshim projekti.

Nga krahasimi mes grafikut të punimeve dhe volumeve të situacionit përfundimtar, kapaciteteve teknike të ofruar dhe të vendosura në dispozicion gjatë zbatimit të punimeve (procesverbali i fillimit të punimeve, ditari i punimeve etj.) rezulton se ka një diferencë të konsiderueshme mes volumeve të parashikuara për tu kryer me ato të situacionuara e likuiduara në vlerën 6,394,479.6 lekë me TVSH, ose gati 50 %. Konkretisht tabela e mëposhtme paraqet diferencat si rrjedhojë e grafikut të punimeve:

Nr.	Zëri	Grafiku			Sit nr. 1		Diferenca në volum plan fakt	Çmimi	Vlera
		Sasia e preventivit	Volume/16 ditë	%	Volum/16 ditë	%			
1	Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , në kanale gjerësi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk në mjet	4134.46	945	23%	2993	72%	2048	350	716,793.20
2	Gërmim kanalesh në toke të forta, me krahe, me seksion deri 0.75 m ²	459	105	23%	335	73%	230	1,000	230,085.71
3	Transport dheu deri 5 km	2756.3	630	23%	732	27%	102	250	25,497.14
10	Prishje shtrese betoni	1	1	80%	3	300%	2	3,500	7,700.00
11	Prerje asfalti	150	120	80%	90	60%	-30	200	-
13	Shtrese Asfaltbetoni 4 cm	150	0	0%	0	0%	0	1,400	-
14	Shtrese binderi t = 6 cm	150	0	0%	0	0%	0	1,600	-
15	Shtrese stabilizant t=10cm	150	0	0%	0	0%	0	300	-
16	Shtrese stabilizanti t = 20 cm	2514.31	0	0%	2771	110%	2771	450	1,246,950.00
17	Mbushje me material të gërmuar me pare	2756.3	630	23%	3323	121%	2693	250	673,247.14
18	F.V. Tub PE100 RC Ø90 mm PN 20 atm	1960	448	23%	1985	101%	1537	1,580	2,428,460.00
19	F.V. Tub PE100 RC Ø 75 mm PN 10 atm	1562	357	23%	1600	102%	1243	1,550	1,926,605.71
20	F.V. Tub PE100 RC Ø 63 mm PN 10 atm	720	165	23%	110	15%	-55	1,300	-
21	F.V. Tub PE100 RC Ø 50 mm PN 16 atm	2710	619	23%	924	34%	305	1,100	335,028.57
22	F.v Saraçineska tip shpindel (me aks vertikal) d = 50-80 mm Pn 20 at	2	0	0%	0	0%	0	35,000	-
23	Kalim me tub çeliku D = 125 / 4.0 mm	85	0	0%	278	327%	278	350	97,300.00
24	Beton M-200 per kalimet me tub çeliku	1	0	0%	0.6	60%	1	12,000	7,200.00
25	Prova në tubin	48	0	0%	0	0%	0	4,000	-
26	Pastrim tubi	6	0	0%	0	0%	0	3,500	-
SHUMA									5,328,733

Gjithashtu, referuar akt kontrollit nr. 2 i cili mban datën 22.01.2021 dhe është miratuar nga ana e mbikëqyrësit të punimeve, sipërmarrësit dhe përfaqësuesit të autorizuar të AK z. K. B. rezulton se ecuria e punimeve ka qenë në masën 10 %, ose **3,125,049 lekë pa TVSH**.

Kështu, duke kryqëzuar informacionin e marrë nga të dhënat e ditarit të punimeve dhe tabelës krahasuese të grafikut të punimeve krijohet një dyshim i arsyeshëm mbi

	baza teknike se likuidimi i situacionit pjesor nr. 1 me vlerë 12,662,956.2 lekë me TVSH është kryer në kushtet e mos kryerjes së punimeve në vlerën prej të paktën 8,912,897 lekë me TVSH.
Kriteri:	- Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III neni 7/1¹³; - Kontrata e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve e lidhur sipas aktit nr. 2801 prot., datë 04.12.2020; - Kontrata e shërbimit të kolaudimit të punimeve e lidhur sipas aktit nr. 2345 prot., datë 12.05.2021; - Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3¹⁴, nënpikat 3.2 dhe 3.3.
Ndikimi:	Kryerja e pagesave përmes situacioneve fiktive denatyrton procesin e prokurimit pasi përveçse është tërësisht në kundërshtim me kuadrin përkatës ligjor e rregullator, ky veprim nuk siguron mirëpërdorimin e fondeve publike, nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, nxitjen e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë, nuk siguron një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik dhe mbi të gjitha nuk siguron integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit të kryera nga ana e UK Durrës sh.a.
Shkaku	Veprimet dhe mosveprimet e sipërmarrësit dhe mbikëqyrësit të punimeve.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	Nga ana e UK Durrës sh.a. të merren masa për ngritjen e grupeve efektive në drejtim ndjekjes së kontratës, me qëllim shmangien e kryerjes së pagesave përmes situacioneve fiktive e që nuk paraqesin realitetin në momentin e likuidimit.

11. Titulli i gjetjes:	Likuidim i zërave të situacionuar por të pakryer në fakt si dhe mungesë e konfirmimit të punimeve të maskuara.
Situata:	Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se i janë likuiduar tepër sipërmarrësit të punimeve BOE G. & L. vlera prej 404,900 lekë pa TVSH si rrjedhojë e punimeve të pa kryera në fakt dhe/ose jo të kryera sipas zërit të parashikuar në preventiv. Konkretisht kjo shumë rezulton si më poshtë: Në lidhje me zërin ‘F.V. Tub PE100 RC Ø 50 mm PN 16 atm’,

¹³ “Mbikëqyrësi/grupi i mbikëqyrësve të punimeve është i detyruar të kontrollojë dhe është përgjegjës për zbatimin e punimeve të ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të projektimit, të zbatimit, si dhe destinacionin e objektit. Ai është i detyruar të kontrollojë librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë, vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit. Kur mbikëqyrësi i punimeve konstaton raste të ndryshimit të projektit, është i detyruar të njoftojë menjëherë Inspektoratin Vendor të Mbrojtjes së Territorit të bashkisë”

¹⁴ 3.2 Libreza e masave për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit.

3.3 Situacionet mujore pjesore, progresive dhe përfundimtare hartohen mbi bazën e volumeve të llogaritura në librezën e masave dhe çmimeve faktike, mbështetur në analizat teknike të çmimeve, që përfshihen në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit, të miratuara çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave. Ato firmosen nga drejtuesi teknik i objektit, mbikëqyrësi i punimeve dhe përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit për të cilin është miratuar leja e ndërtimit. Në rastet kur në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit mungojnë analizat teknike të çmimeve të zërave të punimeve të kryera në objekt, veprohet në përputhje me procedurën e përcaktuar në pikën 8 të vendimit nr. 514, datë 15.8.2007 të Këshillit të Ministrave “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”.

	Sipas situacionit përfundimtar për këtë zë rezulton se është likuiduar volumni prej 3369 ml. Sipas librezës së masave pasqyrohet në mënyrë analitike volumni prej 924 ml linear për situacionin e parë dhe 2429 ml për situacionin e dytë (559 ml + 1867 ml), ose 3350 ml në total. Në fakt nga krahasimi i volveve të situacionit përfundimtar dhe librezave të masave rezulton një diferencë me situacionim tepër në sasinë prej 19 ml. Duke bërë llogaritjet rezulton se është përfituar padrejtësisht vlera prej 20,900 lekë pa TVSH (19 ml x 1,100 lekë/ml). - Në lidhje me zërin ‘Prova në tubin’, Sipas projekt-preventivit të hartuar nga ana e projektuesit rezulton se janë përfshirë në preventiv e njëkohësisht edhe në ofertën e paraqitur nga sipërmarrësi i punimeve BOE G.& L. zëri për kryerjen e provës së tubit. Në fakt, referuar kontratës së sipërmarrjes të lidhur mes palëve sipas aktit me nr. 3011 prot., datë 24.12.2021, neni 31¹⁵ Për rrjedhojë rezulton se është përfituar tepër nga ana e sipërmarrësit të punimeve shuma 384,000 lekë pa TVSH e likuiduar për kryerjen e testimit të tubacioneve. - Në lidhje me zërin ‘Shtresë stabilizanti t=20 cm’ Sipas situacionit përfundimtar rezulton volumni prej 4238.4 m² për lagjen Muzhaq dhe 1890.6 m² për Fshatin Shkafane. Libreza e masave pasqyron po të njëjtat volve të shprehura në mënyrë analitike. Në fakt referuar dokumentacionit fotografik të ndodhur në dosje nuk rezulton asnjë rast i vetëm i përdorimit të këtij materiali përgjatë aksit të linjës së realizuar. Për rrjedhojë rezulton se nuk dokumentohen punime në shumën prej 2,758,050 lekë pa TVSH. Si përfundim, rezulton se janë përfituar tepër nga ana e sipërmarrësit të punimeve vlera 404,900 lekë pa TVSH e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e shoqërisë UK Durrës sh.a. dhe si e tillë duhet të zhdëmtohet nga ana e BOE “G. & L.” në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve si dhe njëkohësisht nuk dokumentohet kryerja e punimeve me tre zëra në vlerën 2,758,050 lekë pa TVSH.
Kriteri:	- Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu II, neni 7¹⁶, Kreu II Kërkesa Themelore, neni 12¹⁷, - Udhëzimi nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika 8.1¹⁸, - Udhëzimi nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011.

¹⁵ Testimet dhe Inspektimet, përcaktohet se: “Kontraktori duhet të bëjë të gjitha testet dhe inspektimet e kërkuara nga dispozitat e kontratës. Kosto e këtyre testeve dhe inspekteve duhet të financohet tërësisht nga Kontraktori brenda çmimit të kontratës”.

¹⁶ “Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë dhe është përgjegjës për zbatimin e punimeve të ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të projektimit, të zbatimit, si dhe destinacionin e objektit. Ai është i detyruar të kontrollojë librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë, vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit.”;

¹⁷ “Të gjitha objektet e përkufizuara në nenin 3 duhet t’i nënshtrohen kolaudimit tekniko-ekonomik, i cili ka për qëllim të verifikojë nëse:

1. objekti është realizuar në kushtet teknike;
2. objekti është realizuar në përputhje me kontratën dhe anekset e saj;
3. çmimet e aplikuar janë sipas përcaktimeve të kontratës;
4. në këtë akt verifikohen edhe kërkesat e zbatuesit të paraqitura gjatë zbatimit të punimeve

¹⁸ “Situacionet pjesore hartohen në lloje, zëra, sasi, çmim e vlerë, sipas kontratës dhe ndryshimeve të urdhëruara nga investitori. Zërat, sasitë, çmimet jashtë kontratës dhe përdorimi i fondit rezervë në situacionin përfundimtar justifikohen me dokumentacionin përkatës”;

	Kreu I, pika 3 ¹⁹ , nënplik 3.2 dhe 3.3 <u>ku përcaktohet se</u> : Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar e konkretisht Kreu II, Pika 3 ²⁰ ; - Kontrata e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve e lidhur sipas aktit nr. 2801 prot., datë 04.12.2020; - Kontrata e shërbimit të kolaudimit të punimeve e lidhur sipas aktit nr. 2345 prot., datë 12.05.2021.
Ndikimi:	Dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit në shumën 404,900 lekë pa TVSH .
Ndikimi:	Mungesë e konfirmimit të zërave të punimeve në shumën 2,758,050 lekë pa TVSH .
Shkaku	Mungesa e ushtrimit të kontrolleve nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	Nga ana e UK Durrës sh.a. të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit për arkëtimin e vlerës 404,900 lekë pa TVSH ndaj sipërmarrësit BOE G. & L. për punime të pakryera dhe/apo të kryera jo në përputhje me kërkesat e projektit por të likuiduara në kontratën e sipërmarrjes të lidhur sipas aktit me nr. 3011 prot., datë 24.12.2020 me objekt ‘Rikonstruksion i rrjetit të ujësjellësit Shkafane dhe Lagjet Muzhaq Kulls, nj. adm. Ishëm, Bashkia Durrës’.
Rekomandimi:	Nga ana e UK Durrës sh.a. të merren masa për ngritjen e një grupi pune me specialistë të fushës me qëllim kryerjen e sondazheve përfaqësuese në terren për të verifikuar zbatueshmërinë e projekt – preventivit të kontratës, konkretisht zbatueshmërisë së zërit <i>Shtresë stabilizanti t=20 cm</i> , për të cilin referuar dokumentacionit fotografik, nuk konfirmohet kryerja e tyre në shumën prej 2,758,050 lekë pa TVSH . Në rast të konstatimit të punimeve të pakryera nga ato të përfshira në situacionin përfundimtar, të kërkohet arkëtimi i dëmit përkatës.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:

1. Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve **z. V.T.** përfaqësues ligjor i studios *D.*, në cilësinë e përfaqësuesit të *BOE D.&I.* nuk janë marra për zbatimin e kuadrit ligjor e rregullator si më poshtë:

- Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, kreu II *Kërkesa Themelore*, neni 7²¹

¹⁹ 3.2 Libreza e masave për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit. 3.3 Situacionet mujore pjesore, progresive dhe përfundimtare hartohen mbi bazën e volumeve të llogaritura në librezën e masave dhe çmimeve faktike, mbështetur në analizat teknike të çmimeve, që përfshihen në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit, të miratuara çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave. Ato firmosen nga drejtuesi teknik i objektit, mbikëqyrësi i punimeve dhe përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit për të cilin është miratuar leja e ndërtimit. Në rastet kur në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit mungojnë analizat teknike të çmimeve të zërave të punimeve të kryera në objekt, veprohet në përputhje me procedurën e përcaktuar në pikën 8 të vendimit nr. 514, datë 15.8.2007 të Këshillit të Ministrave “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”;

²⁰ Kolaudatori ose grupi i kolaudimit duhet të verifikojë me përgjegjësi:

a. Realizimin e objektit, në përputhje me projektin, lejen e ndërtimit, standardet dhe rregullat teknike.

b. Realizimin e objektit, në përputhje me kontratën e nënshkruar.

c. Përputhjen e dokumenteve me të dhënat nga matjet në dimension, formë, sasi dhe cilësi.

ç. Përputhjen e vlerës së preventivuar dhe të kontraktuar me atë të paraqitur në situacionin përfundimtar, si dhe sqarimet përkatëse, në rastet e mospërputhjes.

Punimet e ndërtimit, të përkufizuara në nenin 3, duhet të projektohen dhe të zbatohen në tërësi ose në pjesë të veçanta në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit, kushtet teknike të zbatimit, si dhe me destinacionin e tyre, **duke pasur parasysh edhe anën ekonomike të tyre**

²¹ “Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë dhe është përgjegjës për zbatimin e punimeve të ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të projektimit, të zbatimit, si dhe destinacionin e objektit. Ai është i detyruar të kontrollojë librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë, vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit.”;

- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes të lidhur sipas aktit me nr. 2801 prot., datë 04.12.2020;

2. Nga ana e kolaudatorit të punimeve z. E.Q. përfaqësues ligjor e studios E.C., nuk janë marra për zbatimin e kuadrit ligjor e rregullator si më poshtë:

- Kontratën e shërbimit të kolaudimit lidhur sipas asaj me nr. 2345 prot., datë 12.05.2021;
- Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, kreu II *Kërkesa Themelore*, neni 12²²;
- Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar e konkretisht Kreu II, Pika 3²³.

3. Nga ana e mbikëqyrësit z. V. T. përfaqësues ligjor i studios D., në cilësinë e përfaqësuesit të BOE D. & I. si dhe nga ana e kolaudatorit z. E. Q. përfaqësues ligjor e studios E. C. nuk janë marra për zbatimin e kuadrit ligjor e rregullator si më poshtë:

- Udhëzimi nr. 3²⁴ datë 15.02.2001
- Udhëzimi nr. 2²⁵, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II

Nga ana e konsulentit ligjor të shoqërisë G. sh.p.k, z. E. Gj. është dërguar observacioni i administruar në KLSH me nr. 825/10 prot., datë 02.03.2023 i cili gjen trajtim si më poshtë.

Pretendimi i subjektit:

“Duke parë që observacioni jonë për akt konstatimin është marrë në konsideratë pjesërisht, lidhur me pjesën, e cila nuk është marrë në konsideratë nga Grupi i Auditimit, ju dërgojmë dokumentacionin provues, që vërteton dhe dokumenton të kundërtën e konstatimit. Gjithashtu, në rast se gjykohet e nevojshme nga ana Juaj, kërkojmë që të jemi pjesë në ballafaqimin që do të bëhet në KLSH, si palë e atakuar në projekt raport.”.

Qëndrimi i Audituesve shtetërorë të KLSH

Në përfundim të shqyrtimit të plotë të observacioneve si më sipër Grupi i Auditimit, pasi analizoi dhe vlerësoi me objektivitet, profesionalizëm dhe pavarësi arriti në konkluzionin se materialet e dorëzuara nga ana e **ing. E. Gj.** janë përsëritje e atyre të dorëzuara me observacionet në lidhje me

²² “Të gjitha objektet e përkufizuara në nenin 3 duhet t’i nënshtrohen kolaudimit tekniko-ekonomik, i cili ka për qëllim të verifikojë nëse:

1. objektet është realizuar në kushtet teknike;
2. objektet është realizuar në përputhje me kontratën dhe anekset e saj;
3. çmimet e aplikuar janë sipas përcaktimeve të kontratës;
4. në këtë akt verifikohen edhe kërkesat e zbatuesit të paraqitura gjatë zbatimit të punimeve

²³ Kolaudatori ose grupi i kolaudimit duhet të verifikojë me përgjegjësi:

- a. Realizimin e objektit, në përputhje me projektin, lejen e ndërtimit, standardet dhe rregullat teknike.
- b. Realizimin e objektit, në përputhje me kontratën e nënshkruar.
- c. Përputhjen e dokumenteve me të dhënat nga matjet në dimension, formë, sasi dhe cilësi.
- ç. Përputhjen e vlerës së preventivuar dhe të kontraktuar me atë të paraqitur në situacionin përfundimtar, si dhe sqarimet përkatëse, në rastet e mospërputhjes.

Punimet e ndërtimit, të përkufizuara në nenin 3, duhet të projektohen dhe të zbatohen në tërësi ose në pjesë të veçanta në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit, kushtet teknike të zbatimit, si dhe me destinacionin e tyre, duke pasur parasysh edhe anën ekonomike të tyre.

²⁴ “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3 ku përcaktohet se: 3.2 Libreza e masave për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit. 3.3 Situacionet mujore pjesore, progresive dhe përfundimtare hartohen mbi bazën e vëllimeve të llogaritura në librezën e masave dhe çmimeve faktike, mbështetur në analizat teknike të çmimeve, që përfshihen në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit, të miratuara çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave. Ato firmosen nga drejtuesi teknik i objektit, mbikëqyrësi i punimeve dhe përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit për të cilin është miratuar leja e ndërtimit. Në rastet kur në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit mungojnë analizat teknike të çmimeve të zërave të punimeve të kryera në objekt, veprohet në përputhje me procedurën e përcaktuar në pikën 8 të vendimit nr. 514, datë 15.8.2007 të Këshillit të Ministrave “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”.

²⁵ Pika 8.1: “Situacionet pjesore hartohen në lloje, zëra, sasi, çmim e vlerë, sipas kontratës dhe ndryshimeve të urdhëruara nga investitori. Zërat, sasi, çmimet jashtë kontratës dhe përdorimi i fondit rezervë në situacionin përfundimtar justifikohen me dokumentacionin përkatës”

aktin e konstatimit e si të tilla kanë gjetur trajtim të plotë në Projektraport. Për sa më sipër pretendimet nuk qëndrojnë dhe ato nuk rrëzojnë konstatimet e Grupit të Auditimit.

Sa më sipër është mbajtur *Akt konstatimi nr.07* , datë 13.01.2023

• **Zhvillimi i Procedurës** "Sistemimi i furnizimit me ujë të zonës Turistike Hamallaj, Faza II, Nj. Adm. Sukth, Bashkia Durrës".

Përshkrimi i procedurës

Ky projekt përfshin ndërtimin e rrjetit të ujësjellësit për zonën e banuar të fshatit Hamallaj përkatësisht zonat Armath, Sektor si dhe komplekset turistike në zonë. Me shkresën nr. 331 Prot. datë 18.02.2020 dërgohet ndarja e fondit për ndërtim montim drejtim dhe kolaudim punimesh për objektin në fjalë nga AKUM.

Fondi Limit

Fondi limit në vlerën: 133,470,441.23 leke (pa TVSH).

Përmbledhja e procedurës në tabelë

Procedura e Prokurimit "Sistemimi i furnizimit me ujë të zonës Turistike Hamallaj, Faza II, Nj. Adm. Sukth, Bashkia Durrës"		
Urdhër Prokurimi nr.984/4 prot, date 26.02.2020		
1.Lloji i Procedurës se Prokurimit Procedurë e hapur pune	2. Njesia e prokurimit Znj.A. B. z. B. M. znj. D. B.	3. Komisioni i Vleresimit to Ofertave Sipas Urdhrit nr. 984/6, date 26.03.2020 z. D. Gj. (Kryetar) z. O. K. (Anëtar) z. D. S. (Anëtar)
4. Komisioni i Hartimit të Specifikimeve Teknike z. L. F. z. N. S.		
5. Fondi Limit (pa tvsh) 133,470,441.23 leke	6. Oferta Fituese (pa tvsh) 130,146,289.00 leke	7. Diferenca me fondin Limit (pa tvsh) 3,324,152.23 leke
8. Data e hapjes se ofertave 27.04.2020	9. Burimi i Financimit Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomikë 1. "K." shpk & "A." shpk & "C. R. 2008" shpk – 101,419,354.00 lekë pa TVSH 2. "B." shpk & "H." shpk & "L." shpk – 130,146,289.00 .
11. Ankime 1. Nr.43, Prot., dt.15.05.2020	12. Përgjigje e ankesës nga AK 1. Nr. 948/1 Prot., dt. 22.05.2020	13. Përgjigje ankesës nga KPP
b.Zbatimi i Kontratës se Punimeve/Shërbimeve/Mallrave		
14. Lidhje e kontratës Nr.1516 Prot. date 07.08.2020	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 156,175,546 leke me TVSH	16.
17. Situacioni përfundimtar/fature malli/shërbimi Situacion përfundimtar datë 08.09.2021	18. Afati i kontratës ne dite. Afati i realizimit 200 Ditë	19. Zgjatja e kontratës me dite

Sipas Urdhrit nr. 984/1 Prot. datë 19.03.2020, z. L. F. dhe z. N. S. urdhërohen të hartojnë në mënyrë të detajuar specifikimet teknike si dhe kërkesat për kualifikimin e operatorëve ekonomik.

Gjatë auditimit të specifikimeve teknike, grupi i auditimit vëren kriteret teknike të cilat duken të ekzagjëruara përsa i përket objektit të kontratës, si më poshtë:

Licencat e mëposhtme:

-NP.5-B Punime nëntokësore, ura e vepra arti

Sipas projektit dhe preventivit të hartuar nga ana e projektuesit dhe të miratuar nga ana e AK nuk rezulton asnjë zë i vetëm punimesh që të ketë lidhje me ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime, me anë të përdorimit të mjeteve teknike speciale, të ndërhyrjeve nëntokë që janë të lidhura me ndjeshmërinë e lëvizshmërisë mbi "goma" ose mbi "hekur", kushdo që të je të shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo veprë lidhëse, plotësime ose pajisje, në pika të veçanta ose në rrjet, rrugët hyrëse të çdo shkalle rëndësie, devijimet në nivele dhe në lartësi, punime të mureve mbajtëse. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar galeritë natyrore, shpime, kalime nëntokësore, tunele. Në kushte të tilla vendosja e licencës së mësipërme është një kriter diskriminues dhe përtej kapacitetit të nevojshëm që i duhet OE pjesëmarrës për të kryer një projekt të tillë i cili as nuk ka parashikuar punime për këtë kategori licence.

NP. 11-A Ndërtime për N/Stac., kab. e transform., linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë

Sipas projektit dhe preventivit të hartuar nga ana e projektuesit dhe të miratuar nga ana e AK nuk rezulton asnjë zë i vetëm punimesh që të ketë lidhje me ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshëm për shpërndarjen e T/N dhe tensionit të mesëm dhe për transformimin dhe shpërndarjen e tensionit të ulët deri te përdoruesit e energjisë elektrike, të kompletuar me punimet e muraturës, plotësuese ose ndihmëse, të veçanta ose të rrjetit. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar centrale dhe kabina transformacioni, shtyllat metalike të nevojshme për transportin dhe shpërndarjen e çfarëdo lloj tensioni, furnizimin dhe vendosjen në vepër të linjave elektrike për çfarëdo numër fazash elektrike, ajrore ose tokësore.

Në kushte të tilla vendosja e licencës së mësipërme është një kriter diskriminues dhe përtej kapacitetit të nevojshëm që i duhet OE pjesëmarrës për të kryer një projekt të tillë i cili as nuk ka parashikuar punime për këtë kategori licence.

NS. 1-A Punime për prishjen e ndërtimeve

Sipas projektit dhe preventivit të hartuar nga ana e projektuesit dhe të miratuar nga ana e AK nuk rezulton asnjë zë i vetëm punimesh që të ketë lidhje me çmontimin i impianteve industriale dhe prishjen komplet të ndërtesave me pajisje speciale ose me përdorim eksplozivi me prerje të strukturave betonarme dhe prishjeve në përgjithësi, përfshi edhe grumbullimin e mbeturinave, ndarjen e tyre dhe riciklimin e materialeve. Në kushte të tilla vendosja e licencës së mësipërme është një kriter diskriminues dhe përtej kapacitetit të nevojshëm që i duhet OE pjesëmarrës për të kryer një projekt të tillë i cili as nuk ka parashikuar punime për këtë kategori licence.

Për të provuar se ka përvojën e duhur, Operatori duhet të dëshmojë se ka të punësuar mesatarisht 150 punonjës, ku përvoja e duhur nuk mund të matet me numrin e personave që ka të punësuar por me realizimet e projekteve të mëparshme dhe punëve të ngjashme.

Drejtuesi Teknik të ketë përvojë jo më pak se 10 vjet, kriteret të cilat diskriminojnë operatorët e tjerë si dhe drejtuesit teknik të cilët anën profesionale të tyre e dëshmon licenca përkatëse që kanë.

12. Titulli i gjetjes:	Vendosja e kriterëve dhe specifikimeve teknike diskriminuese për pjesëmarrjen e O.E. në garë.
Situata:	Gjatë zhvillimi të Procedurës së Prokurimit me objekt “Sistemimi i furnizimit me ujë të zonës Turistike Hamallaj, Faza II, Nj. Adm. Sukth, Bashkia Durrës” gjatë hartimit të specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta, janë vendosur kriterë të cilat nën gjykimin e audituesve janë të ekzagjeruara dhe jo në proporcion me objektin e kontratës si më poshtë: Vendosja e licencave të mëposhtme: NP.5-B Punime nëntokësore, ura e vepra arti. NP. 11-A Ndërtime për N/Stac., kab. e transform., linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë. NS. 1-A Punime për prishjen e ndërtimeve. ku bazuar në VKM nr. 943 datë 28.12.2016²⁶ nuk janë në proporcion me objektin e kontratës si dhe me zërat dhe punimet e detajuara në preventivin e punimeve. Vendosja e kriterëve si më poshtë: -Për të provuar se ka përvojën e duhur, Operatori duhet të dëshmojë se ka të punësuar mesatarisht 150 punonjës, ku përvoja e duhur nuk mund të matet me numrin e personave që ka të punësuar por me realizimet e projekteve të mëparshme dhe punëve të ngjashme. -Drejtuesi Teknik të ketë përvojë jo më pak se 10 vjet, kriterë të cilat diskriminojnë operatorët e tjerë si dhe drejtuesit teknik të cilët anën profesionale të tyre e dëshmon licenca përkatëse që kanë.
Kriteri:	Neni 23 “Specifikimet Teknike”, Ligji nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.
Ndikimi/Efekti:	Pengon konkurrencën e drejtë
Shkaku:	Hartimi i specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta diskriminuese.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	UK Durrës sh.a., në zhvillimin e procedurave të prokurimit, veçanërisht në hartimin e kriterëve të veçanta, të ketë parasysh që të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, përmbajtjen e tij duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve.

Për sa më sipër, ngarkohen me përgjegjësi hartuesit të specifikimeve teknike z. L. F. dhe z. N. S.

Sa më sipër është mbajtur *Akt konstatimi nr.08* , datë 13.01.2023

Përsa është trajtuar në këtë pjesë të P/Raportit të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacion me shkresë nr.825/12 prot, datë 15.03.2023 “Observacion mbi Akt Konstatimin Nr.08 datë 13.01.2023 në lidhje me procedurën e prokurimit “Sistemimi i furnizimit me ujë të zonës

²⁶ Për Disa Ndryshime Dhe Shtesa Në Vendimin Nr.759, Datë 12.11.2014, Të Këshillit Të Ministrave, "Për Licencimin Profesional Të Individëve Dhe Personave Juridikë Që Do Të Ushtrorin Veprimtari Në Fushën E Studimit E Të Projektimit Në Ndërtim Dhe Mbikëqyrjes E Kolaudimit Të Punimeve Të Zbatimit Në Ndërtim"

Turistike Hamallaj, Faza II, Nj. Adm. Sukth, Bashkia Durrës” nga z. S. K., ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

Janë kërkuar kategoritë përkatëse të licencave pasi:

Kategoria NP-5 Punime nëntokësore kërkohet sepse gjatë implementimit të projektit kemi intersektimet e rrugës kryesore me kanalet kulluese të zonës dhe duhet të kryhen punime speciale duke ditur se këto objekte janë të rëndësishme së veçantë.

Kategoria NS-1 Ndërtimet për nënstacione, kabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike) duke qenë se investimi shtrihet në një zonë relativisht të gjerë shpesh herë dëmtohen dhe linjat e shpërndarjes së energjisë elektrike pra O.E. duhet të ketë kapacitet për të zgjidhur këto problematika.

Kategoria NS-1 Punime për prishjen e ndërtimeve projekt i ri shtrihet pranë kompleksit turistik V, ku në disa pjesë është parashikuar të prishet rrethimi pasi do kalojë pjesërisht rrjeti i furnizimit me ujë.

Janë kërkuar ai numër punonjësish dhe drejtues Teknik me ato vite eksperiencë pas objekti ka një vështirësi në realizim dhe O.E. duhet të disponojë stafin e nevojshëm me kohët të plotë në mënyrë që të kryhen punimet sipas specifikimeve dhe në afat.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit të KLSH –së:

Në lidhje me observacionin e bërë nga ana e hartuesve të specifikimeve teknike z. L. F. dhe z. N. S., grupi i auditimit pas analizimit të observacionit mban të njëjtin qëndrim mbi gjetjen duke cituar dhe njëherë që në preventivin e punimeve nuk përfshihen zëra punimesh të cilat arsyetojnë pajisjen e O.E. me licencat e mësipërme. Gjithashtu edhe për sa i përket numrit të punonjësve gjithashtu ricalësohet se nuk mund të provohet përvoja e duhur me numrin e personave që ka të punësuar por me realizimet e projekteve të mëparshme dhe punëve të ngjashme si dhe Drejtuesi Teknik të ketë përvojë jo më pak se 10 vjet, kriteret të cilat diskriminojnë operatorët e tjerë si dhe drejtuesit teknik të cilët anën profesionale të tyre e dëshmon licenca përkatëse që kanë.

Për këto arsye, sa më sipër, observacioni juaj nuk pranohet.

• **Zhvillimi i Procedurës "Ndërtim i rrjetit të KUZ të fshatit Shënavlash, Bashkia Durrës"**

Përshkrimi i procedurës

Ndërtimi i rrjetit KUZ të fshatit Shënavlash, Bashkia Durrës, sipas të cilit u synua të ndërtohen rrjet kanalizimesh me rrjedhje të lirë dhe si pikë fundore është Impianti i Trajtimit të Ujërave të Ndotura në Vrrin. Referua shkresës nr.2583 Prot., datë 24.11.2020 nga Agjencia Kombëtare e Ujësjetllës Kanalizime dhe Infrastrukturës së Mbetjeve,u dërgua detajimi mbi financimin e tre objekteve dhe dosjet teknike.

Fondi Limit

Fondi limit në vlerën: **364,498,645 leke (pa TVSH).**

Përmbledhja e procedurës në tabelë

Procedura e Prokurimit " Ndërtim i rrjetit të KUZ të fshatit Shënavlash, Bashkia Durrës "
--

Urdhër Prokurimi nr.3491/4 prot, date 04.12.2020		
1.Lloji i Procedurës së Prokurimit Procedurë e hapur pune	2. Njesia e prokurimit Znj.A. B. z. B. M. znj. D. B.	3. Komisioni i Vleresimit të Ofertave Sipas Urdhrit nr. 3491/6, date 04.12.2020 z. D. Gj. (Kryetar) z. L. F. (Anëtar) znj. M. H. (Anëtar)
4. Komisioni i Hartimit të Specifikimeve Teknike z. N. S. z. E. S. z. A. K.		
5. Fondi Limit (pa tvsh) 364,498,645 leke	6. Oferta Fituese (pa tvsh) 352,017,419 leke	7. Diferenca me fondin Limit (pa tvsh) 12,481,226 leke
8. Data e hapjes së ofertave 06.01.2021	9. Burimi i Financimit Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomikë 1. "K. C. shpk 244,224,908 lekë pa tsh 2. "E.&2." shpk
11. Ankime -	12. Pergjigje e ankesës nga AK -	13. Grupi i ndjekjes së Kontratës Znj. D. S. z. A. K. z. T. D.
b.Zbatimi i Kontratës së Punimeve/Shërbimeve/Mallrave		
14. Lidhje e kontratës Nr.1453 Prot. date 24.03.2021	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 422,420,903leke me TVSH	18. Afati i kontratës në ditë. Afati i realizimit 540 Ditë

Sipas Urdhrit nr. 3491/1 Prot. datë 03.12.2020, z. N. S., z. E. S. dhe z. A. K. urdhërohen të hartojnë në mënyrë të detajuar specifikimet teknike si dhe kërkesat për kualifikimin e operatorëve ekonomik.

Gjatë auditimit të specifikimeve teknike, grupi i auditimit vëren kriteret teknike të cilat duken të ekzagjuruara përsa i përket objektit të kontratës, si më poshtë:

Licencat e mëposhtme:

- *NP.5-B Punime nëntokësore, ura e vepra arti*

Sipas projektit dhe preventivit të hartuar nga ana e projektuesit dhe të miratuar nga ana e AK nuk rezultojn asnjë zë i vetëm punimesh që të ketë lidhje me ndërtime, mirëmbajtje ose rristurime, me anë të përdorimit të mjeteve teknike speciale, të ndërhyrjeve nëntokë që janë të lidhura me ndjeshmërinë e lëvizshmërisë mbi "goma" ose mbi "hekur", kushdo që të je të shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo veprë lidhëse, plotësime ose pajisje, në pika të veçanta ose në rrjet, rrugët hyrëse të çdo shkalle rëndësie, devijimet në nivele dhe në lartësi, punime të mureve mbajtëse. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar galeritë natyrore, shpime, kalime nëntokësore, tunele. Në kushte të tilla vendosja e licencës së mësipërme është një kriter diskriminues dhe përtej kapacitetit të nevojshëm që i duhet OE pjesëmarrës për të kryer një projekt të tillë i cili as nuk ka parashikuar punime për këtë kategori licence.

- *NP. 11-A Ndërtime për N/Stac., kab. e transform., linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë*

Sipas projektit dhe preventivit të hartuar nga ana e projektuesit dhe të miratuar nga ana e AK nuk rezultojn asnjë zë i vetëm punimesh që të ketë lidhje me ndërtime, mirëmbajtje ose rristurime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshëm për shpërndarjen e T/N dhe tensionit të mesëm dhe për transformimin dhe shpërndarjen e tensionit të ulët deri te përdoruesit e energjisë elektrike, të kompletuar me punimet e muraturës, plotësuese ose ndihmëse, të veçanta ose të rrjetit. Përfshin në

mënyrë të thjeshtuar centrale dhe kabina transformacioni, shtyllat metalike të nevojshme për transportin dhe shpërndarjen e çfarëdo lloj tensioni, furnizimin dhe vendosjen në vepër të linjave elektrike për çfarëdo numër fazash elektrike, ajrore ose tokësore.

Në kushte të tilla vendosja e licencës së mësipërme është një kriter diskriminues dhe përtej kapacitetit të nevojshëm që i duhet OE pjesëmarrës për të kryer një projekt të tillë i cili as nuk ka parashikuar punime për këtë kategori licence.

- *NS. 1-A Punime për prishjen e ndërtimeve*

Sipas projektit dhe preventivit të hartuar nga ana e projektuesit dhe të miratuar nga ana e AK nuk rezulton asnjë zë i vetëm punimesh që të ketë lidhje me çmontimin i impianteve industriale dhe prishjen komplet të ndërtesave me pajisje speciale ose me përdorim eksplozivi me prerje të strukturave betonarmeje dhe prishjeve në përgjithësi, përfshi edhe grumbullimin e mbeturinave, ndarjen e tyre dhe riciklimin e materialeve. Në kushte të tilla vendosja e licencës së mësipërme është një kriter diskriminues dhe përtej kapacitetit të nevojshëm që i duhet OE pjesëmarrës për të kryer një projekt të tillë i cili as nuk ka parashikuar punime për këtë kategori licence.

- *NS 9-A Punime strukturore special*

Sipas projektit dhe preventivit të hartuar nga ana e projektuesit dhe të miratuar nga ana e AK nuk rezulton asnjë zë i vetëm punimesh që të ketë lidhje me ndërtimin e objektit të destinuar për transmetim ngarkese të realizuar në terrene jo të përshtatshme për mbajtjen e këtyre ngarkesave, të objekteve të destinuara për t'u ndërtuar në terrene rezistente dhe jo të deformueshme, por me parashikime të lëvizjeve gjeologjike, të objekteve me karakter antisizmik të strukturave ekzistuese. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar zbatimin e pilotëve të çfarëdolloj tipi, të themeleve nëntokësore me pilotë ose me mure mbajtëse, me ankorim, të objekteve që duhet të rivlerësohen nga funksioni statik i strukturës, me zbatim të punimeve nëntokësore me mjete speciale, përfshirë edhe marrjen e kampioneve për analiza laboratorit nga pikëpamja gjeoteknike, gjithashtu të provave me ngarkesë, të sondave të veprave që sigurojnë qëndrueshmërinë e shpateve. Impermeabilizim dhe konsolidimin e terreneve. Në kushte të tilla vendosja e licencës së mësipërme është një kriter diskriminues dhe përtej kapacitetit të nevojshëm që i duhet OE pjesëmarrës për të kryer një projekt të tillë i cili as nuk ka parashikuar punime për këtë kategori licence.

Drejtuesi Teknik të ketë përvojë jo më pak se 10 vjet, kritere të cilat diskriminojnë operatorët e tjerë si dhe drejtuesit teknik të cilët anën profesionale të tyre e dëshmon licenca përkatëse që kanë.

Për sa i përket procedurës së mësipërme ka pasur dhe një ankesë mbi specifikimet teknike nga Operatori Ekonomik R. C.. Ankesa nuk është marrë parasysh duke u mjaftuar me faktin që është sjellë jashtë afateve. Me datë 30.03.2020 është bërë publikimi i njoftimit të kontratës me mjete elektronike për procedurën e mësipërme nga APP. O.E. ka paraqitur ankesë e cila është protokolluar pranë UK Durrës sh.a. me datë 06.04.2020 por që në Formularin e ankesës pranë autoriteti kontraktor mban datën 01.04.2020. Edhe nëse marrim parasysh datën e mësipërme, 06.04.2020 afati prej 7 ditësh siç është i cituar në ligj është respektuar. Reflektimi i ankesës së O.E. do të kishte bërë të mundur përfshirjen e shumë operatorëve të tjerë, ku vlen të përmendet se dhe gjetjet e grupit të auditimit përkohë me ankesën e O.E.

13. Titulli i gjetjes:	Vendosja e kriterëve dhe specifikimeve teknike diskriminuese për pjesëmarrjen e O.E. në garë.
Situata:	Gjatë zhvillimi të Procedurës së Prokurimit me objekt “Ndërtim i rrjetit të KUZ të fshatit Shënavlash, Bashkia Durrës” gjatë hartimit të specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta, janë vendosur kriterë të cilat nën gjykimin e audituesve janë të ekzagjeruara dhe jo në proporcion me objektin e kontratës si më poshtë: Vendosja e licencave të mëposhtme: NP.5-B Punime nëntokësore, ura e vepra arti; NP. 11-A Ndërtime për N/Stac., kab. e transform., linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë; NS. 1-A Punime për prishjen e ndërtimeve ku bazuar në VKM nr. 943 datë 28.12.2016²⁷ nuk janë në proporcion me objektin e kontratës si dhe me zërat dhe punimet e detajuara në preventivin e punimeve. Vendosja e kriterit si më poshtë: -Drejtuesi Teknik të ketë përvojë jo më pak se 10 vjet kriterë të cilat diskriminojnë operatorët e tjerë si dhe drejtuesit teknik të cilët anën profesionale të tyre e dëshmon licenca përkatëse që kanë.
Kriteri:	Neni 23 “Specifikimet Teknike”, Ligji nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.
Ndikimi/Efekti:	Pengon konkurrencën e drejtë
Shkaku:	Hartimi i specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta diskriminuese.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	UK Durrës sh.a., në zhvillimin e procedurave të prokurimit, veçanërisht në hartimin e kriterëve të veçanta, të ketë parasysh që të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, përmbajtjen e tij duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve.

Për sa më sipër, ngarkohen me përgjegjësi z. A. K., z. N. S. dhe z. E.S., në cilësinë e hartuesve të specifikimeve teknike, në kundërshtim me Nenin 46 të Ligjit për Prokurimin Publik “Kualifikimi i ofertuesve”.

Sa më sipër është mbajtur *Akt konstatimi nr.09*, datë 13.01.2023

Përsa është trajtuar në këtë pjesë të P/Raportit të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacion me shkresë nr.825/12 prot, datë 15.03.2023 “Observacion mbi Akt Konstatimin Nr.08 datë 13.01.2023 në lidhje me procedurën e prokurimit “Sistemi i furnizimit me ujë të zonës Turistike Hamallaj, Faza II, Nj. Adm. Sukth, Bashkia Durrës” nga z. S. K., ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

Janë kërkuar kategoritë përkatëse të licencave pasi:

Kategoria NP-5 Punime nëntokësore kërkohet sepse gjatë implementimit të projektit kemi

²⁷ Për Disa Ndryshime Dhe Shtesa Në Vendimin Nr.759, Datë 12.11.2014, Të Këshillit Të Ministrave, "Për Licencimin Profesional Të Individëve Dhe Personave Juridikë Që Do Të Ushtrijnë Veprimtari Në Fushën E Studimit E Të Projektimit Në Ndërtim Dhe Mbikëqyrjes E Kolaudimit Të Punimeve Të Zbatimit Në Ndërtim"

intersektimet e rrugës kryesore me kanalet kulluese të zonës dhe duhet të kryhen punime speciale duke ditur se këto objekte janë të rëndësishme së veçantë.

Kategoria NS-1 Ndërtimet për nënstacione, kabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike) duke qenë se investimi shtrihet në një zonë relativisht të gjerë shpesh herë dëmtohen dhe linjat e shpërndarjes së energjisë elektrike pra O.E. duhet të ketë kapacitet për të zgjidhur këto problematika.

Kategoria NS-1 Punime për prishjen e ndërtimeve projekt i ri shtrihet pranë kompleksit turistik “V”, ku në disa pjesë është parashikuar të prishet rrethimi pasi do kalojë pjesërisht rrjeti i furnizimit me ujë.

Janë kërkuar ai numër punonjësish dhe drejtues Teknik me ato vite eksperiencë pas objekti ka një vështirësi në realizim dhe O.E. duhet të disponojë stafin e nevojshëm me kohët të plotë në mënyrë që të kryhen punimet sipas specifikimeve dhe në afat.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit të KLSH –së:

Në lidhje me observacionin e bërë nga ana e z. S. K., grupi i auditimit pas analizimit të observacionit mban të njëjtin qëndrim mbi gjetjen duke cituar dhe njëherë që në preventivin e punimeve nuk përfshihen zëra punimesh të cilat arsyetojnë pajisjen e O.E. me licencat e mësipërme. Gjithashtu edhe për sa i përket Drejtuesi Teknik të ketë përvojë jo më pak se 10 vjet, kriteret të cilat diskriminojnë operatorët e tjerë si dhe drejtuesit teknik të cilët anën profesionale të tyre e dëshmon licenca përkatëse që kanë.

Për këto arsye, sa më sipër, observacioni juaj nuk pranohet.

- **Zhvillimi i Procedurës "Përmirësim i furnizimit me ujë lagja nr.1, Vardardh, nj. Adm Sukth, Bashkia Durrës".**

Përshkrimi i procedurës

Me shkresën nr. 332 Prot., datë 18.02.2020 dërgohet ndarja e fondit për ndërtim, montim, drejtim dhe kolaudim punimesh për objektin “Përmirësimi i furnizimit me ujë Lagjja nr.1, Vardardhë, Njësia Administrative Sukth, Bashkia Durrës”. Ky projekt përfshin ndërtimin e rrjetit të ujësjetillësit për zonën e banuar të Vardardhës, si vazhdimësi e plotësimit me investim të ri të zonave që furnizohen me ujë të pijshëm me anë të tubacionit kryesor.

Fondi Limit

Fondi limit në vlerën: **131,441,922.06 lekë (pa TVSH).**

Përmbledhja e procedurës në tabelë

Procedura e Prokurimit "Përmirësim i furnizimit me ujë lagja nr.1, Vardardh, nj. Adm Sukth, Bashkia Durrës"		
Urdhër Prokurimi nr.985/4 prot, date 27.03.2020		
1.Lloji i Procedurës së Prokurimit Procedurë e hapur pune	2. Njesia e prokurimit Znj. A. B. z. B. M. znj. D. B.	3. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave Sipas Urdhrit nr. 3491/6, date 04.12.2020 z. D. Gj. (Kryetar) z. G. D. (Anëtar) znj. M. B. Anëtar

4. Komisioni i Hartimit të Specifikimeve Teknike Znj. D. S. z. E. S.		
5. Fondi Limit (pa tvsh) 131,441,922 leke	6. Oferta Fituese (pa tvsh) 127,727,766 leke	7. Diferenca me fondin Limit (pa tvsh) 3,714,155 leke
8. Data e hapjes se ofertave 29.04.2020	9. Burimi i Financimit Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomikë 1. "K." shpk & "S." shpk & "L." sh.a. – 127,727,766.20 lekë pa TVSH 2. "C." shpk – Pa ofertë ekonomike 3. "B." shpk – 129,507,323.98 lekë pa TVSH.
11. Ankimime Nr. 679 Prot. Datë 06.04.2020	12. Pergjigje e ankesës nga AK -	13. Grupi i ndjekjes së Kontratës Znj. D. S. z. A. K. z. T. D.
b.Zbatimi i Kontratës se Punimeve/Shërbimeve/Mallrave		
14. Lidhje e kontratës Nr.1520 Prot. date 10.08.2021	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 153.273.319 leke me TVSH	16. Afati i kontratës ne dite. Afati i realizimit 200 Ditë

Sipas Urdhrit nr. 3491/1 Prot. datë 03.12.2020, z. N. S., z. E. S. dhe z. A. K. urdhërohen të hartojnë në mënyrë të detajuar specifikimet teknike si dhe kërkesat për kualifikimin e operatorëve ekonomik.

Gjatë auditimit të specifikimeve teknike, grupi i auditimit vëren kriteret teknike të cilat duken të ekzagjëruara përsa i përket objektit të kontratës, si më poshtë:

- Licencat e mëposhtme:

- *NP.5-B Punime nëntokësore, ura e vepra arti*

Sipas projektit dhe preventivit të hartuar nga ana e projektuesit dhe të miratuar nga ana e AK nuk rezulton asnjë zë i vetëm punimesh që të ketë lidhje me ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime, me anë të përdorimit të mjeteve teknike speciale, të ndërhyrjeve nëntokë që janë të lidhura me ndjeshmërinë e lëvizshmërisë mbi "goma" ose mbi "hekur", kushdo që të je të shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo veprë lidhëse, plotësime ose pajisje, në pika të veçanta ose në rrjet, rrugët hyrëse të çdo shkalle rëndësie, devijimet në nivele dhe në lartësi, punime të mureve mbajtëse. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar galeritë natyrore, shpime, kalime nëntokësore, tunele. Në kushte të tilla vendosja e licencës së mësipërme është një kriter diskriminues dhe përtej kapacitetit të nevojshëm që i duhet OE pjesëmarrës për të kryer një projekt të tillë i cili as nuk ka parashikuar punime për këtë kategori licence.

- *NP. 11-A Ndërtime për N/Stac., kab. e transform., linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë*

Sipas projektit dhe preventivit të hartuar nga ana e projektuesit dhe të miratuar nga ana e AK nuk rezulton asnjë zë i vetëm punimesh që të ketë lidhje me ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshëm për shpërndarjen e T/N dhe tensionit të mesëm dhe për transformimin dhe shpërndarjen e tensionit të ulët deri te përdoruesit e energjisë elektrike, të kompletuar me punimet e muraturës, plotësuese ose ndihmëse, të veçanta ose të rrjetit. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar centrale dhe kabina transformacioni, shtyllat metalike të nevojshme për transportin dhe shpërndarjen e çfarëdo lloj tensioni, furnizimin dhe vendosjen në vepër të linjave elektrike për çfarëdo numër fazash elektrike, ajrore ose tokësore.

Në kushte të tilla vendosja e licencës së mësipërme është një kriter diskriminues dhe përtej kapacitetit të nevojshëm që i duhet OE pjesëmarrës për të kryer një projekt të tillë i cili as nuk ka parashikuar punime për këtë kategori licence.

- *NS. 1-A Punime për prishjen e ndërtimeve*

Sipas projektit dhe preventivit të hartuar nga ana e projektuesit dhe të miratuar nga ana e AK nuk rezulton asnjë zë i vetëm punimesh që të ketë lidhje me çmontimin i impianteve industriale dhe prishjen komplet të ndërtesave me pajisje speciale ose me përdorim eksplozivi me prerje të strukturave betonarme dhe prishjeve në përgjithësi, përfshi edhe grumbullimin e mbeturinave, ndarjen e tyre dhe riciklimin e materialeve. Në kushte të tilla vendosja e licencës së mësipërme është një kriter diskriminues dhe përtej kapacitetit të nevojshëm që i duhet OE pjesëmarrës për të kryer një projekt të tillë i cili as nuk ka parashikuar punime për këtë kategori licence.

- *NS 9-A Punime strukturore special*

Sipas projektit dhe preventivit të hartuar nga ana e projektuesit dhe të miratuar nga ana e AK nuk rezulton asnjë zë i vetëm punimesh që të ketë lidhje me ndërtimin e objektit të destinuar për transmetim ngarkese të realizuar në terrene jo të përshtatshme për mbajtjen e këtyre ngarkesave, të objekteve të destinuara për t'u ndërtuar në terrene rezistente dhe jo të deformueshme, por me parashikime të lëvizjeve gjeologjike, të objekteve me karakter antisizmik të strukturave ekzistuese. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar zbatimin e pilotëve të çfarëdolloj tipi, të themeleve nëntokësore me pilotë ose me mure mbajtëse, me ankorim, të objekteve që duhet të rivlerësohen nga funksioni statik i strukturës, me zbatim të punimeve nëntokësore me mjete speciale, përfshirë edhe marrjen e kampioneve për analiza laboratoriale nga pikëpamja gjeoteknike, gjithashtu të provave me ngarkesë, të sondave të veprave që sigurojnë qëndrueshmërinë e shpateve. Impermeabilizim dhe konsolidimin e terreneve. Në kushte të tilla vendosja e licencës së mësipërme është një kriter diskriminues dhe përtej kapacitetit të nevojshëm që i duhet OE pjesëmarrës për të kryer një projekt të tillë i cili as nuk ka parashikuar punime për këtë kategori licence.

Drejtuuesi Teknik të ketë përvojë jo më pak se 10 vjet, kritere të cilat diskriminojnë operatorët e tjerë si dhe drejtuesit teknik të cilët anën profesionale të tyre e dëshmon licenca përkatëse që kanë.

Për sa i përket procedurës së mësipërme ka pasur dhe një ankesë mbi specifikimet teknike nga Operatori Ekonomik R. C.. Ankesa nuk është marrë parasysh duke u mjaftuar me faktin që është sjellë jashtë afateve. Me datë 30.03.2020 është bërë publikimi i njoftimit të kontratës me mjete elektronike për procedurën e mësipërme nga APP. O.E. ka paraqitur ankesë e cila është protokolluar pranë UK Durrës sh.a. me datë 06.04.2020 por që në Formularin e ankesës pranë autoriteti kontraktor mban datën 01.04.2020. Edhe nëse marrim parasysh datën e mësipërme, 06.04.2020 afati prej 7 ditësh siç është i cituar në ligj është respektuar. Reflektimi i ankesës së O.E. do të kishte bërë të mundur përfshirjen e shumë operatorëve të tjerë, ku vlen të përmendet se dhe gjetjet e grupit të auditimit përkohë me ankesën e O.E.

14. Titulli i gjetjes:	Vendosja e kriterëve dhe specifikimeve teknike diskriminuese për pjesëmarrjen e O.E. në garë.
Situata:	Gjatë zhvillimi të Procedurës së Prokurimit me objekt “Përmirësim i furnizimit me ujë lagja nr.1, Vardardh, nj. Adm Sukth, Bashkia Durrës” gjatë hartimit të specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta, janë vendosur kriterë të cilat nën gjykimin e audituesve janë të ekzagjeruara dhe jo në proporcion me objektin e kontratës si më poshtë: Vendosja e licencave të mëposhtme: <i>NP.5-B Punime nëntokësore, ura e vepra arti</i> <i>NP. 11-A Ndërtime për N/Stac., kab. e transform., linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë</i> <i>NS. 1-A Punime për prishjen e ndërtimeve</i> <i>NS 9-A Punime strukturore special</i> ku bazuar në VKM nr. 943 datë 28.12.2016²⁸ nuk janë në proporcion me objektin e kontratës si dhe me zërat dhe punimet e detajuara në preventivin e punimeve. Vendosja e kriterit si më poshtë: <i>-Drejtuesi Teknik të ketë përvojë jo më pak se 10 vjet</i> kriterë të cilat diskriminojnë operatorët e tjerë si dhe drejtuesit teknik të cilët anën profesionale të tyre e dëshmon licensa përkatëse që kanë.
Kriteri:	Neni 23 “Specifikimet Teknike”, Ligji nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.
Ndikimi/Efekti:	Pengon konkurrencën e drejtë
Shkaku:	Hartimi i specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta diskriminuese.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	UK Durrës sh.a., në zhvillimin e procedurave të prokurimit, veçanërisht në hartimin e kriterëve të veçanta, të ketë parasysh që të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, përmbajtjen e tij duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve.

Për sa më sipër, ngarkohen me përgjegjësi znj. D. S. dhe z. E. S., në cilësinë e hartuesve të specifikimeve teknike, në kundërshtim me Nenin 46 të Ligjit për Prokurimin Publik “Kualifikimi i ofertuesve”.

Përsa është trajtuar në këtë pjesë të P/Raportit të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacion me shkresë nr.825/12 prot, datë 15.03.2023 “Observacion mbi Akt Konstatimin Nr.08 datë 13.01.2023 në lidhje me procedurën e prokurimit “Përmirësim i furnizimit me ujë lagja nr.1, Vardardh, nj. Adm Sukth, Bashkia Durrës” nga z. S. K., ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

Janë kërkuar kategoritë përkatëse të licencave pasi:

Kategoria NP-5 Punime nëntokësore kërkohet sepse gjatë implementimit të projektit kemi intersektimet e rrugës kryesore me kanalet kulluese të zonës dhe duhet të kryhen punime speciale duke ditur se këto objekte janë të rëndësishme së veçantë.

²⁸ Për Disa Ndryshime Dhe Shtesa Në Vendimin Nr.759, Datë 12.11.2014, Të Këshillit Të Ministrave, “Për Licencimin Profesional Të Individëve Dhe Personave Juridikë Që Do Të Ushtrijnë Veprimtari Në Fushën E Studimit E Të Projektimit Në Ndërtim Dhe Mbikëqyrjes E Kolaudimit Të Punimeve Të Zbatimit Në Ndërtim”

Kategoria NS-1 Ndërtimet për nënstacione, kabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike) duke qenë se investimi shtrihet në një zonë relativisht të gjerë shpesh herë dëmtohen dhe linjat e shpërndarjes së energjisë elektrike pra O.E. duhet të ketë kapacitet për të zgjidhur këto problematika.

Kategoria NS-1 Punime për prishjen e ndërtimeve projekt i ri shtrihet pranë kompleksit turistik “V”, ku në disa pjesë është parashikuar të priset rrethimi pasi do kalojë pjesërisht rrjeti i furnizimit me ujë.

Janë kërkuar ai numër punonjësish dhe drejtues Teknik me ato vite eksperiencë pas objekti ka një vështirësi në realizim dhe O.E. duhet të disponojë stafin e nevojshëm me kohët të plotë në mënyrë që të kryhen punimet sipas specifikimeve dhe në afat.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit të KLSH –së:

Në lidhje me observacionin e bërë nga ana e z. S. K., grupi i auditimit pas analizimit të observacionit mban të njëjtin qëndrim mbi gjetjen duke cituar dhe njëherë që në preventivin e punimeve nuk përfshihen zëra punimesh të cilat arsyetojnë pajisjen e O.E. me licencat e mësipërme. Gjithashtu edhe për sa i përket Drejtuesi Teknik të ketë përvojë jo më pak se 10 vjet, kriteret të cilat diskriminojnë operatorët e tjerë si dhe drejtuesit teknik të cilët anën profesionale të tyre e dëshmon licenca përkatëse që kanë.

Për këto arsye, sa më sipër, observacioni juaj nuk pranohet.

Në lidhje me Projektin

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se projekti është hartuar nga ana e studios I.ligjor A. K. Projekti i zbatimit ka parashikuar një vlerë punimesh prej 157,730,306 lekë me TVSH.

Objekti i kësaj veprë teknike është hartimi i rrjetit të shpërndarjes të furnizimit me ujë të lagjes Nr.1 Vardardhë, Njësia Administrative Sukth, Bashkia Durrës. Ndërhyrja në këtë zonë bëhet për të:

- Furnizuar me ujë zonën;
- Përmirësuar orarin të furnizimit me ujë;
- Përmirësimin e sasisë së ujit për frymë;
- Përmirësimin e cilësisë së ujit.

Në lidhje me projektin, sipas shkresës së administruar në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit me nr. 1322/4 prot., datë 07.10.2019 është dërguar në UK Durrës sh.a. Oponenca Teknike sipas të cilës është konfirmuar përputhshmëria e projektit me kërkesat e UK Durrës sh.a. Sipas dokumentacionit të mësipërm dhe atij të zbatimit rezulton se nga ana e AK nuk janë marrë masat e nevojshme për ndryshimin e projektit sipas propozimeve të bëra në oponencën teknike, konkretisht për sa i takon hidrantëve të zjarrit të cilat janë rekomanduar ti bashkëngjiten rrjetit shpërndarës sipas udhëzimeve të KTP në fuqi.

Historiku i zbatimit të punimeve

Në përfundim të procedurës së prokurimit, është shpallur fitues BOE K. & L. & S., të përfaqësuar këta nga OE K. me nr. licence për zbatim punimesh NZ. 4901/12 datë 07.04.2020 dhe me përfaqësues ligjor z. S. K. me të cilin është lidhur kontrata me Autoritetin Kontraktor e përfaqësuar nga z. K. B. me nr. 1520 prot., datë 10.08.2020 me vlerë 153,273,319.4 lekë me TVSh dhe me afat të zbatimit të punimeve 200 ditë kalendarike nga dita e nesërme e punës pas nënshkrimit të kontratës.

Për mbikëqyrjen e punimeve është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me OE Gj&Co me nr. licence për mbikëqyrje dhe kolaudim punimesh MK.1735/18 datë 04.12.2019, me përfaqësues ligjor z. H. M. sipas aktit me nr. 1521 prot., datë 10.08.2020 me vlerë të kontratës 2,423,544 lekë me TVSH.

Për kolaudimin e punimeve është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi sipas shkresës me nr. 1653/8 prot., datë 11.05.2021 me OE NET G. e përfaqësuar nga z. V. B. me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim MK.3101/10, datë 30.03.2021 me vlerë të kontratës 363,531 lekë me TVSH.

Mbi zbatimin e punimeve

Në lidhje me zërin 'Prova në tubin',

Sipas projekt-preventivit të hartuar nga ana e projektuesit rezulton se janë përfshirë në preventiv e njëkohësisht edhe në ofertën e paraqitur nga sipërmarrësi i punimeve BOE K. & L. & S. zëri për kryerjen e provës së tubit. Në fakt referuar *Specifikimeve Teknike*, Kapitulli 8, pika 8.9 *Përshkrimi i çmimit njësi të tubave për kanalizimet përcaktohet se*: “Furnizim i tubacioneve të gjitha diametrave, mbajtja, shtrirja, furnizimi i të gjitha materialeve të nevojshme, veglave, pajisjeve të kërkuara për shtrimin e tubave, fuqia punëtore, përshtatësit, bashkuesit, izoluesit, prova e tubave, sigurimi dhe instalimi i shiritave me ngjyrë, sheshimi i sipërfaqes, hekuri dhe armimi i tubave dhe të gjitha aktivitetet siç përshkruhen më sipër janë përfshirë në çmimin njësi për një metër tubacion kanalizimesh”. Gjithashtu, referuar kontratës së sipërmarrjes të lidhur mes palëve sipas aktit me nr. 1520 prot., datë 10.08.2020, neni 31 Inspektimet, pika 1 *përcaktohet se*: “Kontraktori duhet të bëjë të gjitha testet dhe inspektimet e kërkuara nga dispozitat e kontratës. Kosto e këtyre testimeve dhe inspektimeve duhet të financohet tërësisht nga Kontraktori brenda çmimit të kontratës”. Për rrjedhojë rezulton se është përfituar tepër nga ana e sipërmarrësit të punimeve shuma **336,000 lekë pa TVSH**.

Në lidhje me zërin 'F.V derë metalike',

Nga verifikimi në terren i punimeve rezultoi se dyer metalike të vendosura ishin të një cilësie shumë të dobët duke mos siguruar kështu një investim të qëndrueshëm e duke bërë që fondet e shpenzuara për këtë zë në masën prej **1,339,800 lekë pa TVSH** të konsiderohen si të përdoruara pa efektivitet eficiencë dhe ekonomikitet.

Si përfundim, rezulton se janë përfituar tepër nga ana e sipërmarrësit të punimeve vlera 336,000 lekë cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e shoqërisë UK Durrës sh.a. dhe si e tillë duhet të zhdëmtohet nga ana e BOE “K. & S. & L.” në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve. Njëkohësisht rezulton se është përdorur pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet shuma prej 1,339,800 lekë pa TVSH si rrjedhojë e punimeve të kryera me cilësi të dobët.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:

1. Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve **z. H. M.** përfaqësues ligjor i studios Gj.&C. nuk janë marra për zbatimin e kuadrit ligjor e rregullator si më poshtë:

- Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, kreu II Kërkesa Themelore, neni 7²⁹.

²⁹ “Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë dhe është përgjegjës për zbatimin e punimeve të ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të projektimit, të zbatimit, si dhe destinacionin e objektit. Ai është i detyruar të kontrollojë librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë, vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit.”;

- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes të lidhur sipas aktit me nr. 1521 prot., datë 10.08.2020;

2. Nga ana e kolaudatorit të punimeve **z. V.B.** përfaqësues ligjor e studios NET G., nuk janë marra për zbatimin e kuadrit ligjor e rregullator si më poshtë:

- Kontratën e shërbimit të kolaudimit lidhur sipas asaj me nr. 1653/8 prot., datë 11.05.2021;
- Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, kreu II *Kërkesa Themelore*, neni 12³⁰;
- Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar e konkretisht Kreu II, Pika 3³¹.

3. Nga ana e mbikëqyrësit **z. H.M.** përfaqësues ligjor i studios Gj.&C. si dhe nga ana e kolaudatorit **z. V. B.** përfaqësues ligjor e studios N. G. nuk janë marra për zbatimin e kuadrit ligjor e rregullator si më poshtë:

- Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3³², nën pikat 3.2 dhe 3.3;
- Udhëzimi nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II Pika 8.1³³;
- **znj. D. S. dhe z. E. S.**, në cilësinë e hartuesve të specifikimeve teknike, në kundërshtim me Nenin 46 të Ligjit për Prokurimin Publik “Kualifikimi i ofertuesve”.

15. Titulli i gjetjes:	Likuidim i zërave të situacionuar por të pakryer në fakt dhe/apo të kryera jo në përputhje me specifikimet teknike.
Situata:	Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se i janë likuiduar tepër sipërmarrësit të punimeve BOE K. & L. & S. vlera prej 336,000 lekë pa TVSH si rrjedhojë e punimeve të pa kryera në fakt dhe/ose jo të kryera sipas zërit të parashikuar në preventiv. Konkretisht kjo shumë rezulton si më poshtë: - <u>Në lidhje me zërin ‘Prova në tubin’</u>, Sipas projekt-preventivit të hartuar nga ana e projektuesit rezulton se janë përfshirë në preventiv e njëkohësisht edhe në ofertën e paraqitur nga sipërmarrësi i punimeve BOE K. & L. & S. zëri për kryerjen e provës së tubit. Në fakt referuar <i>Specifikimeve Teknike</i>, Kapitulli 8³⁴, pika 8.9 <i>Përshkrimi i çmimit njësi të tubave për kanalizimet</i>.

³⁰ “Të gjitha objektet e përkufizuara në nenin 3 duhet t’i nënshtrohen kolaudimit tekniko-ekonomik, i cili ka për qëllim të verifikojë nëse:

1. objektet është realizuar në kushtet teknike;
2. objektet është realizuar në përputhje me kontratën dhe anekset e saj;
3. çmimet e aplikuar janë sipas përcaktimeve të kontratës;
4. në këtë akt verifikohen edhe kërkesat e zbatuesit të paraqitura gjatë zbatimit të punimeve

³¹ Kolaudatori ose grupi i kolaudimit duhet të verifikojë me përgjegjësi:

- a. Realizimin e objektit, në përputhje me projektin, lejen e ndërtimit, standardet dhe rregullat teknike.
- b. Realizimin e objektit, në përputhje me kontratën e nënshkruar.
- c. Përputhjen e dokumenteve me të dhënat nga matjet në dimension, formë, sasi dhe cilësi.

ç. Përputhjen e vlerës së preventivuar dhe të kontraktuar me atë të paraqitur në situacionin përfundimtar, si dhe sqarimet përkatëse, në rastet e mospërputhjes. Punimet e ndërtimit, të përkufizuara në nenin 3, duhet të projektohen dhe të zbatohen në tërësi ose në pjesë të veçanta në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit, kushtet teknike të zbatimit, si dhe me destinacionin e tyre, duke pasur parasysh edhe anën ekonomike të tyre.

³² 3.2 Libreza e masave për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit.

³³ “Situacionet pjesore hartohen në lloje, zëra, sasi, çmim e vlerë, sipas kontratës dhe ndryshimeve të urdhëruara nga investitori. Zërat, sasitë, çmimet jashtë kontratës dhe përdorimi i fondit rezervë në situacionin përfundimtar justifikohen me dokumentacionin përkatës

³⁴ Furnizimi i tubacioneve të gjitha diametrave, mbajtja, shtrirja, furnizimi i të gjitha materialeve të nevojshme, veglave, pajisjeve të kërkuara për shtrimin e tubave, fuqia punëtore, përshtatësit, bashkuesit, izoluesit, prova e tubave, sigurimi dhe instalimi i shiritave me ngjyrë, sheshimi i sipërfaqes, hekuri dhe armimi i tubave dhe të

	Gjithashtu, referuar kontratës së sipërmarrjes të lidhur mes palëve sipas aktit me nr. 1520 prot., datë 10.08.2020, neni 31 Inspektimet, pika 1³⁵. Për rrjedhojë rezultoi se është përfituar tepër nga ana e sipërmarrësit të punimeve shuma 336,000 lekë pa TVSH. • <u>Në lidhje me zërin ‘F.V derë metalike’</u>, Nga verifikimi në terren i punimeve rezultoi se dyert metalike të vendosura ishin të një cilësie shumë të dobët duke mos siguruar kështu një investim të qëndrueshëm e duke bërë që fondet e shpenzuara për këtë zë në masën prej 1,339,800 lekë pa TVSH të konsiderohen si të përdoruara pa efektivitet eficientë dhe ekonomikitet.
Kriteri:	- Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu II, neni 7³⁶; - Udhëzimi nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika 8.1³⁷; - Udhëzimi nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënparagrafi 3.2 dhe 3.3³⁸; - Kontrata e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve e lidhur sipas aktit nr. 1521 prot., datë 10.08.2020; - Kontrata e shërbimit të kolaudimit të punimeve e lidhur sipas aktit nr. 1653/8 prot., datë 11.05.2021.
Ndikimi:	Dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit në shumën 336,000 lekë pa TVSH .
Ndikimi:	Përdorim pa efektivitet, eficientë dhe ekonomikitet i fondeve në shumën prej 1,339,800 lekë pa TVSH .
Shkaku	Mungesa e ushtrimit të kontrolleve nga ana e mbikëqyrësi dhe kolaudatorit.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	Nga ana e UK Durrës sh.a. të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës 336,000 lekë pa TVSH ndaj sipërmarrësit BOE K. & L. & S. për punime të pakryera dhe/apo të kryera jo në përputhje me kërkesat e projektit por të likuiduara në kontratën e sipërmarrjes të lidhur sipas aktit me nr. 1520 prot., datë 10.08.2020 me objekt ‘Përmirësimi i furnizimit me ujë Lagia Nr. 1, Vadardhë, Njësia Administrative Sukth Bashkia Durrës’.

gjitha aktivitetet siç përshkruhen më sipër janë përfshirë në çmimin njësi për një metër tubacion kanalizimesh”.

³⁵ “Kontraktori duhet të bëjë të gjitha testet dhe inspektimet e kërkuara nga dispozitat e kontratës. Kosto e këtyre testeve dhe inspektimeve duhet të financohet tërësisht nga Kontraktori brenda çmimit të kontratës”.

³⁶ “Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë dhe është përgjegjës për zbatimin e punimeve të ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të projektimit, të zbatimit, si dhe destinacionin e objektit. Ai është i detyruar të kontrollojë librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë, vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit”;

³⁷ “Situationet pjesore hartohen në lloje, zëra, sasi, çmim e vlerë, sipas kontratës dhe ndryshimeve të urdhëruara nga investitori. Zërat, sasi, çmimet jashtë kontratës dhe përdorimi i fondit rezervë në situacionin përfundimtar justifikohen me dokumentacionin përkatës”;

³⁸ “3.2 Librezja e masave për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit. 3.3 Situationet mujore pjesore, progresive dhe përfundimtare hartohen mbi bazën e vëllimeve të llogaritura në librezën e masave dhe çmimeve faktike, mbështetur në analizat teknike të çmimeve, që përfshihen në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit, të miratuara çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave. Ato firmosen nga drejtuesi teknik i objektit, mbikëqyrësi i punimeve dhe përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit për të cilin është miratuar leja e ndërtimit. Në rastet kur në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit mungojnë analizat teknike të çmimeve të zërave të punimeve të kryera në objekt, veprohet në përputhje me procedurën e përcaktuar në pikën 8 të vendimit nr. 514, datë 15.8.2007 të Këshillit të Ministrave “Për informatizimin e llogaritjes së koston dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”;

Rekomandimi:	Nga ana e UK Durrës sh.a. të merren masa për ngritjen e grupeve efektive në drejtim ndjekjes së kontratës, me qëllim eliminimin e kryerjes së punimeve jo cilësore dhe/apo në kundërshtim me specifikimet teknike të kërkuara si dhe shmangien e përdorimit pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet siç është ai si më sipër për zërin <u>'F.V derë metalike'</u> në shumën prej 1,339,800 lekë pa TVSH .
---------------------	---

Lidhur me sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi mbikëqyrësi i punimeve z. H. M. si dhe kolaudatori i punimeve z. V. B..

Nga ana e shoqërisë K. SH.P.K është dërguar observacioni i administruar në KLSH me nr. 825/9 prot., datë 02.03.2023 i cili gjen trajtim si më poshtë.

Pretendimi i subjektit:

Me datë 27.02.2023 pranë zyrave të selisë së shoqërisë sonë, nëpërmjet shërbimit postar kemi marrë shkresën me nr. 184/10 prot., datë 22.02.2023, të dërguar nga ana e investitorit Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Durrës lidhur me pretendimet dhe detyrat e përcaktuara në Raportin³⁹ e Auditimit nr. 825/8 prot., datë 14.02.2023 të hartuar nga ana e Kontrollit të Lartë të Shtetit për zbatimin e punimeve në ndërtimin e objekteve:

Përmirësimi i furnizimit me ujë Lagia Nr. 1, Vadardhë, Njësia Administrative Sukth Bashkia Durrës.

Ndërtimi i Ujësjetllës të Fshatrave Lalëz, Bizë, Draç dhe Shetë Njësia Administrative Ishëm - Bashkia Durrës.

Për sa më sipër ju bëjmë me dije se në shoqërinë tonë nuk ka ardhur asnjë lajmërim zyrtar në lidhje me auditimin dhe konstatimet e kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit të realizuar gjatë kësaj periudhe pranë shoqërisë në lidhje me objektet e sipërcituara.

Në lidhje me gjetjet nga auditimi për objektin Ndërtimi i Ujësjetllës të Fshatrave Lalëz, Bizë, Draç dhe Shetë Njësia Administrative Ishëm - Bashkia Durrës ku pretendohet që sipërmarrësi i punimeve nuk ka dokumentuar në asnjë rast kryerjen e punimeve për transportin e materialit të gërmuar, mbushjes me rërë si dhe mbushjes me zhavorr për linjën e dërgimit si dhe linjave të shpërndarjes. Lidhur me këtë pretendim, ju bëjmë me dije se ne jemi përpjekur të paraqesim foto të punimeve ku reflektohen mbushjet me rërë dhe me zhavorr. Megjithatë po ju vëmë në dispozicion foto të këtyre punimeve të marra nga dosjet e objektit nga arkivat tona".

Qëndrimi i Audituesve shtetërorë të KLSH

Në përfundim të shqyrtimit të plotë të observacioneve si më sipër Grupi i Auditimit, pasi analizoi dhe vlerësoi me objektivitet, profesionalizëm dhe pavarësi arriti në konkluzionin se materialet e dorëzuara nuk sjellin fakte shtesë nga ato të konstatuara gjatë fazës së auditimit në terren. Për sa më sipër pretendimet Tuaja nuk qëndrojnë dhe si të tilla ato nuk merren në konsideratë nga Grupi i Auditimit.

Nga ana e shoqërisë aksionare UK Durrës është dërguar observacioni i administruar në KLSH me nr. 825/11 prot., datë 15.03.2023 i cili gjen trajtim si më poshtë.

Pretendimi i subjektit:

Observacioni konsiston në një procesverbal të mbajtur në datë 07.03.2023 mes përfaqësuesit të firmës sipërmarrëse K. z. A.D., përfaqësuesi të AK z. B. M. si dhe mbikëqyrësit të punimeve z.

³⁹ Në fakt observuesi i referohet Raportit Përfundimtar të nisur në UK Durrës sh.a. SH.A.

Xh. M. sipas të cilit është kryer një përzgjedhje rastësore për kryerjen e një sondazhi në piketën L-D 4000 nga ku ka rezultuar se:

Bankina ishte e sistemuar me stabilizant dhe në kuotë me asfaltin e rrugës;

Kanali ishte i mbushur me material të zgjedhur, i përzier me zhavorr;

Tubi ishte i mbuluar me rërë guri;

Qëndrimi i Audituesve shtetërorë të KLSH

Në përfundim të shqyrtimit të plotë të observacioneve si më sipër Grupi i Auditimit, pasi analizoi dhe vlerësoi me objektivitet, profesionalizëm dhe pavarësi arriti në konkluzionin se materialet e dorëzuara nuk sjellin fakte shtesë nga ato të konstatuara gjatë fazës së auditimit në terren. Sqarojmë se një sondazh i vetëm nuk mund të jetë përfaqësues për gjithë volumin e punës të realizuar për shtrimin e tubave. Për sa më sipër pretendimet Tuaja nuk qëndrojnë dhe si të tilla ato nuk merren në konsideratë nga Grupi i Auditimit.

Sa më sipër është mbajtur *Akt konstatimi nr.10* , datë 13.01.2023

- **Zhvillimi i Procedurës** "Sistemi i matjes, kontrollit, komandimit në distancë dhe sistemi klorifikimit automatik".

Përshkrimi i procedurës

Ky projekt është për instalimin e matësve kryesorë në Stacionet e Fushë Kuqe, Fushë Krujë dhe njëjën Xhafzotaj, si dhe instalimin e klorifikatorëve automatik.

Fondi Limit

Fondi limit në vlerën: **72,059,000 leke (pa TVSH).**

Përmbledhja e procedurës në tabelë

Procedura e Prokurimit "Sistemi i matjes, kontrollit, komandimit në distancë dhe sistemi i klorifikimit automatik"		
Urdhër Prokurimi nr.366/4 prot, date 07.03.2019		
1.Lloji i Procedurës së Prokurimit Procedurë e hapur pune	2. Njesia e prokurimit Znj. A. B. z. B. M. znj. D. B.	3. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave Sipas Urdhrit nr. 3491/6, date 04.12.2020 z. L. F. (Kryetar) z. O. K. (Anëtar) znj. M.B. (Anëtar)
4. Komisioni i Hartimit të Specifikimeve Teknike Z. G. D. z. E. S.		
5. Fondi Limit (pa tvsh) 72,059,000 lekë	6. Oferta Fituese (pa tvsh) 69,921,411 lekë	7. Diferenca me fondin Limit (pa tvsh) 2,137,589 lekë
8. Data e hapjes së ofertave 29.04.2020	9. Burimi i Financimit Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomikë 1. "S." shpk & "I. E." & "A. T." shpk – 69,921,411 lekë pa TVSH

11. Ankimime S. Kërkesë për sqarim nr. 563 datë 19.03.2019. M. 2. ankesë me nr. 621 Prot. datë 27.03.2019.	12. Pergjigje e ankesës nga AK Kthim pergjigje me nr. 687 Prot. datë 19.03.2019 Kthim pergjigje me nr. 563/1 Prot. datë 19.03.2019	13. Grupi i ndjekjes së Kontratës
b.Zbatimi i Kontratës se Punimeve/Shërbimeve/Mallrave		
14. Lidhje e kontratës Nr.1111 Prot. 03.06.2019	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 83,905,693 leke me TVSH	16. Afati i kontratës ne dite. Afati i realizimit 224 ditë

Sipas Urdhrit nr. 366/1 Prot. datë 14.02.2019, z. G. D., dhe z. E. S.i urdhërohen të hartojnë në mënyrë të detajuar specifikimet teknike si dhe kërkesat për kualifikimin e operatorëve ekonomik. Gjatë auditimit të specifikimeve teknike, grupi i auditimit vëren kriteret teknike të cilat duken të ekzagjëruara përsa i përket objektit të kontratës, si më poshtë:

- Licencat e mëposhtme:

NP 1-A Punime gjurmimi në tokë, kriter i cili nuk është në proporcion me objektin e kontratës pasi nuk ka të bëjë me gjurmime tokësore pasi në preventiv e punës nuk përfshihen gjurmimet, sistemet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gjurmohet ose sistemohet, vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.

- Të kenë në stafin e tyre një inxhinier ndërtimi i cili gjithashtu nuk është në proporcion me objektin e kontratës, pasi do ishte e mjaftueshme përfshirja e një inxhinieri informatike ose elektronike për zhvillimin e procedurës.
- Të kenë në stafin e tyre një murator, bojaxhi, ku për shkak të volumit të vogël të punës që ka në lidhje me ndërtimin është i panevojshëm përfshirja e tyre si kriter për të qenë pjesëmarrës në garë.
- Kamion me vinç (me kapacitet mbajtës mbi 5 ton), ku sipas specifikimeve teknike kemi të bëjmë me vendosjen e depozitave të klorit gjë që e bën të panevojshme pasjen si kriter të veçantë të kamionit me vinç vetëm për arsyen e mësipërme.

Për kolaudimin e procedurës së mësipërme është kryer një tjetër procedurë prokurimi ku fitues është shpallur O.E. M.K. e licencuar për mbikëqyrje dhe kolaudim punimesh zbatimi me Licencë Nr. MK. 1200/4 për vlerën prej 92,854 lekë pa TVSH.

Grupi i ndjekjes së Kontratës janë:

z. L. F.

z. A. K.

z. S. C.

Pas verifikimeve të kryera nga grupi i auditimit mbi funksionimin e sistemit e objektit të kontratës u vu re që kishte anomali në mënyrën e funksionimit të saj, që lidhet me shërbimin e internetit. Duke qenë se lidhja e internetit zhvillohet me anë të procedurës e cila zgjat 12 muaj, diapazoni kohor midis zhvillimit të procedurës dhe lidhjes së kontratës së re për vitin pasardhës, krijon mosfunksionim të sistemit duke mos marrë të dhënat në kohë reale si dhe bëhet pengesë në rastin e krijimit të statistikave dhe në nxjerrjen në pah të dukurive të tjera.

16. Titulli i gjetjes:	Vendosja e kriterëve dhe specifikimeve teknike diskriminuese për pjesëmarrjen e O.E. në garë.
-------------------------------	---

Situata:	Gjatë zhvillimi të Procedurës së Prokurimit me objekt “<i>Sistemimi i furnizimit me ujë të zonës Turistike Hamallaj, Faza II, Nj. Adm. Sukth, Bashkia Durrës</i>” gjatë hartimit të specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta, janë vendosur kriterë të cilat nën gjykimin e audituesve janë të ekzagjeruara dhe jo në proporcion me objektin e kontratës si më poshtë: Vendosja e licencës të mëposhtme: <i>NP.- 1 Punime gërmimi në tokë</i> ku bazuar në VKM nr. 943 datë 28.12.2016⁴⁰ nuk janë në proporcion me objektin e kontratës si dhe me zërat dhe punimet e detajuara në preventivin e punimeve. Vendosja e kriterëve si më poshtë: - <i>Të kenë në stafin e tyre një inxhinier ndërtimi i cili gjithashtu nuk është në proporcion me objektin e kontratës, pasi do ishte e mjaftueshme përfshirja e një inxhinieri informatike ose elektronike për zhvillimin e procedurës.</i> - <i>Të kenë në stafin e tyre një murator, bojaxhi, ku për shkak të volumit të vogël të punës që ka në lidhje me ndërtimin është i panevojshëm përfshirja e tyre si kriter për të qenë pjesëmarrës në garë.</i> - <i>Kamion me vinç (me kapacitet mbajtës mbi 5 ton), ku sipas specifikimeve teknike kemi të bëjmë me vendosjen e depozitave të klorit gjë që e bën të panevojshme pasjen si kriter të veçantë të kamionit me vinç vetëm për arsyen e mësipërme.</i>
Kriteri:	Neni 23 “ <i>Specifikimet Teknike</i> ”, Ligji nr.9643 datë 20.11.2006 “ <i>Për Prokurimin Publik</i> ”, i ndryshuar.
Ndikimi/Efekti:	Pengon konkurrencën e drejtë
Shkaku:	Hartimi i specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta diskriminuese.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	UK Durrës sh.a., në zhvillimin e procedurave të prokurimit, veçanërisht në hartimin e kriterëve të veçanta, të ketë parasysh që të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, përmbajtjen e tij duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve.

Përsa është trajtuar në këtë pjesë të P/Raportit të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacion me shkresë nr.825/12 prot, datë 15.03.2023 “Observacion mbi Akt Konstatimin Nr.11 datë 13.01.2023 në lidhje me procedurën e prokurimit “*Sistemi i matjes, kontrollit, komandimit në distancë dhe sistemi klorifikimit automatik*” nga z. S. K., ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

Janë kërkuar kategoritë përkatëse të licencave pasi:

Kategoria NP-1 Punime gërmimi në tokë

Në preventivin e punimeve janë të përfshira dhe punimet për instalimin e matësve, për të cilat

⁴⁰ Për Disa Ndryshime Dhe Shtesa Në Vendimin Nr.759, Datë 12.11.2014, Të Këshillit Të Ministrave, "Për Licencimin Profesional Të Individëve Dhe Personave Juridikë Që Do Të Ushtrijnë Veprimtari Në Fushën E Studimit E Të Projektimit Në Ndërtim Dhe Mbikëqyrjes E Kolaudimit Të Punimeve Të Zbatimit Në Ndërtim"

nevojiten të kryhen punime sipas kësaj kategorie.

Inxhinier ndërtimi: Kërkohet pasi objekti përfshin punimet ndërtimi si psh. prishje në muraturën e Depove, të cilat nevojiten të monitorohen në zbatim nga ana e inxhinierit të fushës.

Kamion me vinç: (me kapacitet mbajtës mbi 5 ton): objekti përfshin instalimin e matësve të dimensioneve të mëdha, për të cilat është e pamundur që instalimi i tyre të bëhet pa pajisjen vinç.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit të KLSH –së:

Në lidhje me observacionin e bërë nga ana e z. S. K., grupi i auditimit pas analizimit të observacionit mban të njëjtin qëndrim mbi gjetjen duke cituar dhe njëherë që në preventivin e punimeve nuk përfshihen zëra punimesh të cilat arsyetojnë pajisjen e O.E. me licencën e mësipërme. Gjithashtu edhe për sa i përket inxhinierit të ndërtimit nuk është në proporcion me objektin e kontratës.

Për këto arsye, sa më sipër, observacioni juaj nuk pranohet.

Për sa më sipër, ngarkohen me përgjegjësi z. G. D. dhe z. E. S., në cilësinë e hartuesve të specifikimeve teknike, në kundërshtim me Nenin 46 të Ligjit për Prokurimin Publik “Kualifikimi i ofertuesve”.

• **Zhvillimi i Procedurës "Ndërtimi i ujësjellësit të fshatrave Lalëz, Bizë, Draç dhe Shetë, Njësia Administrative Ishëm-Bashkia Durrës".**

Përshkrimi i procedurës

Sipas Vendimit Nr.5 datë 27.03.2019 të Këshillit Teknik pranë AKUM, është miratuar projekt-preventivi me objekt: “Ndërtim i ujësjellësit të fshatrave Lalëz, Bizë, Draç dhe Shetaj, Njësia Administrative Ishëm, Bashkia Durrës”, me vlerë 180,414,265 lekë me TVSH.

Fondi Limit

Fondi limit në vlerën: **180,414,265 leke (pa TVSH)**

Përmbledhja e procedurës në tabelë

Procedura e Prokurimit: "Ndërtimi i ujësjellësit të fshatrave Lalëz, Bizë, Draç dhe Shetë, Njësia Administrative Ishëm-Bashkia Durrës".		
Urdhër Prokurimi nr.1298/4 prot, date 24.05.2019	3. Njësia e prokurimit znj. A. B. z. B. M. znj. D. B.	4. Komisioni i Vleresimit të Ofertave sipas Urdhrit nr. 1298/6, date 27.03.2020 z.D. Gj. (Kryetar) znj.M. H. (Anëtar) znj.Q. Q.(Anëtar)
1. Lloji i Procedurës së Prokurimit Procedurë e hapur pune	4. Komisioni i Hartimit të Specifikimeve Teknike z. L. F.	
5. Fondi Limit (pa tvsh) 180,414,265 leke	6. Oferta Fituese (pa tvsh) 143,726,215 leke	7. Diferenca me fondin Limit (pa tvsh) 36,688,050 leke

8. Data e hapjes se ofertave 26.06.2019	9. Burimi i Financimit Fondet e UK DURRËS sh.a.	10. Operatorët Ekonomikë 1. 4. shpk – 123,278,760 lekë pa TVSH 2. “K.” shpk & “N.” shpk – 143,726,215 lekë pa TVSH. 3. “B.” shpk – 148, 573,083 lekë pa TVSH. 4. “E.d” shpk – Pa ofertë ekonomike
11. Ankimime -	12. Pergjigje e ankesës nga AK	13. Pergjigje ankesës nga KPP -
b.Zbatimi i Kontratës se Punimeve/Shërbimeve/Mallrave		
14. Lidhje e kontratës Nr.1922 Prot. date 13.09.2019	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 172,471,458.40 leke me TVSH	16. Afati i kontratës ne dite. Parashikuar 21 javë

Me shkresën Nr.1298/1 datë 22.05.2019 është urdhëruar Z. L. F. dhe Z. G. D. të hartojnë në mënyrë të detajuar specifikimet teknike , si dhe kërkesat për kualifikimin e operatorëve ekonomikë. Pas shqyrtimit të shkresës Nr.1298/2 datë 22.05.2019 ku janë hartuar specifikimet teknike si dhe kërkesën për kualifikimin e operatorëve ekonomike, grupi i auditimit konstaton:

Ne pikën 6 të Specifikimeve Teknike që ka të bëjë me mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës:

- Kamiona vetshkarkues kapacitet mbajtës (mbi 20 ton) – Copë 3
- Kamiona vetshkarkues kapacitet mbajtës (mbi 13 ton) – Copë 2
- Kamiona vetshkarkues kapacitet mbajtës (mbi 8 ton) – Copë 2 janë të ekzagjëruara për objektin e kontratës.

Kërkesat për drejtues teknik si në rastin e:

-1 (një) inxhinier hidroteknik

-1 (një) inxhinier ndërtimi të cilët në proporcion me objektin e kontratës ku minimalisht duhet të ishin kërkuar nga dy inxhinier për klasifikim.

17. Titulli i gjetjes:	Vendosja e kriterëve dhe specifikimeve teknike diskriminuese për pjesëmarrjen e O.E. në garë.
Situata:	Gjatë zhvillimi të Procedurës së Prokurimit me objekt “Ndërtimi i ujësjellësit të fshatrave Lalëz, Bizë, Draç dhe Shetë, Njesia Administrative Ishëm-Bashkia Durrës” gjatë hartimit të specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta, janë vendosur kriterë të cilat nën gjykimin e audituesve janë të ekzagjëruara dhe jo në proporcion me objektin e kontratës si më poshtë: Mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës: - Kamiona vetshkarkues kapacitet mbajtës (mbi 20 ton) – Copë 3 - Kamiona vetshkarkues kapacitet mbajtës (mbi 13 ton) – Copë 2 - Kamiona vetshkarkues kapacitet mbajtës (mbi 8 ton) – Copë 2 Të cilat duke u bazuar në preventivin e punimeve dhe grafikun e punimeve, nuk ka një llogaritje të ndarjes së tyre sipas tonazhit ku në gjykimin e audituesve ndarja e tyre si më sipër sipas tonazhit përbën arsye

	mbi skualifikimin e O.E. të tjerë pjesëmarrës ose orientimin drejtë një O.E. fitues të paracaktuar që të përmbushë kriteret e mësipërme. Kërkesa për drejtues teknik si në rastin e: -1 (një) inxhinier hidroteknik -1 (një) inxhinier ndërtimi e cila është e ulët në proporcion me objektin e kontratës dhe volumin e punëve në grafikun dhe preventivin e punimeve, ku minimalisht duhet të ishin kërkuar nga dy inxhinier për klasifikim.
Kriteri:	Neni 23 “ <i>Specifikimet Teknike</i> ”, Ligji nr.9643 datë 20.11.2006 “ <i>Për Prokurimin Publik</i> ”, i ndryshuar.
Ndikimi/Efekti:	Pengon konkurrencën e drejtë
Shkaku:	Hartimi i specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta diskriminuese.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	UK Durrës sh.a., në zhvillimin e procedurave të prokurimit, veçanërisht në hartimin e kriterëve të veçanta, të ketë parasysh që të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, përmbajtjen e tij duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve.

Përsa është trajtuar në këtë pjesë të P/Raportit të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacion me shkresë nr.825/12 prot, datë 15.03.2023 “Observacion mbi Akt Konstatimin Nr.13 datë 13.01.2023 në lidhje me procedurën e prokurimit “*Ndërtimi i ujësjellësit të fshatrave Lalëz, Bizë, Draç dhe Shetë, Njesia Administrative Ishëm-Bashkia Durrës*” nga z. S. K. ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

Janë kërkuar makineritë me ato kapacitet dhe ato drejtues Teknik, pasi:

Kamiona vetshkarkues, 7 copë sipas kapaciteteve mbajtës përkatëse, pasi: referuar volumit të lartë të punimeve, distancat e largëta të depozitimeve, shkallës së lartë të amortizimit të rrjetit ekzistues duke kërkuar që punimet të realizoheshin në një afat kohor të shkurtër të pasqyruar në grafikun e punimeve, nevojiten këto makineri me qëllim që të përballohet intensiteti i punimeve që përfshin projekti.

Drejtues Teknik, inxhinier hidroteknik dhe ndërtimi, pasi duke qenë se bëhet fjalë për drejtues Teknik, është menduar që një kompani ndërtimi ka në përgjithësi nga një inxhinier për kategoritë përkatëse, të pasqyruara dhe në licencë. Ndërkohë që është kërkuar staf mbështetës inxhinierik për të përballuar punimet në objekt.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit të KLSH –së:

Në lidhje me observacionin e bërë nga ana e z. S. K., grupi i auditimit pas analizimit të observacionit mban të njëjtin qëndrim mbi gjetjen duke cituar dhe njëherë që ndarja e kamionëve të mënyrë të specifikuar sipas tonazhit dhe me numër të caktuar të kamionëve pa dhënë shpjegimet përkatëse si dhe ndërlidhjen e tyre me preventivin dhe grafikun e punimeve duke ngritur dyshimet mbi paracaktimin e O.E. fitues.

Gjithashtu duke u nisur nga vlera e kontratës dhe e preventivit të punimeve në gjykimin tonë caktimi i një inxhinieri hidroteknik dhe një inxhinieri ndërtimi është e ulët.

Për këto arsye, sa më sipër, observacioni juaj nuk pranohet.

Për sa më sipër, ngarkohen me përgjegjësi z. G. D. dhe z. L. F., në cilësinë e hartuesve të specifikimeve teknike, në kundërshtim me Nenin 46 të Ligjit për Prokurimin Publik “Kualifikimi i ofertuesve”.

Në lidhje me Projektin

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se projekti është hartuar nga ana e studios INVICTUS ligjor A. K. Projekti i zbatimit ka parashikuar një vlerë punimesh prej 180,401,929 lekë me TVSH.

Objekti i kësaj Vepre Teknike është hartimi i rrjetit të furnizimit me ujë të fshatrave, Lalëz, Bizë, Draç dhe Shetaj, nga depoja ekzistuese e ujësjellësit në Lalëz dhe Draç. Ndërhyrja në këto zona bëhet për të:

- *Furnizuar me ujë zonat e banuara;*
 - *Përmirësuar e orarit të furnizimit me ujë;*
 - *Përmirësimin e sasisë së ujit për frymë;*
 - *Përmirësimin e cilësisë së ujit;*
 - *Eliminimi i humbjeve dhe ndotjeve të ujit në rrjet;*
 - *Prerjen e lidhjeve të paligjshme dhe lidhjen e kontratave të rreja konform modelit të ERRU-së*
- Në lidhje me projektin, sipas shkresës së administruar në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit me nr. 263/3 prot., datë 04.10.2018 është dërguar në UK Durrës sh.a. Oponenca Teknike sipas të cilës është konfirmuar përputhshmëria e projektit me kërkesat e UK Durrës sh.a.

Sipas dokumentacionit të mësipërm dhe atij të zbatimit rezulton se nga ana e AK nuk janë marrë masat e nevojshme për ndryshimin e projektit sipas propozimeve të bëra në opionencën teknike, konkretisht për sa i takon hidrantëve të zjarrit të cilat janë rekomanduar t'i bashkëngjiten rrjetit shpërndarës sipas udhëzimeve të KTP në fuqi.

Historiku i zbatimit të punimeve

Në përfundim të procedurës së prokurimit, është shpallur fitues BOE K. & N., të përfaqësuar këta nga OE K. me nr. licence për zbatim punimesh NZ. 4901/10 datë 06.06.2019 dhe me përfaqësues ligjor z. S. K. me të cilin është lidhur kontrata me Autoritetin Kontraktor të përfaqësuar nga z. K. B. me nr. 1922 prot., datë 13.09.2019 me vlerë 172,471,458.4 lekë me TVSH dhe me afat të zbatimit të punimeve 21 javë nga dita e nesërme e punës pas nënshkrimit të kontratës.

Për mbikëqyrjen e punimeve është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me OE Gj&Co me nr. licence për mbikëqyrje dhe kolaudim punimesh MK.1735/18 datë 04.12.2019, me përfaqësues ligjor z. H. M. sipas aktit me nr. 1925 prot., datë 13.09.2019 me vlerë të kontratës 2,629,815 lekë me TVSH.

Për kolaudimin e punimeve është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi sipas shkresës me nr. 720 prot., datë 10.04.2020 me OE N. G. e përfaqësuar nga z. V. B. me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim MK.3101/7, datë 23.04.2019 me vlerë të kontratës 394,472 lekë me TVSH.

Sipas shkresës nr. 1298/9 prot., datë 24.05.2019 është ngritur Grupi i Punës për ndjekjen e kontratës i përbërë nga z. G. D., z. L. F. dhe z. N. S.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në datën 16.09.2019 nga ana e mbikëqyrësit të punimeve është bërë kërkesë për lirim të plotë të sheshit të ndërtimit. Në vijim pas korrespondencave rezulton se nga ana e AK është lejuar fillimi i punimeve në datë 02.12.2019 edhe pse në momentin e fillimit të tyre objekti nuk ka disponuar leje ndërtimi dhe nuk është kthyer përgjigje nga ana e Bashkisë Durrës. Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve është protokolluar shkresa nr. 2515/2 prot., datë 02.12.2019 sipas të cilës është njoftuar AK mbi fillimin e punimeve.

Ky njoftim është bërë edhe nga ana e sipërmarrësit sipas shkresës së administruar në AK me nr. 320/1 prot., datë 02.12.2019. Me shkresën e datës 02.12.2019 është mbajtur procesverballi i fillimit të punimeve mes AK e përfaqësuar nga z. K. B., mbikëqyrësit dhe sipërmarrësit si dhe me Grupin e Ndjekjes së Kontratës. Sipas shkresës me nr. 620 prot., datë 19.03.2020 është bërë kërkesë nga ana e sipërmarrësit të punimeve për miratimin e ndryshimeve të volumeve e shoqëruar me relacionin e mbikëqyrësit të punimeve. Kjo kërkesë është miratuar përmes procesverballit përkatës me nr. 620/1 prot., datë 19.03.2020 të mbajtur mes Titullarit të AK, Grupit të Punës për ndjekjen e kontratës, mbikëqyrësit dhe sipërmarrësit. Gjithashtu, tabela e ndryshimit të volumeve dhe preventivi i ripunuar janë miratuar nga palët si më sipër. Në total vlera e preventivit të ndryshuar nuk ka ndryshuar nga vlera e atij të kontratës duke përdorur kështu fondin rezervë për efekt të ndryshimeve në volume. Sipas procesverballit të datës 06.04.2020 është bërë prova me ngarkesë e rrjetit sipas të cilit është cituar se projekti është zbatuar sipas kërkesave të AK. Punimet kanë përfunduar me datë 02.04.2020 (sipas njoftimit të mbikëqyrësit dhe sipërmarrësit me nr. 669 prot., datë 02.04.2020), pra brenda afati prej 21 javësh të parashikuar në kontratën e sipërmarrjes. Punimet janë kolauduar sipas aktit përkatës të administruar në UK Durrës sh.a. me nr. 1196 prot., datë 21.04.2020 dhe sipas shkresës së administruar në AK me nr. 1196/1 prot., datë 21.04.2020 është marrja e përkohshme në dorëzim e punimeve dhe marrja përfundimtare në dorëzim është bërë sipas shkresës me nr. 3092/1 prot., datë 04.07.2022.

Sipas dokumentacionit të mësipërm dhe atij të zbatimit rezulton se nga ana e AK nuk janë marrë masat e nevojshme për ndryshimin e projektit sipas propozimeve të bëra në opionencën teknike, konkretisht për sa i takon hidrantëve të zjarrit të cilat janë rekomanduar ti bashkëngjiten rrjetit shpërndarës sipas udhëzimeve të KTP në fuqi.

18. Titulli i gjetjes:	Likuidim i zërave të situacionuar por të pakryer në fakt si dhe mungesë e konfirmimit të punimeve të maskuara.
Situata:	Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se i janë likuiduar tepër sipërmarrësit të punimeve BOE K. & N. vlera prej 49,755 lekë pa TVSH si rrjedhojë e punimeve të pa kryera në fakt dhe/ose jo të kryera sipas zërit të parashikuar në preventiv. Konkretisht kjo shumë rezulton si më poshtë: - <u>Në lidhje me kategorinë Linja e shpërndarjes Lalëz dhe Bizë</u> Sipas situacionit përfundimtar rezulton se në total janë gërmuar 3215.88 m³ tokë kategoria III dhe 1411.8 m³ tokë e fortë, ose 4,627.68 m³ në total. Për sa i takon volumeve të punimeve që lidhen me mbushjen e kanaleve rezulton se janë situacionuar: Mbushje me material të zgjedhur të gërmuar – 1168.55 m³; Mbushje me zhavorr – 2407.02 m³; Shtresë stabilizant 20 cm + shtresë çaklli mbeturinë kave 10 cm – 480 m³; Pra në total rezulton një volum prej 4055.57 m³. Duke bërë krahasimet rezulton se ka një mospërputhje të dukshme në volum prej 803.69 m³. Nisur nga ky fakt Grupi i Auditimit analizoi segmentin L-B D.1 750-4275⁴¹ për të cilin është gërmuar gjatësia prej 3530 ml, nga të cilat 2400 ml x 0.25 ml x 1.2 ml (<i>l x b x h</i>) për tokë kat. III dhe 1130 ml x 0.25 ml x 1 ml (<i>l x b x h</i>) për tokë të fortë. Nga verifikimi i librezës së masave për po të njëjtin segment (L-B

⁴¹ Segmenti u përzgjedh në bazë të distancës më të lartë por i njëjti fenomen u konstatua edhe në segmente të tjera.

D.1 750-4275) rezulton se janë pasqyruar në librezën e masave volumet si më poshtë:

SEGMENTI 2400 ML X 0.25 ML X 1.2 ML

Zëri	Lartësia e shtresës (ml)
Shtresë çakulli mbeturine	0.1
Shtresë stabilizanti	0.2
Mbushje me rërë	0.35
Mbushje me zhavorr	0.6
Mbushje ngjeshje me material të gërmuar	0.1
TOTAL	1.35

SEGMENTI 1130 ML X 0.25 ML X 1. ML

Zëri	Lartësia e shtresës (ml)
Shtresë çakulli mbeturine	0.1
Shtresë stabilizanti	0.2
Mbushje me rërë	0.35
Mbushje me zhavorr	0.6
Mbushje ngjeshje me material të gërmuar	0.1
TOTAL	1.35

Për rrjedhojë rezulton se lartësia e kanaleve duke mbledhur lartësitë e materialeve të përdorura për mbushje janë 15 cm deri në 35 cm më të larta se sa lartësia për të cilat këto kanale janë gërmuar. Nga sa më sipër rezulton se librezat e masave është një dokument që nuk mbështet mbi fakte dhe si e tillë nuk përbën bazën reale të përllogaritjes së volumeve të pasqyruara në librezën e masave.

Sipas dokumentacionit fotografik të ndodhur në dosjen teknike të zbatimit nuk dokumentohen në asnjë rast të vetëm kryerja e punimeve për transportin e materialit të gërmuar, mbushjes me rërë si dhe mbushjes me zhavorr për linjën e dërgimit si dhe linjave të shpërndarjes (shuma prej 8,464,526 lekë pa TVSH për linjën e dërgimit, shuma prej 6,378,512 lekë pa TVSH për linjën e shpërndarjes Lalëz dhe Bizë, shuma prej 4,533,929 lekë pa TVSH për linjën e shpërndarjes në Drac si dhe shuma prej 4,133,966 për linjën e shpërndarjes në Shete). Në total rezulton se vetëm për këta dy zëra nuk dokumentohen punime të kryera në vlerën totale prej 23,510,933 lekë pa TVSH.

- Në lidhje me zërin 'Mbushje me material të zgjedhur të gërmuar',

Sipas situacionit përfundimtar për këtë zë rezulton se është likuiduar volumi prej 1168 m³. Libreza e masave pasqyron në mënyrë analitike të njëjtin volum punimesh. Në fakt nga analiza e kësaj të fundit konstatohet se gjerësia me të cilin është gërmuar kanali në segmentin L-B D.1 750-4275 është 0.25 ml kurse gjerësia e mbushjes me këtë material është marrë 0.6 ml. Duke bërë korrigjimet rezulton se është përfutur tepër nga ana e sipërmarrësit të punimeve volumi prej 123.55 m³ ose shuma prej **12,355 lekë pa TVSH**.

- Në lidhje me zërin 'F.V. Tub PE100 Ø 63mm PN 10atm',

Sipas situacionit përfundimtar për këtë zë rezulton se është likuiduar volumi prej 597 ml. Ky volum sipas librezës së masave ka rezultuar nga linja në L-B D.1 5087 - 4790 (368 ml), L-B D.4 0 - 165 (113 ml) dhe L-B D.9 0 - 125 (116

	ml). Në fakt referuar kronologjisë së punimeve dhe volumeve të pasqyruara për volumet e gërmimit në tokë kat. III dhe tokë e fortë rezulton se po në këto akse janë gërmuar përkatësisht gjatësitë 300 ml, 113 ml dhe 116 ml, ose 529 ml në total, pra 68 ml më pak. Duke bërë korrigjimet rezulton se është përfituar tepër nga ana e sipërmarrësit të punimeve shuma prej 37,400 lekë pa TVSH. Si përfundim, rezulton se janë përfituar tepër nga ana e sipërmarrësit të punimeve vlere prej 49,755 lekë pa TVSH si rrjedhojë e punimeve të pakryera në fakt, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e shoqërisë UK Durrës sh.a. dhe si e tillë duhet të zhdëmtohet nga ana e BOE “K. & N.” në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve si dhe njëkohësisht nuk dokumentohet kryerja e punimeve me tre zëra në vlerën 23,510,933 lekë pa TVSH.
Kriteri:	- Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu II, neni 7⁴²; - Udhëzimi nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika 8.1⁴³; - Udhëzimi nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nën pikat 3.2 dhe 3.3⁴⁴; - Kontrata e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve e lidhur sipas aktit nr. 1925 prot., datë 13.09.2019; - Kontrata e shërbimit të kolaudimit të punimeve e lidhur sipas aktit nr. 720 prot., datë 10.04.2020; - Urdhri i Titullari të AK me nr. 1298/9 prot., datë 24.05.2019 për ndjekjen e kontratës.
Ndikimi:	Dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit në shumën 49,755 lekë pa TVSH .
Ndikimi:	Mungesë e konfirmimit të zërave të punimeve në shumën 23,510,933 lekë pa TVSH.
Shkaku	Mungesa e ushtrimit të kontrolleve nga ana e mbikëqyrësit, kolaudatorit dhe grupit të ndjekjes së kontratës.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	Nga ana e UK Durrës sh.a. të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës 49,755 lekë pa TVSH ndaj sipërmarrësit BOE K. & N. për punime të pakryera dhe/apo të kryera jo në përputhje me kërkesat e projektit por të likuiduara në kontratën e sipërmarrjes të lidhur sipas aktit me nr. 1922

⁴² “Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë dhe është përgjegjës për zbatimin e punimeve të ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të projektimit, të zbatimit, si dhe destinacionin e objektit. Ai është i detyruar të kontrollojë librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë, vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit.”;

⁴³ “Situacionet pjesore hartohen në lloje, zëra, sasi, çmim e vlerë, sipas kontratës dhe ndryshimeve të urdhëruara nga investitori. Zërat, satitë, çmimet jashtë kontratës dhe përdorimi i fondit rezervë në situacionin përfundimtar justifikohen me dokumentacionin përkatës”;

⁴⁴ “3.2 Libreza e masave për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit. 3.3 Situacionet mujore pjesore, progresive dhe përfundimtare hartohen mbi bazën e volumeve të llogaritura në librezën e masave dhe çmimeve faktike, mbështetur në analizat teknike të çmimeve, që përfshihen në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit, të miratuara çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave. Ato firmosen nga drejtuesi teknik i objektit, mbikëqyrësi i punimeve dhe përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit për të cilin është miratuar leja e ndërtimit. Në rastet kur në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit mungojnë analizat teknike të çmimeve të zërave të punimeve të kryera në objekt, veprohet në përputhje me procedurën e përcaktuar në pikën 8 të vendimit nr. 514, datë 15.8.2007 të Këshillit të Ministrave “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit

	prot., datë 13.09.2019 me objekt <i>‘Ndërtimi i Ujësjetllës të Fshatrave Lalëz, Bizë, Draç dhe Shetë Njësia Administrative Ishëm - Bashkia Durrës’</i> .
Rekomandimi:	Nga ana e UK Durrës sh.a. të merren masa për ngritjen e një grupi pune me specialistë të fushës ⁴⁵ me qëllim kryerjen e sondazheve përfaqësuese në terren për të verifikuar zbatueshmërinë e projekt – preventivit të kontratës, konkretisht zbatueshmërisë së zërave për transportin e materialit të gërmuar, mbushjes me rrë si dhe mbushjes me zhavorr për të cilat nuk konfirmohet kryerja e tyre në shumën prej 23,510,933 lekë pa TVSH. Në rast të konstatimit të punimeve të pakryera nga ato të përfshira në situacionin përfundimtar, të kërkohet arkëtimi i dëmit përkatës.

Lidhur me sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi mbikëqyrësi i punimeve z. H. M., kolaudatori i punimeve z. V. B. si dhe grupi i ndjekjes së kontratës i përbërë nga z. G. D., z. L. F. dhe z. N. S..

Nga ana e shoqërisë K. SH.P.K është dërguar observacioni i administruar në KLSH me nr. 825/9 prot., datë 02.03.2023 i cili gjen trajtim si më poshtë.

Pretendimi i subjektit:

“Me datë 27.02.2023 pranë zyrave të selisë së shoqërisë sonë, nëpërmjet shërbimit postar kemi marrë shkresën me nr. 184/10 prot., datë 22.02.2023, të dërguar nga ana e investitorit Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Durrës SH.A. lidhur me pretendimet dhe detyrat e përcaktuara në Raportin⁴⁶ e Auditimit nr. 825/8 prot., datë 14.02.2023 të hartuar nga ana e Kontrollit të Lartë të Shtetit për zbatimin e punimeve në ndërtimin e objekteve:

Përmirësimi i furnizimit me ujë Lagia Nr. 1, Vadardhë, Njësia Administrative Sukth Bashkia Durrës.

Ndërtimi i Ujësjetllës të Fshatrave Lalëz, Bizë, Draç dhe Shetë Njësia Administrative Ishëm - Bashkia Durrës.

Për sa më sipër ju bëjmë me dije se në shoqërinë tonë nuk ka ardhur asnjë lajmërim zyrtar në lidhje me auditimin dhe konstatimet e kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit të realizuar gjatë kësaj periudhe pranë shoqërisë në lidhje me objektet e sipërcituara.

Në lidhje me gjetjet nga auditimi për objektin ‘Përmirësimi i furnizimit me ujë Lagia Nr. 1, Vadardhë, Njësia Administrative Sukth Bashkia Durrës’ në lidhje me zërin Prova në tub, ju bëjmë me dije se tubat i nënshtrohen disa lloje testesh, ku mund të përmendim teste në laborator, nga ku nxirren specifikat e tubave që do të përdoren si p.sh. dimensionit, përbërja materiale, presioni maksimal, etj. të cilat paraqiten në certifikatat e cilësisë të bashkëngjitura në dosjen e objektit dhe që mbulohen të gjitha nga ana jonë, si dhe teste në terren në përfundim të vendosjes së tubave, të cilat parashikohen në preventiv. Këto teste kryhen para vendosjes së veprës në punë për të evidentuar dëmtime të mundshme edhe nga faktorë të jashtëm, defekte apo mosfunksionim të të gjithë veprës në tërësi, përfshirë tubat rakorderitë, pusetat e manovrimit, saracineskat shpindel e deri tek konsumatori. Pra ky lloj testi nuk përfshin vetëm tubat.”

Qëndrimi i Audituesve shtetërorë të KLSH

Në përfundim të shqyrtimit të plotë të observacioneve si më sipër Grupi i Auditimit, pasi analizoi dhe vlerësoi me objektivitet, profesionalizëm dhe pavarësi arriti në konkluzionin se materialet e dorëzuara nuk sjellin fakte shtesë nga ato të konstatuara gjatë fazës së auditimit në terren. Për sa

⁴⁵ Jo punonjës të përfshirë në procesin e ndjekjes së kontratës.

⁴⁶ Në fakt observuesi i referohet Raportit Përfundimtar të nisur në UK Durrës sh.a. SH.A.

më sipër pretendimet Tuaja nuk qëndrojnë dhe si të tilla ato nuk merren në konsideratë nga Grupi i Auditimit.

Nga ana e shoqërisë aksionare UK Durrës është dërguar observacioni i administruar në KLSH me nr. 825/11 prot., datë 15.03.2023 i cili gjen trajtim si më poshtë.

Pretendimi i subjektit:

Observacioni konsiston në një procesverbal të mbajtur në datë 07.03.2023 mes përfaqësuesit të firmës sipërmarrëse K. z. A.D., përfaqësuesi të AK z. B. M. si dhe mbikëqyrësit të punimeve z. Xh. M. sipas të cilit është kryer një përzgjedhje rastësore për kryerjen e një sondazhi në piketën L-D 7000 nga ku ka rezultuar se:

Bankina ishte e sistemuar me stabilizant dhe në kuotë me asfaltin e rrugës;

Kanali ishte i mbushur me material të zgjedhur, i përzier me zhavorr;

Tubi ishte i mbuluar me rërë shtufi;

Qëndrimi i Audituesve shtetërorë të KLSH

Në përfundim të shqyrtimit të plotë të observacioneve si më sipër Grupi i Auditimit, pasi analizoi dhe vlerësoi me objektivitet, profesionalizëm dhe pavarësi arriti në konkluzionin se materialet e dorëzuara nuk sjellin fakte shtesë nga ato të konstatuara gjatë fazës së auditimit në terren. Sqarojmë se një sondazh i vetëm nuk mund të jetë përfaqësues për gjithë volumnin e punës të realizuar për shtrimin e tubave. Për sa më sipër pretendimet Tuaja nuk qëndrojnë dhe si të tilla ato nuk merren në konsideratë nga Grupi i Auditimit.

- **Zhvillimi i Procedurës** "Sistemimi i kanalizimeve të ujërave të ndotura të zonës turistike Hamallaj, Faza I, Njësia Administrative Sukth , Bashkia Durrës".

Përshkrimi i procedurës

Sipas Vendimit nr. 7 datë 27.03.2019 të Këshillit Teknik pranë AKUM, është miratuar projekt-preventivi me objekt "Sistemimi i kanalizimeve të ujërave të ndotura të zonës turistike Hamallaj, Faza I, Njësia Administrative Sukth , Bashkia Durrës", me vlerë 98,553,920 lekë me TVSH. Ky projekt përfshin ndërtimin e rrjetit të kanalizimeve për zonën e banuar në veri të qytetit të Durrësit, si dhe fshatrat Hidrovor, Hamallaj, Draç, Bizë dhe Rrotull.

Fondi Limit

Fondi limit në vlerën: **82,111,600.45 leke (pa TVSH).**

Përmbledhja e procedurës në tabelë

Procedura e Prokurimit "Sistemimi i kanalizimeve të ujërave të ndotura të zonës turistike Hamallaj, Faza I, Njësia Administrative Sukth, Bashkia Durrës"		
Urdhër Prokurimi nr.1296/4 prot, date 27.05.2019		
1.Lloji i Procedurës së Prokurimit Procedurë e hapur pune	2. Njesia e prokurimit Znj.A. B. z. B. M. znj. D. B.	3. Komisioni i Vleresimit të Ofertave Sipas Urdhrit nr. 3491/6, date 04.12.2020 z. D. Gj. (Kryetar) znj. D. S. (Anëtar) znj. M. H. (Anëtar)

4. Komisioni i Hartimit të Specifikimeve Teknike		
Z. L. F. z.N. S.		
5. Fondi Limit (pa tvsh) 82,111,600 lekë	6. Oferta Fituese (pa tvsh) 79,915,686 lekë	7. Diferenca me fondin Limit (pa tvsh) 2,195,914 lekë
8. Data e hapjes se ofertave 02.07.2019	9. Burimi i Financimit Buxheti i Shtetit	10. Operatoret Ekonomikë 1. "F." shpk – 75,497815.50 lekë pa TVSH 2. "L." shpk & "A" shpk – 75,452,472 lekë pa TVSH 3. "B." shpk & "M" shpk & "Sh." shpk – 69,477,050 lekë pa TVSH 4. "B." shpk – 81,567,667.60 lekë pa TVSH 5. "2T" shpk – 79,915,686.35 lekë pa TVSH
11. Ankimime L. sh.p.k. nr. 1542 Prot. datë 22.07.2019	12. Pergjigje e ankesës nga AK Kthim pergjigje me nr.1542/1 Prot. datë 29.07.2019	13. Grupi i ndjekjes së Kontratës z. L. F. z. T. D. z. A. K.
b.Zbatimi i Kontratës se Punimeve/Shërbimeve/Mallrave		
14. Lidhje e kontratës Nr. Prot. 13.09.2019	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 95,898,823 leke me TVSH	16. Afati i kontratës ne dite. Afati i realizimit 120 ditë

Sipas Urdhrit nr. 1296/1 Prot. datë 22.05.2019, z. L. F., dhe z. N. S. urdhërohen të hartojnë në mënyrë të detajuar specifikimet teknike si dhe kërkesat për kualifikimin e operatorëve ekonomik. Gjatë auditimit të specifikimeve teknike, grupi i auditimit vëren kriteret teknike të cilat duken të ekzagjëruara përsa i përket objektit të kontratës, si më poshtë:

- Licencat e mëposhtme:

NP 2-B Ndërtimi civile dhe industrial,

Sipas projektit dhe preventivit të hartuar nga ana e projektuesit dhe të miratuar nga ana e AK nuk rezulton asnjë zë i vetëm punimesh që të ketë lidhje me ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta, në objekte ku zhvillohen aktivitete njerëzore të drejtpërdrejta ose jo, kompletimi me strukturat e nevojshme dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar godina banimi, shkolla, zyra, kazerma ushtrie, teatro, stadione, godina industriale, godina për parkim, burgje, stacione hekurudhore dhe metroje, godina aeroporti me ndonjë punim special në betonarme të thjeshtë ose të paranderur, betonim të tavaneve të hollë, membrana, kupola, depozita të varura, sillos dhe ndërtime të larta me strukturë me karakteristika të veçanta e komplekse.

NP 5-B Punime nëntokësore, ura e vepra arti

Sipas projektit dhe preventivit të hartuar nga ana e projektuesit dhe të miratuar nga ana e AK nuk rezulton asnjë zë i vetëm punimesh që të ketë lidhje me ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime, me anë të përdorimit të mjeteve teknike speciale, të ndërhyrjeve nëntokë që janë të lidhura me ndjeshmërinë e lëvizshmërisë mbi "goma" ose mbi "hekur", kushdo që të je të shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo veprë lidhëse, plotësime ose pajisje, në pika të veçanta ose në rrjet, rrugët hyrëse të çdo shkalle rëndësie, devijimet në nivele dhe në lartësi, punime të mureve mbajtëse. Përfshin në

mënyrë të thjeshtuar galeritë natyrore, shpime, kalime nëntokësore, tunele. Në kushte të tilla vendosja e licencës së mësipërme është një kriter diskriminues dhe përtej kapacitetit të nevojshëm që i duhet OE pjesëmarrës për të kryer një projekt të tillë i cili as nuk ka parashikuar punime për këtë kategori licence.

NP. 11-A Ndërtime për N/Stac., kab. e transform., linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë

Sipas projektit dhe preventivit të hartuar nga ana e projektuesit dhe të miratuar nga ana e AK nuk rezulton asnjë zë i vetëm punimesh që të ketë lidhje me ndërtime, mirëmbajtje ose rristurime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshëm për shpërndarjen e T/N dhe tensionit të mesëm dhe për transformimin dhe shpërndarjen e tensionit të ulët deri te përdoruesit e energjisë elektrike, të kompletuar me punimet e muraturës, plotësuese ose ndihmëse, të veçanta ose të rrjetit. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar centrale dhe kabina transformacioni, shtyllat metalike të nevojshme për transportin dhe shpërndarjen e çfarëdo lloji tensioni, furnizimin dhe vendosjen në vepër të linjave elektrike për çfarëdo numër fazash elektrike, ajrore ose tokësore.

Në kushte të tilla vendosja e licencës së mësipërme është një kriter diskriminues dhe përtej kapacitetit të nevojshëm që i duhet OE pjesëmarrës për të kryer një projekt të tillë i cili as nuk ka parashikuar punime për këtë kategori licence.

Të kenë në stafin e tyre një inxhinier elektronik i cili gjithashtu nuk është në proporcion me objektin e kontratës.

Të kenë në stafin e tyre:

4 Punonjës mekanik

4 Punonjës Elektricitist

4 Punonjës Bojaxhi

2 Punonjës Pllakashtrues,

kritere të cilat janë të ekzagjuruara për objektin e kontratës dhe për zërat e punimeve.

Disa nga Kriteret e Veçanta të cituara më sipër janë kërkuar për argumentin dhe nga ana e APP-së, ku grupi i auditimit edhe pas shqyrtimit të korrespondencës midis A.K. dhe A.P.P. nuk u kuptua argumentimi i tyre.

19. Titulli i gjetjes:	Vendosja e kriterëve dhe specifikimeve teknike diskriminuese për pjesëmarrjen e O.E. në garë.
Situata:	Gjatë zhvillimit të Procedurës së Prokurimit me objekt “ <i>Sistemimi i kanalizimeve të ujërave të ndotura të zonës turistike Hamallaj, Faza I, Njësia Administrative Sukth, Bashkia Durrës</i> ” gjatë hartimit të specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta, janë vendosur kritere të cilat nën gjykimin e audituesve janë të ekzagjuruara dhe jo në proporcion me objektin e kontratës si më poshtë: Vendosja e licencës të mëposhtme: <i>NP 2-B Ndërtimi civil dhe industrial, NP 5-B Punime nëntokësore, ura e vepra arti NP. 11-A Ndërtime për N/Stac., kab. e transform., linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë</i> , ku bazuar në VKM nr. 943 datë 28.12.2016 ⁴⁷

⁴⁷ Për Disa Ndryshime Dhe Shtesa Në Vendimin Nr.759, Datë 12.11.2014, Të Këshillit Të Ministrave, "Për Licencimin Profesional Të Individëve Dhe Personave Juridikë Që Do Të Ushtrorjnë Veprimtari Në Fushën E Studimit E Të Projektimit Në Ndërtim Dhe Mbikëqyrjes E Kolaudimit Të Punimeve Të Zbatimit Në Ndërtim"

	nuk janë në proporcion me objektin e kontratës si dhe me zërat dhe punimet e detajuara në preventivin e punimeve. Vendosja e kriterëve si më poshtë: <i>1 inxhinier elektronik ,4 Punonjës mekanik, 4 Punonjës Elektracist, 4 Punonjës Bojaxhi, 2 Punonjës Pllakashtrues</i> , ku për shkak të volumit të vogël të punës që ka në lidhje me ndërtimin është i panevojshëm përfshirja e tyre si kriter për të qenë pjesëmarrës në garë.
Kriteri:	Neni 23 “ <i>Specifikimet Teknike</i> ”, Ligji nr.9643 datë 20.11.2006 “ <i>Për Prokurimin Publik</i> ”, i ndryshuar.
Ndikimi/Efekti:	Pengon konkurrencën e drejtë
Shkaku:	Hartimi i specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta diskriminuese.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	UK Durrës sh.a., në zhvillimin e procedurave të prokurimit, veçanërisht në hartimin e kriterëve të veçanta, të ketë parasysh që të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, përmbajtjen e tij duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve.

Përsa është trajtuar në këtë pjesë të P/Raportit të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacion me shkresë nr.825/12 prot, datë 15.03.2023 “Observacion mbi Akt Konstatimin Nr.13 datë 13.01.2023 në lidhje me procedurën e prokurimit “*Sistemimi i kanalizimeve të ujërave të ndotura të zonës turistike Hamallaj, Faza I, Njësia Administrative Sukth, Bashkia Durrës*” nga z. S. K. ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

Janë kërkuar kategoritë përkatëse të licencave pasi:

Kategoria NP-2 Ndërtime civile dhe industrial kërkohen sepse projekti përfshin që për një zonë të caktuar të bëhet kalimi i lumit Tarin, me anë të elementëve parafabrikat, për të cilat parashikohet dhe kjo kategori licencimi.

Kategoria NP-5 punime nëntokësore kërkohet sepse gjatë implementimit të projektit kemi intersektimet e rrugës kryesore me kanalet kulluese të zonës dhe duhet të kryhen punime speciale duke ditur se këto objekte janë të rëndësishë së veçantë.

Kategoria NP-11 Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike) kërkohet sepse gjatë implementimin të projektit kemi intersektime të linjave të tensionit të lartë dhe të mesëm dhe kontraktuesi i punimeve duhet të jetë i licensuar me këtë kategori për të shmangur defektet ose dhe kryerjen e tyre gjatë ecurisë së punimeve.

Inxhinier elektronik, në projekt parashikohet të bëhet lidhja me stacionin e kanalizimeve ekzistuese nr.3, në të cilën kemi pajisje të sistemit Scada për të cilën kërkohet specialist i fushës së elektronikës.

Megjithatë O.E. të cilët duan të jenë pjesëmarrës në çdo procedurë prokurimi kanë të drejtë të ankohen sipas ligjit pranë organeve APP dhe KPP në çdo fazë të procedurave dhe nuk privohen nga kjo e drejtë, sa më sipër pra për sa kohë nuk ka ankesa, kriteret nuk mund të paragjykojnë. Vete APP është autoriteti parësor i cili kontrollon DST dhe del me rekomandimeve nëse vëren se ka kushte për konkurrim jo të drejtë.

Për këtë procedurë ka pasur ankesa në faza të ndryshme të prokurimit, të cilat janë marrë parasysh dhe janë përmirësuar apo ndryshuar kriteret sipas rekomandimeve edhe të vetë APP.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit të KLSH –së:

Në lidhje me observacionin e bërë nga ana e z. S. K., grupi i auditimit pas analizimit të observacionit mban të njëjtin qëndrim mbi gjetjen duke cituar dhe njëherë që në preventivin e punimeve nuk përfshihen zëra punimesh të cilat arsyetojnë pajisjen e O.E. me licencat e mësipërme. Gjithashtu edhe për sa i përket numrit të punonjësve gjithashtu ricilësohet se nuk nevojitet numër i lartë punonjësish në lidhje me preventivin e punimeve si dhe për sa i përket inxhinierit elektronik nuk është i nevojshëm pasi për shtimet e moduleve të reja në sistemin SCADA është O.E. mirëmbajtës i sistemit i cili e ka për detyrë shtimin e moduleve (Stacioneve të reja).

Për këto arsye, sa më sipër, observacioni juaj nuk pranohet.

Për sa më sipër, ngarkohen me përgjegjësi z. L. F. dhe z. N. S., në cilësinë e hartuesve të specifikimeve teknike, në kundërshtim me Nenin 46 të Ligjit për Prokurimin Publik “Kualifikimi i ofertuesve”.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga Auditimi: Nga Ujësjellës Kanalizime Durrës sh.a. nuk është respektuar afati ligjor prej 6 muajsh nga data e njoftimit të Raportit të Auditimit, në lidhje me raportimin në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 21 , të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1 Rekomandimi: UK Durrës sh.a., të marrë masa për njoftimin e KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, me qëllim përmirësimin e funksionimit të shoqërisë.

Në vijimësi

2. Gjetje nga Auditimi: Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit për auditimin e ushtruar në Ujësjellës Kanalizime Durrës sh.a. administruar në KLSH me nr. 520/56 prot., datë 04.12.2020, janë rekomanduar gjithsej:

- 12 masa organizative, nga të cilat janë zbatuar 8 masa , në proces zbatimi 3 masa dhe të pa zbatuara 1 masë.
- 12 masa shpërblim dëmi, nga të cilat janë zbatuar 5 masa , në proces zbatimi 7 masa.
- 9 masa për eliminimin e efekteve negative, nga të cilat janë në proces zbatimi 9 masa.
- 3 masa për procedura të realizuara në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik, nga të cilat janë në proces zbatimi 3 masa.

19 masa disiplinore, nga të cilat janë zbatuar 19 masa

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 24 , të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1 Rekomandimi: UK Durrës sh.a., të marrë masa për realizimin e plotë të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, me synim realizimin e objektivave dhe në përmbushjen e misionit të shoqërisë.

Menjëherë

3. Gjetje nga Auditimi: Rritja e ujit pa të ardhura tregon se, një pjesë e madhe e “klientëve”, por që zyrtarisht nuk janë të tillë dhe që realisht marrin ujë nga sistemi nuk faturohen dhe nuk e paguajnë atë.

Shoqëria UK Durrës sh.a., për periudhën objekt auditimi, është karakterizuar nga një paqëndrueshmëri e lartë financiare.

Rritja vjetore e të ardhurave (faturimi total), krahasuar me një vit më parë, rezulton përkatësisht 2.3 % në vitin 2019, -0.4 % në vitin 2020, dhe 6.5 % në vitin 2021.

Norma e arkëtimit është llogaritur sipas kategorisë së arkëtimit korrent dhe të prapambetur. Gjithashtu, e para ka një ulje nga 79.8 % në vitin 2018 në 54 % në vitin 2021, dhe arkëtimi i prapambetur është rritur nga 17 % në vitin 2018 në 37 % në vitin 2021.

Realizimi i shpenzimeve dhe investimeve është i paqëndrueshëm, përkatësisht 37% në vitin 2018, 55% në vitin 2019, 39 % në vitin 2020 dhe 156 % në vitin 2021.

Sa më sipër, kjo ndodh se parashikimet e investimeve apo nevojat për shpenzime kryhen pa studime konkrete dhe analiza të plota me bazë rrisht.

Diferenca ndërmjet kostos së shitjes dhe kostos së prodhimit **përbën koston shtesë joefektive në vlerën prej -118.46 leke/ m³**, nga ku 20 % e saj ose 24 leke/ m³, përbën humbjen teknike të pranuar.

Përsa më sipër, kjo situatë vjen kryesisht ngaqë shoqëria nuk ka organizuar dhe planifikuar mjaftueshëm burimet e saj, duke lejuar një rritje të papranueshme të ujit pa të ardhura.

Planifikimi për buxhetin e shoqërisë është kryer mbi bazën e nevojave të krahasuara me një vit më parë, mbi bazën e kërkesave të veçuara, pa analiza të plota të rrisht dhe të pambështetura në prioritetet konkrete dhe politika të qarta komerciale.

Sa më sipër, shoqëria ka pësuar një humbje financiare, përkatësisht për vitin 2019 në vlerën - 201,045,754 lekë, për vitin 2020 në vlerën prej -216,213,668, për vitin 2021 në vlerën prej - 370,713,260 lekë, si edhe për 9/Mujorin e vitit 2022 në vlerën prej -498,412,304 lekë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 28, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1 Rekomandimi: Administratori i shoqërisë UK Durrës sh.a. të marrë të gjitha masat për të ngritur një sistem eficient të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar, krijimin e regjistrat të rrisht dhe funksionimin e grupit të menaxhimit strategjik.

Hartuesit e programit ekonomik-financiar duhet të mbështeten në analiza të plota me bazë rrisht si edhe të orientuar nga prioritetet të përcaktuara më parë, me qëllim evidentimin dhe korrigjimin e shkaqeve që ndikojnë në mosrealizimin e objektivave të shoqërisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga Auditimi: Konstatohen 8 raste me copëzim fondesh, ku shoqëria nuk ka marrë parasysh grupin e mallrave apo shërbimeve të ngjashme, të cilat zakonisht duhet të prokurohen njëherësh, me qëllim parandalimin e shmangies të procedurave konkurruese të prokurimeve.

Shoqëria, procedurat e prokurimit nuk i ka planifikuar sipas natyrës, sasisë dhe llojet e kontratave, që do të prokurohen, por brenda shumës totale të parashikuar ka realizuar procedurat e prokurimit në vlerë të vogël sipas nevojës.

- Në vitin 2019 është kryer shërbimi i ngjashëm riparim pjesë motorike dhe xhenerike të mjeteve me të njëjtin operator ekonomik A. G.. Procedurat sipërcituara së bashku rezultojnë në vlerën 1,227,000 lekë, që tejkalojnë me 227,000 lekë pragun e procedurës së prokurimit në vlerë të vogël.

- Në vitin 2021 është kryer shërbimi i ngjashëm riparim pjesë motorike dhe xhenerike të mjeteve. Procedurat e sipërcituara së bashku rezultojnë në vlerën 2,245,533 lekë, që tejkalojnë me 1,245,533 lekë pragun e procedurës së prokurimit në vlerë të vogël.

- Në vitin 2022 është kryer shërbimi i ngjashëm riparim pjesë motorike dhe xhenerike mjeteve, që tejkalojnë me 976,199.87 lekë pragun e procedurës së prokurimit në vlerë të vogël.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 32, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1 Rekomandimi: Administratori i shoqërisë ose personi i autorizuar dhe personi përgjegjës i prokurimeve të marrin të gjitha masat që në hartimin e regjistrit të prokurimeve të parashikohen të gjitha procedurat e blerjes së mallrave, punëve dhe shërbimeve, që do të prokurohen në vlerë të vogël, me qëllim që të shmangë përdorimin e paplanifikuar dhe të parregulluar të fondeve publike.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga Auditimi: Në 6 raste, nga dosjet e kontrolluara, operatorët ekonomikë fitues rezultojnë me 2 oferta të ndryshme për të njëjtën objekt prokurimi, njëra ofertë e paraqitur gjatë verifikimit në treg për vlerësimin e fondit limit, dhe tjetra në vlerë më të ulët, gjatë zhvillimit të procedurës elektronike të prokurimit:

Në vitin 2018_Procedura e prokurimit me objekt *“Riparim i pompës kineze H 250 m dhe Q 100 lit/s”* dhe procedura e prokurimit me objekt *“Shërbim riparim pompe centrifugale për stacionin Fushë Kuqe”*. Në vitin 2019_Procedura e prokurimit me objekt *“Furnizim vendosje materiale elektrike të tensionit të mesëm (TM) në Fushë Kuqe”* dhe Procedura e prokurimit me objekt *“Riparim Fadrome”* e mjetit me targë AA 125 AB modeli JCB 3CX. Në vitin 2021 Procedura e prokurimit me objekt *“Riparim mjeti Renault”* dhe procedura e prokurimit me objekt *“Blerje materiale për elektropompën zhytëse Sulzer 15”*.

Në zbatim të pikave 1 dhe 3 të Udhëzimit Nr.11 datë 30.05.2018, të Agjencisë Prokurimit Publik, komisioni i prokurimit ka detyrimin të krahasojë ofertat e operatorëve ekonomik me fondin limit të përcaktuar më parë nga autoriteti kontraktor, me qëllim që oferta e OE të jetë sa më reale.

Komisioni i prokurimit në vlerë të vogël është vënë në dijeni jo vetëm për fondin limit të objektit të prokurimit, por edhe të ofertave të administruara gjatë studimit të tregut, që rezultojnë të jenë në të njëjtën kohë edhe me ofertat e prezantuara në sistemin elektronik.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 34, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5.1 Rekomandimi:

Administratori i shoqërisë të analizojë situatën e krijuar dhe të përcaktojë shkallën e përgjegjësisë të personave përgjegjës.

Menjëherë

6. Gjetje nga Auditimi: Për katër vitet ushtrimore 2018, 2019, 2020 dhe 2021 bilancet nuk janë dorëzuar sipas legjislacionit në fuqi si dhe shtyrjeve me anë të akteve normative.

Në analizimin e zërit Mjete Monetare vihet re që nga viti 2018 deri në vitin 2021 kemi një rënie në vlerë e cila pasqyrohet si mos arkëtim si më poshtë, duke mos dhënë arsyt përkatëse se përse vjen kjo rënie e mos arkëtimeve. Të ardhurat kryesore në bankë janë depozitimet e arkës gjatë mbylljeve ditore.

Në analizimin e zërit Të drejta të Arkëtueshme dhe nënkategorisë “nga aktiviteti i shfrytëzimit” vihet re një rritje në vlerë e cila përkon me mosarkëtim në kohë të detyrimeve nga ana e debitorëve që reflektohet dhe në zërin e Mjeteve Monetare si një rënie e arkëtimeve me anë të Bankës dhe Arkës.

Në analizimin e zërit të Drejta të Arkëtueshme vihet re që në nënkategorinë “llogari të tjera të arkëtueshme”, përshkrimi i llogarisë “Institucioni Financiare për t’u arkëtuar Posta, Uft, etj të drejta të cilët nuk sqarohen nëse përkojnë me të ardhurat e përfituara në muajin dhjetor dhe të mbledhura nga këto institucione për llogari të shoqërisë apo për ndonjë arsye tjetër.

Në analizimin e zërit të Drejta të Arkëtueshme vihet re që në nënkategorinë “llogari të tjera të arkëtueshme”, përshkrimi i llogarisë “Garanci përmbarues privat” paraqitet një vlerë e cila në fund të periudhës 2018 paraqitet si vlerë 24,105,629 lekë, duke u shtuar në periudhën pasardhëse në vlerën 28,069,356 lekë dhe duke qëndruar si e tillë për vitet në vazhdim, duke mos dhënë arsyt përkatëse se çfarë karakterizon kjo vlerë dhe përse është e mbartur ndër vite.

Në analizimin e zërit të Drejta të Arkëtueshme, në llogaritë e arkëtueshme janë të krijuar provizione për zhvlerësimin e aktiveve financiare të ndara në 3 kategori, atë të KL Familjar, KL Privat dhe KL Ente. Nga analizimi i tyre vihet re që vlera e provizionit mbetet e pandryshuar dhe nuk jepen shpjegime se klientët e përfshirë në klasifikimet e mësipërme në çfarë viti janë mbartur dhe përse janë klasifikuar si provizione dhe jo si borxh i keq. Në ato pak raste ku ndërmarrja ka humbur me anë të vendimit të gjykatës vlerë të caktuar të cilat i përkasin faturimeve që janë provizionuar për humbje, ekziston një vlerë e re e cila kalon si shpenzime të periudhës duke mos dhënë arsytet përkatëse mbi karakteristikat e vlerës.

Në analizimin e zërit Detyrime Afatshkurtra dhe nënkategorisë “*Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit*” vihet re një rritje në vlerë e këtij zëri ku në të cilën janë të përfshira edhe detyrimet e mbartura nga institucionet e tjera si Ujësjiellës Kavajë, Ndërmarrja rruga si dhe OSSH, për të cilët administrata nuk ka ndjekur asnjë rrugë për likuidimin e tyre duke caktuar një rend apo një metodë të drejtë mbi likuidimin e tyre.

Në analizimin e zërit Detyrime Afatgjata dhe në nënkategorinë “*Titujt e huamarrjes*” përfaqësohet nga tre kredi afatgjatat Kredia OPEC lidhur me datë 10.10.2002 në vlerën 2,672,938 USD, Kredia BEI lidhur me datë 15.04.2044 në vlerën 7,011,841 Euro si dhe Kredia IDA lidhur me datë 07.07.2003 në vlerën 5,201,310 USD, të konvertuara me kursin e ditës për vitet përkatëse ku e njëjta gjë vazhdon dhe për vitet në vijim kur principi dhe interesat nuk paguhën, por njihen si detyrime ndaj Ministrisë së Financave.

Në analizimin e shpenzimeve në zërin Gjoha, Penalitete, Dëmshpërblime gjendja të cilat rëndojnë buxhetin e shoqërisë duke i përdorur fondet pa efektivitet, efience dhe ekonomicitet.

Në analizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve ku në të cilën shihet që shoqëria tre vitet e fundit, duke mbajtur të ardhurat në mënyrë konstante ka rritur shpenzimet dhe kur shoqëria rezulton me humbje.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 43, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

6.1 Rekomandimi: UK Durrës sh.a. gjatë hartimit të pasqyrave financiare të marrë në konsideratë Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, hartimin, miratimin dhe depozitimit e pasqyrave financiare në kohë sipas legjislacionit në fuqi si dhe të ketë parasysh likuidimin në kohë ose duke krijuar një rend mbi likuidimin e kreditorëve të cilët janë akumuluar ndër vite.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga Auditimi: Gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit me objekt “Rikonstruksion në rrjetin ekzistues të qytetit të Durrësit, zona 10 dhe 13/1, Bashkia Durrës” për vitin 2021, në analizimin e hartimit të specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta u gjetën kriterë të cilat nuk ishin në proporcion me objektin e kontratës si dhe në mospërputhje me njëra tjetrën si më poshtë: *Shofer 4 persona, Automakinist 2 persona dhe Manovrator 6 persona*, ndërkohë kërkon që të disponohen dhe mjetet që në total janë 25 mjete të kërkuara me 12 shoferë të kërkuar më sipër, të cilët janë mjete që duhen të jenë në shfrytëzim me kohë të plotë dhe që minimumi duhet të kenë nga një shofer për çdo mjet si dhe përfshirja e një numri të vogël të inxhinierëve në proporcion me vlerën dhe me zërat e punimeve në preventivin e punimeve.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 47, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

7.1 Rekomandimi:

UK Durrës sh.a., në zhvillimin e procedurave të prokurimit, veçanërisht në hartimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta, të ketë parasysh që të përgatiten për të përshkruar

sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve.

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga Auditimi: Gjatë zhvillimi të Procedurës së Prokurimit me objekt *“Blerje mjete për nevojat e UK Durrës sh.a.”* gjatë hartimit të specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta, nuk janë cilësuar se të çfarë viti prodhimi duhet të jenë automjetet, që është minimumi mbi përlllogaritjen e vlerës që mbartin ato. Gjithashtu në specifikimet teknike të “Makinë teknologjike APV vetëshkarkuese” është kërkuar kriter që për km e përshkruara të jenë jo më shumë se 251,000 km, ndërsa për të njëjtin automjet “makinë teknologjike vetëshkarkuese për pastrim pusetash e kanalizime dhe transport materiale të veçanta” në specifikimet teknike kërkohet që në kilometrat e përshkruara të jenë jo më shumë se 150,000 km, që do të thotë për një objekt të njëjtë kërkohen specifikime teknike të ndryshme. Për automjetin “makinë teknologjike APV” me targë AE....rezultoi që është me timon në krahë të djathtë, gjë e cila duhet që të ishte e cilësuar në specifikimet teknike për vet riskun që mbartin.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 50, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

8.1 Rekomandimi: Administratori i shoqërisë UK Durrës, të nxjerrë përgjegjësitë për komisionin e hartimit të specifikimeve teknike në lidhje me hartimin e procesverbalit mbi hartimin e specifikimeve teknike në lidhje me km e përshkruara të automjeteve dhe vitin e prodhimit si dhe për komisionin e marrjes në dorëzim të mallit, në lidhje me makinën teknologjike APV që rezultoi të jetë me timon në krahë të djathtë.

Menjëherë

9. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të kontratës me objekt *“Rikonstruksion i rrjetit të ujësjellësit Shkafane dhe Lagjet Muzhaq Kulls, nj. Adm. Ishëm, Bashkia Durrës”*, rezulton se në përfundim të procedurës së prokurimit, është shpallur fitues BOE G. & L., të përfaqësuar këta nga OE G. me nr. licence për zbatim punimesh NZ.7351/4 datë 15.06.2020 dhe me përfaqësues ligjor z. K. A. me të cilin është lidhur kontrata me Autoritetin Kontraktor e përfaqësuar nga z. K. B. me nr. 3011 prot., datë 24.12.2020 me vlerë 37,500,594.41 lekë me TVSh dhe me afat të zbatimit të punimeve 90 ditë kalendarike nga dita e nesërme e punës pas nënshkrimit të kontratës sipas grafikut të hartuar nga projektuesi.

- Nga auditimi, rezulton se volumet e punës të situacionit nr. 1, për disa zëra të ndryshëm janë nga 101 % deri në 300 % më tepër në krahasim me ato të preventivit të kontratës, në një kohë kur në nga data 07.01.2021 deri në datë 22.01.2021 nuk ka as një kërkesë dhe as miratim për ndryshim projekti. Nga krahasimi mes grafikut të punimeve dhe volumeve të situacionit kapaciteteve teknike të ofruar dhe të vendosura në dispozicion gjatë zbatimit të punimeve (procesverbali i fillimit të punimeve, ditari i punimeve etj.) rezulton se ka një diferencë të konsiderueshme mes volumeve të parashikuara për tu kryer me ato të situacionuara e likuiduara në vlerën 6,394,479.6 lekë me TVSH, ose gati 50 %.

- Nga auditimi i të dhënave të ditarit të punimeve dhe tabelës krahasuese të grafikut të punimeve rezulton se është likuiduar situacionit pjesor nr. 1 me vlerë 12,662,956.2 lekë me TVSH në kushtet kur nuk janë kryer zëra punimesh në vlerën 8,912,897 lekë me TVSH.

Sa më sipër është në kundërshtim me Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 *“Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”*, i ndryshuar, Kreu III, Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 *“Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”*, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3, Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve e lidhur sipas aktit nr. 2801 prot., datë 04.12.2020 si dhe me Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve e lidhur sipas aktit nr. 2345 prot., datë 12.05.2021.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 54, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

9.1 Rekomandimi: Nga ana e UK Durrës sh.a. të merren masa për ngritjen e grupeve efektive në drejtim ndjekjes së kontratës, me qëllim shmangien e kryerjes së pagesave përmes situacioneve fiktive e që nuk paraqesin realitetin në momentin e likuidimit.

Në vijimësi

10. Gjetje nga Auditimi: Gjatë zhvillimi të Procedurës së Prokurimit me objekt *“Sistemimi i furnizimit me ujë të zonës Turistike Hamallaj, Faza II, Nj. Adm. Sukth, Bashkia Durrës”* gjatë hartimit të specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta, janë vendosur kriterë të cilat nën gjykimin e audituesve janë të ekzagjeruara dhe jo në proporcion me objektin e kontratës si më poshtë:

Vendosja e licencave të mëposhtme: *NP.5-B Punime nëntokësore, ura e vepra arti, NP. 11-A Ndërtim për N/Stac., kab. e transform., linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë dhe NS. 1-A Punime për prishjen e ndërtimeve*, ku bazuar në VKM nr. 943 datë 28.12.2016⁴⁸ nuk janë në proporcion me objektin e kontratës si dhe me zërat dhe punimet e detajuara në preventivin e punimeve.

Vendosja e kriterëve si më poshtë: *“Për të provuar se ka përvojën e duhur, Operatori duhet të dëshmojë se ka të punësuar mesatarisht 150 punonjës”* ku përvoja e duhur nuk mund të matet me numrin e personave që ka të punësuar por me realizimet e projekteve të mëparshme dhe punëve të ngjashme dhe *“Drejtuesi Teknik të ketë përvojë jo më pak se 10 vjet”* kriterë të cilat diskriminojnë operatorët e tjerë si dhe drejtuesit teknik të cilët anën profesionale të tyre e dëshmon licenca përkatëse që kanë.

- Gjatë zhvillimi të Procedurës së Prokurimit me objekt *“Ndërtim i rrjetit të KUZ të fshatit Shënavlash, Bashkia Durrës”* gjatë hartimit të specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta, janë vendosur kriterë të cilat nën gjykimin e audituesve janë të ekzagjeruara dhe jo në proporcion me objektin e kontratës si më poshtë:

Vendosja e licencave të mëposhtme: *NP.5-B Punime nëntokësore, ura e vepra arti, NP. 11-A Ndërtim për N/Stac., kab. e transform., linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë dhe NS. 1-A Punime për prishjen e ndërtimeve*, ku bazuar në VKM nr. 943 datë 28.12.2016⁴⁹ nuk janë në proporcion me objektin e kontratës si dhe me zërat dhe punimet e detajuara në preventivin e punimeve.

Vendosja e kriterit si më poshtë: *“Drejtuesi Teknik të ketë përvojë jo më pak se 10 vjet”* kriterë të cilat diskriminojnë operatorët e tjerë si dhe drejtuesit teknik të cilët anën profesionale të tyre e dëshmon licenca përkatëse që kanë.

- Gjatë zhvillimi të Procedurës së Prokurimit me objekt *“Përmirësim i furnizimit me ujë lagja nr.1, Vardardh, nj. Adm Sukth, Bashkia Durrës”* gjatë hartimit të specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta, janë vendosur kriterë të cilat nën gjykimin e audituesve janë të ekzagjeruara dhe jo në proporcion me objektin e kontratës si më poshtë:

Vendosja e licencave të mëposhtme: *NP.5-B Punime nëntokësore, ura e vepra arti, NP. 11-A Ndërtim për N/Stac., kab. e transform., linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë, NS. 1-A Punime për prishjen e ndërtimeve dhe NS 9-A Punime strukturore special* ku bazuar në VKM

⁴⁸ Për Disa Ndryshime Dhe Shtesa Në Vendimin Nr.759, Datë 12.11.2014, Të Këshillit Të Ministrave, “Për Licencimin Profesional Të Individëve Dhe Personave Juridikë Që Do Të Ushtrijnë Veprimtari Në Fushën E Studimit E Të Projektimit Në Ndërtim Dhe Mbikëqyrjes E Kolaudimit Të Punimeve Të Zbatimit Në Ndërtim”

⁴⁹ Për Disa Ndryshime Dhe Shtesa Në Vendimin Nr.759, Datë 12.11.2014, Të Këshillit Të Ministrave, “Për Licencimin Profesional Të Individëve Dhe Personave Juridikë Që Do Të Ushtrijnë Veprimtari Në Fushën E Studimit E Të Projektimit Në Ndërtim Dhe Mbikëqyrjes E Kolaudimit Të Punimeve Të Zbatimit Në Ndërtim”

nr. 943 datë 28.12.2016⁵⁰ nuk janë në proporcion me objektin e kontratës si dhe me zërat dhe punimet e detajuara në preventivin e punimeve.

Vendosja e kriterit si më poshtë: “*Drejtuesi Teknik të ketë përvojë jo më pak se 10 vjet*” kriteret të cilat diskriminojnë operatorët e tjerë si dhe drejtuesit teknik të cilët anën profesionale të tyre e dëshmon licenca përkatëse që kanë.

- Gjatë zhvillimi të Procedurës së Prokurimit me objekt “*Sistemimi i furnizimit me ujë të zonës Turistike Hamallaj, Faza II, Nj. Adm. Sukth, Bashkia Durrës*” gjatë hartimit të specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta, janë vendosur kriteret të cilat nën gjykimin e audituesve janë të ekzagjeruara dhe jo në proporcion me objektin e kontratës si më poshtë:

Vendosja e licencës të mëposhtme “*NP.- 1 Punime gërmimi në tokë*” ku bazuar në VKM nr. 943 datë 28.12.2016⁵¹ nuk janë në proporcion me objektin e kontratës si dhe me zërat dhe punimet e detajuara në preventivin e punimeve.

Vendosja e kriterëve si më poshtë: “*Të kenë në stafin e tyre një inxhinier ndërtimi*” i cili gjithashtu nuk është në proporcion me objektin e kontratës, pasi do ishte e mjaftueshme përfshirja e një inxhinieri informatike ose elektronike për zhvillimin e procedurës, “*Të kenë në stafin e tyre një murator, bojaxhi*” ku për shkak të volumit të vogël të punës që ka në lidhje me ndërtimin është i panevojshëm përfshirja e tyre si kriter për të qenë pjesëmarrës në garë dhe “*Kamion me vinç (me kapacitet mbajtës mbi 5 ton)*” ku sipas specifikimeve teknike kemi të bëjmë me vendosjen e depozitave të klorit gjë që e bën të panevojshme pasjen si kriter të veçantë të kamionit me vinç vetëm për arsyen e mësipërme.

- Gjatë zhvillimi të Procedurës së Prokurimit me objekt “*Ndërtimi i ujësjellësit të fshatrave Lalëz, Bizë, Draç dhe Shetë, Njesia Administrative Ishëm-Bashkia Durrës*” gjatë hartimit të specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta, janë vendosur kriteret të cilat nën gjykimin e audituesve janë të ekzagjeruara dhe jo në proporcion me objektin e kontratës si më poshtë:

Mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës: “*Kamiona vetshkarkues kapacitet mbajtës (mbi 20 ton) – Copë 3*”, “*Kamiona vetshkarkues kapacitet mbajtës (mbi 13 ton) – Copë 2*” dhe “*Kamiona vetshkarkues kapacitet mbajtës (mbi 8 ton) – Copë 2*, të cilat duke u bazuar në preventiv e punimeve dhe grafikun e punimeve, nuk ka një llogaritje të ndarjes së tyre sipas tonazhit ku në gjykimin e audituesve ndarja e tyre si më sipër sipas tonazhit përbën arsye mbi skualifikimin e O.E. të tjerë pjesëmarrës ose orientimin drejtë një O.E. fitues të paracaktuar që të përmbushë kriteret e mësipërme.

Kërkesa për drejtues teknik si në rastin e: “*1 (një) inxhinier hidroteknik*” dhe “*1 (një) inxhinier ndërtimi*” e cila është e ulët në proporcion me objektin e kontratës dhe volumin e punëve në grafikun dhe preventivin e punimeve, ku minimalisht duhet të ishin kërkuar nga dy inxhinier për klasifikim.

- Gjatë zhvillimi të Procedurës së Prokurimit me objekt “*Sistemimi i kanalizimeve të ujërave të ndotura të zonës turistike Hamallaj, Faza I, Njesia Administrative Sukth, Bashkia Durrës*” gjatë hartimit të specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta, janë vendosur kriteret të cilat nën gjykimin e audituesve janë të ekzagjeruara dhe jo në proporcion me objektin e kontratës si më poshtë:

Vendosja e licencës të mëposhtme: “*NP 2-B Ndërtimi civil dhe industrial*”, “*NP 5-B Punime nëntokësore, ura e vepra arti*” dhe “*NP. 11-A Ndërtime për N/Stac., kab. e transform., linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë*” ku bazuar në VKM nr. 943 datë 28.12.2016⁵² nuk janë

⁵⁰ Për Disa Ndryshime Dhe Shtesa Në Vendimin Nr.759, Datë 12.11.2014, Të Këshillit Të Ministrave, “Për Licencimin Profesional Të Individëve Dhe Personave Juridikë Që Do Të Ushtrijnë Veprimtari Në Fushën E Studimit E Të Projektimit Në Ndërtim Dhe Mbikëqyrjes E Kolaudimit Të Punimeve Të Zbatimit Në Ndërtim”

⁵¹ Për Disa Ndryshime Dhe Shtesa Në Vendimin Nr.759, Datë 12.11.2014, Të Këshillit Të Ministrave, “Për Licencimin Profesional Të Individëve Dhe Personave Juridikë Që Do Të Ushtrijnë Veprimtari Në Fushën E Studimit E Të Projektimit Në Ndërtim Dhe Mbikëqyrjes E Kolaudimit Të Punimeve Të Zbatimit Në Ndërtim”

⁵² Për Disa Ndryshime Dhe Shtesa Në Vendimin Nr.759, Datë 12.11.2014, Të Këshillit Të Ministrave, “Për Licencimin Profesional Të Individëve Dhe Personave

në proporcion me objektin e kontratës si dhe me zërat dhe punimet e detajuara në preventivin e punimeve.

Vendosja e kriterëve si më poshtë: “inxhinier elektronik” i cili gjithashtu nuk është në proporcion me objektin e kontratës si dhe me zërat e punimeve si dhe “4 Punonjës mekanik, 4 Punonjës Elektricitist, 4 Punonjës Bojaxhi dhe 2 Punonjës Pllakashtrues” ku për shkak të volumit të vogël të punës që ka në lidhje me ndërtimin është i panevojshëm përfshirja e tyre si kriter për të qenë pjesëmarrës në garë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

10.1 Rekomandimi:

UK Durrës sh.a., në zhvillimin e procedurave të prokurimit, veçanërisht në hartimin e kriterëve të veçanta, të ketë parasysh që të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, përmbajtjen e tij duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve.

Në vijimësi

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me kontratën me objekt ‘Ndërtimi i Ujësjiellësit të Fshatrave Lalëz, Bizë, Draç dhe Shetë Njesia Administrative Ishëm - Bashkia Durrës’, rezulton se në përfundim të procedurës së prokurimit, është shpallur fitues BOE K. & N., të përfaqësuar këta nga OE K. me nr. licence për zbatim punimesh NZ. 4901/10 datë 06.06.2019 dhe me përfaqësues ligjor z. S. K. me të cilin është lidhur kontrata me Autoritetin Kontraktor e përfaqësuar nga z. K. B. me nr. 1922 prot., datë 13.09.2019 me vlerë 172,471,458.4 lekë me TVSh dhe me afat të zbatimit të punimeve 21 javë nga dita e nesërme e punës pas nënshkrimit të kontratës. Nga auditimi i dosjes teknike të kontratës, konkretisht nga krahasimi i librezës së masave, situacionit përfundimtar, projektit të miratuar me ndryshime, etj. rezultoi se i janë likuiduar tepër sipërmarrësit të punimeve shuma prej **49,755 lekë pa TVSH, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik** si rrjedhojë e punimeve të situacionuara por të pakryera në fakt për 2 zëra punimesh si më poshtë:

- Në lidhje me zërin ‘Mbushje me material të zgjedhur të gërmuar’,

Sipas situacionit përfundimtar për këtë zë rezulton se është likuiduar volumi prej 1168 m³. Libreza e masave pasqyron në mënyrë analitike të njëjtin volum punimesh. Në fakt nga analiza e kësaj të fundit konstatohet se gjerësia me të cilin është gërmuar kanali në segmentin L-B D.1 750-4275 është 0.25 ml kurse gjerësia e mbushjes me këtë material është marrë 0.6 ml. Duke bërë korrigjimet rezulton se është përfituar tepër nga ana e sipërmarrësit të punimeve volumi prej 123.55 m³ ose shuma prej **12,355 lekë pa TVSH.**

- Në lidhje me zërin ‘F.V. Tub PE100 Ø 63mm PN 10atm’,

Sipas situacionit përfundimtar për këtë zë rezulton se është likuiduar volumi prej 597 ml. Ky volum sipas librezës së masave ka rezultuar nga linja në L-B D.1 5087 - 4790 (368 ml), L-B D.4 0 - 165 (113 ml) dhe L-B D.9 0 - 125 (116 ml). Në fakt referuar kronologjisë së punimeve dhe volumeve të pasqyruara për volumet e gërmimit në tokë kat. III dhe tokë e fortë rezulton se po në këto akse janë gërmuar përkatësisht gjatësitë 300 ml, 113 ml dhe 116 ml, ose 529 ml në total, pra 68 ml më pak. Duke bërë korrigjimet rezulton se është përfituar tepër nga ana e sipërmarrësit të punimeve shuma prej **37,400 lekë pa TVSH.**

Si përfundim, rezulton se janë përfituar tepër nga ana e sipërmarrësit të punimeve vlera prej **49,755 lekë pa TVSH** si rrjedhojë e punimeve të pakryera në fakt, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik

për buxhetin e shoqërisë UK Durrës sh.a. dhe si e tillë duhet të zhdëmtohet nga ana e BOE “K. & N.” në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 71, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Nga ana e UK Durrës sh.a. të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **49,755 lekë pa TVSH** ndaj sipërmarrësit BOE K. & N. për punime të pakryera dhe/apo të kryera jo në përputhje me kërkesat e projektit por të likuiduara në kontratën e sipërmarrjes të lidhur sipas aktit me nr. 1922 prot., datë 13.09.2019 me objekt ‘Ndërtimi i Ujësjellësit të Fshatrave Lalëz, Bizë, Draç dhe Shetë Njësia Administrative Ishëm - Bashkia Durrës’.

Menjëherë

2. Gjetje nga Auditimi: Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me kontratën me objekt ‘Përmirësimi i furnizimit me ujë Lagia Nr. 1, Vadardhë, Njësia Administrative Sukth Bashkia Durrës’, rezulton se në përfundim të procedurës së prokurimit, është shpallur fitues BOE K. & L. & S., të përfaqësuar këta nga OE K. me nr. licence për zbatim punimesh NZ. 4901/12 datë 07.04.2020 dhe me përfaqësues ligjor z. S. K. me të cilin është lidhur kontrata me Autoritetin Kontraktor e përfaqësuar nga z. K. B. me nr. 1520 prot., datë 10.08.2020 me vlerë 153,273,319.4 lekë me TVSh dhe me afat të zbatimit të punimeve 200 ditë kalendarike nga dita e nesërme e punës pas nënshkrimit të kontratës. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se i janë likuiduar tepër sipërmarrësit të punimeve BOE K. & L. & S. vlera prej 336,000 lekë pa TVSH si rrjedhojë e punimeve të pa kryera në fakt dhe/ose jo të kryera sipas zërit të parashikuar në preventiv. Konkretisht kjo shumë rezulton si më poshtë:

- Në lidhje me zërin ‘Prova në tubin’.

Sipas projekt-preventivit të hartuar nga ana e projektuesit rezulton se janë përfshirë në preventiv e njëkohësisht edhe në ofertën e paraqitur nga sipërmarrësi i punimeve BOE K. & L. & S. zëri për kryerjen e provës së tubit. Në fakt referuar *Specifikimeve Teknike*, Kapitulli 8, pika 8.9 *Përshkrimi i çmimit njësi të tubave për kanalizimet përcaktohet se:* “Furnizim i tubacioneve të gjitha diametrave, mbajtja, shtrirja, furnizimi i të gjitha materialeve të nevojshme, veglave, pajisjeve të kërkuara për shtrimin e tubave, fuqia punëtore, përshtatësit, bashkuesit, izoluesit, prova e tubave, sigurimi dhe instalimi i shiritave me ngjyrë, sheshimi i sipërfaqes, hekuri dhe armimi i tubave dhe të gjitha aktivitetet siç përshkruhen më sipër janë përfshirë në çmimin njësi për një metër tubacion kanalizimesh”. Gjithashtu, referuar kontratës së sipërmarrjes të lidhur mes palëve sipas aktit me nr. 1520 prot., datë 10.08.2020, neni 31 Inspektimet, pika 1 *përcaktohet se:* “Kontraktori duhet të bëjë të gjitha testet dhe inspektimet e kërkuara nga dispozitat e kontratës. Kosto e këtyre testeve dhe inspektimeve duhet të financohet tërësisht nga Kontraktori brenda çmimit të kontratës”. Për rrjedhojë rezulton se është përfituar tepër nga ana e sipërmarrësit të punimeve shuma **336,000 lekë pa TVSH**.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 81, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Nga ana e UK Durrës sh.a. të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **336,000 lekë pa TVSH** ndaj sipërmarrësit BOE K. & L. & S. për punime të pakryera dhe/apo të kryera jo në përputhje me kërkesat e projektit por të likuiduara në kontratën e sipërmarrjes të lidhur sipas aktit me nr. 1520 prot., datë 10.08.2020 me objekt ‘Përmirësimi i furnizimit me ujë Lagia Nr. 1, Vadardhë, Njësia Administrative Sukth Bashkia Durrës’.

3. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me kontratën me objekt ‘Rikonstruksion i rrjetit të ujësjellësit Shkafane dhe Lagjet Muzhaq Kulls, nj. adm. Ishëm,

Bashkia Durrës, rezulton se në përfundim të procedurës së prokurimit, është shpallur fitues BOE G. & L., të përfaqësuar këta nga OE G. me nr. licence për zbatim punimesh NZ.7351/4 datë 15.06.2020 dhe me përfaqësues ligjor z. K. A. me të cilin është lidhur kontrata me Autoritetin Kontraktor e përfaqësuar nga z. K. B. me nr. 3011 prot., datë 24.12.2020 me vlerë 37,500,594.41 lekë me TVSh dhe me afat të zbatimit të punimeve 90 ditë kalendarike nga dita e nesërme e punës pas nënshkrimit të kontratës sipas grafikut të hartuar nga projektuesi.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se i janë likuiduar tepër sipërmarrësit të punimeve BOE G. & L. vlara prej **404,900 lekë pa TVSH** si rrjedhojë e punimeve të pa kryera në fakt dhe/ose jo të kryera sipas zërit të parashikuar në preventiv. Konkretisht kjo shumë rezulton si më poshtë:

- Në lidhje me zërin 'F.V. Tub PE100 RC Φ 50 mm PN 16 atm',

Sipas situacionit përfundimtar për këtë zë rezulton se është likuiduar volumi prej 3369 ml. Sipas librezës së masave pasqyrohet në mënyrë analitike volumi prej 924 ml linear për situacionin e parë dhe 2429 ml për situacionin e dytë (559 ml + 1867 ml), ose 3350 ml në total. Në fakt nga krahasimi i volumeve të situacionit përfundimtar dhe librezave të masave rezulton një diferencë me situacionim tepër në sasinë prej 19 ml. Duke bërë llogaritjet rezulton se është përfutur padrejtësisht vlara prej **20,900 lekë pa TVSH** (19 ml x 1,100 lekë/ml).

- Në lidhje me zërin 'Prova në tubin',

Sipas projekt-preventivit të hartuar nga ana e projektuesit rezulton se janë përfshirë në preventiv e njëkohësisht edhe në ofertën e paraqitur nga sipërmarrësi i punimeve BOE G.&L. zëri për kryerjen e provës së tubit. Në fakt, referuar kontratës së sipërmarrjes të lidhur mes palëve sipas aktit me nr. 3011 prot., datë 24.12.2021, neni 31 *Testimet dhe Inspektimet*, përcaktohet se: “Kontraktori duhet të bëjë të gjitha testet dhe inspektimet e kërkuara nga dispozitat e kontratës. Kosto e këtyre testeve dhe inspektimeve duhet të financohet tërësisht nga Kontraktori brenda çmimit të kontratës”. Për rrjedhojë rezulton se është përfutur tepër nga ana e sipërmarrësit të punimeve shuma **384,000 lekë pa TVSH** e likuiduar për kryerjen e testimit të tubacioneve.

Si përfundim, rezulton se janë përfutur tepër nga ana e sipërmarrësit të punimeve vlara 404,900 lekë pa TVSH e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e shoqërisë UK Durrës sh.a. dhe si e tillë duhet të zhdëmtohet nga ana e BOE “G. & L.” në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 54, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandimi: Nga ana e UK Durrës sh.a. të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **404,900 lekë pa TVSH** ndaj sipërmarrësit BOE G.&L. për punime të pakryera dhe/apo të kryera jo në përputhje me kërkesat e projektit por të likuiduara në kontratën e sipërmarrjes të lidhur sipas aktit me nr. 3011 prot., datë 24.12.2020 me objekt ‘Rikonstruksion i rrjetit të ujësjellësit Shkafane dhe Lagjet Muzhaq Kulls, nj. adm. Ishëm, Bashkia Durrës’.

Menjëherë

C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga Auditimi:

Në 63 raste të blerjeve emergjente, gjithsej në vlerën prej **3,180,666 lekë**, shoqëria ka përdorur procedurën e blerjeve shkresore kur blerjet nuk kanë qenë në kushtet e emergjencës, d.mth. në kushtet e ndodhjes të një ngjarje të rastit, ngjarje e cila nuk mund të parashikohej në fillim të vitit, për kë arsye këto shpenzime janë konsideruar pa efektivitet ekonomik.

Në vitin 2018, në 19 procedura emergjente, gjithsej në vlerën prej **508,621 lekë**.

Në vitin 2020, në 17 procedura emergjente, gjithsej në vlerën prej **902,043 lekë**.

-Në vitin 2021, në 16 procedura emergjente gjithsej në vlerën prej **1,186,082 lekë**.

Në vitin 2022, në 11 raste, Autoriteti Kontraktor ka përdorur procedurën e blerjeve shkresore në raste emergjente kur blerjet nuk kanë qenë në kushtet e emergjencës, në vlerën gjithsej prej **583,920 lekë**, dhe se këto shpenzime konsiderohen pa ekonomikitet.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 34, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1 Rekomandimi: Administratori i shoqërisë të analizojë situatën e krijuar dhe të përcaktojë shkallën e përgjegjësisë të personave përgjegjës. Gjithashtu, administratori duhet të sigurojë që të përfshijë në rregulloret apo manualet përkatëse klasifikimin e rasteve emergjente sipas natyrës së proceseve kryesore të aktivitetit të shoqërisë, me qëllim parandalimin e rasteve abuzive në shpenzimin e fondeve publike.

2. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me kontratën me objekt *‘Përmirësimi i furnizimit me ujë Lagia Nr. 1, Vadardhë, Njësia Administrative Sukth Bashkia Durrës’*, rezulton se në përfundim të procedurës së prokurimit, është shpallur fitues BOE K. & L. & S., të përfaqësuar këta nga OE K. me nr. licence për zbatim punimesh NZ. 4901/12 datë 07.04.2020 dhe me përfaqësues ligjor z. S. K. me të cilin është lidhur kontrata me Autoritetin Kontraktor e përfaqësuar nga z. K. B. me nr. 1520 prot., datë 10.08.2020 me vlerë 153,273,319.4 lekë me TVSh dhe me afat të zbatimit të punimeve 200 ditë kalendarike nga dita e nesërme e punës pas nënshkrimit të kontratës. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton Në lidhje me zërin ‘F.V derë metalike’.

Nga verifikimi në terren i punimeve rezultoi se dyert metalike të vendosura ishin të një cilësie shumë të dobët duke mos siguruar kështu një investim të qëndrueshëm e duke bërë që fondet e shpenzuara për këtë zë në masën prej **1,339,800 lekë pa TVSH** të konsiderohen si të përdorura pa efektivitet, efikasitet dhe ekonomikitet.

Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *“Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”*, i ndryshuar, Kreu II, neni 7, Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 *“Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”*, Kreu II, Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 *“Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”*, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3, Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve e lidhur sipas aktit nr. 1521 prot., datë 10.08.2020 si dhe Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve e lidhur sipas aktit nr. 1653/8 prot., datë 11.05.2021.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 72, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.2 Rekomandimi: Nga ana e UK Durrës sh.a. të merren masa për ngritjen e grupeve efektive në drejtim ndjekjes së kontratës, me qëllim shmangien e kryerjes së punimeve jo cilësore dhe/apo në kundërshtim me specifikimet teknike të kërkuara si dhe shmangien e përdorimit pa efektivitet, efikasitet dhe ekonomikitet të fondeve të shoqërisë.

Në vijimësi

3. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me kontratën me objekt *‘Ndërtimi i Ujësjellësit të Fshatrave Lalëz, Bizë, Draç dhe Shetë Njesia Administrative*

Ishëm - Bashkia Durrës, rezulton se në përfundim të procedurës së prokurimit, është shpallur fitues BOE K. & N., të përfaqësuar këta nga OE K. me nr. licence për zbatim punimesh NZ. 4901/10 datë 06.06.2019 dhe me përfaqësues ligjor z. S. K. me të cilin është lidhur kontrata me Autoritetin Kontraktor e përfaqësuar nga z. K. B. me nr. 1922 prot., datë 13.09.2019 me vlerë 172,471,458.4 lekë me TVSh dhe me afat të zbatimit të punimeve 21 javë nga dita e nesërme e punës pas nënshkrimit të kontratës. Nga auditimi i dosjes teknike të kontratës, konkretisht nga krahasimi i librezës së masave, situacionit përfundimtar, projektit të miratuar me ndryshime, etj. rezultoi se sipas dokumentacionit fotografik të ndodhur në dosjen teknike të zbatimit nuk dokumentohen në asnjë rast të vetëm kryerja e punimeve për transportin e materialit të gërmuar, mbushjes me rërë si dhe mbushjes me zhavorr për linjën e dërgimit si dhe linjave të shpërndarjes (shuma prej 8,464,526 lekë pa TVSH për linjën e dërgimit, shuma prej 6,378,512 lekë pa TVSH për linjën e shpërndarjes Lalëz dhe Bizë, shuma prej 4,533,929 lekë pa TVSH për linjën e shpërndarjes në Drac si dhe shuma prej 4,133,966 për linjën e shpërndarjes në Shete). Në total rezulton se vetëm për këta dy zëra nuk dokumentohen punime të kryera në vlerën totale prej **23,510,933 lekë pa TVSH**.

Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3 si dhe me kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes të lidhur sipas shkresës me nr. 1925 prot., datë 13.09.2019, kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve e lidhur sipas aktit nr. 720 prot., datë 10.04.2020 si dhe Urdhrin e Titullari të AK me nr. 1298/9 prot., datë 24.05.2019 për ndjekjen e kontratës.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 71, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.2 Rekomandimi: Nga ana e UK Durrës sh.a. të merren masa për ngritjen e një grupi pune me specialistë të fushës⁵³ me qëllim kryerjen e sondazheve përfaqësuese në terren për të verifikuar zbatueshmërinë e projekt – preventivit të kontratës, konkretisht zbatueshmërisë së zërave për transportin e materialit të gërmuar, mbushjes me rërë si dhe mbushjes me zhavorr për të cilat nuk konfirmohet kryerja e tyre në shumën prej **23,510,933 lekë pa TVSH**. Në rast të konstatimit të punimeve të pakryera nga ato të përfshira në situacionin përfundimtar, të kërkohet arkëtimi i dëmit përkatës.

Menjëherë

4. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me kontratën me objekt ‘Rikonstruksion i rrjetit të ujësjellësit Shkafane dhe Lagjet Muzhaq Kulls, nj. adm. Ishëm, Bashkia Durrës’, rezulton se në përfundim të procedurës së prokurimit, është shpallur fitues BOE G. & L., të përfaqësuar këta nga OE G. me nr. licence për zbatim punimesh NZ.7351/4 datë 15.06.2020 dhe me përfaqësues ligjor z. K. A. me të cilin është lidhur kontrata me Autoritetin Kontraktor e përfaqësuar nga z. K. B. me nr. 3011 prot., datë 24.12.2020 me vlerë 37,500,594.41 lekë me TVSh dhe me afat të zbatimit të punimeve 90 ditë kalendarike nga dita e nesërme e punës pas nënshkrimit të kontratës sipas grafikut të hartuar nga projektuesi.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se:

- Në lidhje me zërin ‘Shtresë stabilizanti $t=20\text{ cm}$ ’

Sipas situacionit përfundimtar rezulton volumni prej 4238.4 m² për lagjen Muzhaq dhe 1890.6 m² për Fshatin Shkafane. Libreza e masave pasqyron po të njëjtat volume të shprehura në mënyrë analitike. Në fakt referuar dokumentacionit fotografik të ndodhur në dosje nuk rezulton asnjë rast

⁵³ Jo punonjës të përfshirë në procesin e ndjekjes së kontratës.

i vetëm i përdorimit të këtij materiali përgjatë aksit të linjës së realizuar. Për rrjedhojë rezulton se nuk dokumentohen punime në shumën prej **2,758,050 lekë pa TVSH**.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 54, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.2 Rekomandimi: Nga ana e UK Durrës sh.a. të merren masa për ngritjen e një grupi pune me specialistë të fushës me qëllim kryerjen e sondazheve përfaqësuese në terren për të verifikuar zbatueshmërinë e projekt – preventivit të kontratës, konkretisht zbatueshmërisë së zërit *Shtresë stabilizanti t=20 cm*, për të cilin referuar dokumentacionit fotografik, nuk konfirmohet kryerja e tyre në shumën prej 2,758,050 lekë pa TVSH. Në rast të konstatimit të punimeve të pakryera nga ato të përfshira në situacionin përfundimtar, të kërkohet arkëtimi i dëmit përkatës.

Menjëherë

V. Lista e dokumentacionit të auditimit

1. Akt Konstatim nr.1, Datë 13.01.2023 “Mbi zbatimin e rekomandimeve”
2. Akt konstatim nr. 2, datë 13.01.2023 “Mbajtja e evidencës kontabile në qendër dhe në njësitë e vartësisë, respektimi i afateve për nxjerrjen dhe miratimin e bilancit nga organet drejtuese të shoqërisë, si dhe dërgimi dhe miratimi i tij në organet e vartësisë, analiza e debitorëve, kreditorëve, derdhja e detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore, etj. ndaj buxhetit të shtetit.”
3. Akt konstatim nr. 3 datë 13.01.2023 “Mbi hartimin, miratimin dhe realizimin e programit ekonomiko financiar të shoqërisë”.
4. Akt konstatim nr. 4 datë 13.01.2023 “Rregullshmëria e shpenzimeve me arkë, bankë dhe blerjet me vlera të vogla (shpenzimet administrative për automjetet, udhëtime e dieta brenda dhe jashtë vendit, sponsorizime etj.).
5. Akt konstatim nr. 5-113 datë 13.01.2023 “Mbi zbatimin e ligjshmërisë në prokurimet e fondeve publike dhe ankandet, lidhjen dhe zbatimin e kontratave”.

Shënim: Të gjithë punonjësit që atakohen në këtë Raport Përfundimtar auditimi duhet t’u bëhen prezent mangësitë dhe problemet për të cilat mbajnë përgjegjësi, mundësisht t’u jepen fotokopje të dokumentacionit që ka lidhje me ta, në mënyrë që të njihen dhe të bëjnë komentet dhe shpjegimet përkatëse, nëse kanë.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

VI. ANEKSE

Aneksi nr. 1.1 – Argumentim i shumës prej 6,394,479.6 lekë me TVSH.

Nr.	Zëri	Grafiku			Sit nr. 1		Diferenca në volum plan fakt	mimi	Vlera
		Sasia e preventivit	Volume/ 16 ditë	%	Volum/16 ditë	%			

1	Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , ne kanale gjerësi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet	4134.46	945	23%	2993	72%	2048	350	716,793.20
2	Gërmim kanalesh ne toke te forte, me krahe, me seksion deri 0.75 m ²	459	105	23%	335	73%	230	1,000	230,085.71
3	Transport dheu deri 5 km	2756.3	630	23%	732	27%	102	250	25,497.14
10	Prishje shtrese betoni	1	1	80%	3	300 %	2	3,500	7,700.00
11	Prerje asfalti	150	120	80%	90	60%	-30	200	
13	Shtrese Asfaltbetoni 4 cm	150	0	0%	0	0%	0	1,400	-
14	Shtrese binderi t = 6 cm	150	0	0%	0	0%	0	1,600	-
15	Shtrese stabilizant t=10cm	150	0	0%	0	0%	0	300	-
16	Shtrese stabilizanti t = 20 cm	2514.31	0	0%	2771	110 %	2771	450	1,246,950.00
17	Mbushje me material te germuar me pare	2756.3	630	23%	3323	121 %	2693	250	673,247.14
18	F.V. Tub PE100 RC Ø90 mm PN 20 atm	1960	448	23%	1985	101 %	1537	1,580	2,428,460.00
19	F.V. Tub PE100 RC Ø 75 mm PN 10 atm	1562	357	23%	1600	102 %	1243	1,550	1,926,605.71
20	F.V. Tub PE100 RC Ø 63 mm PN 10 atm	720	165	23%	110	15%	-55	1,300	
21	F.V. Tub PE100 RC Ø 50 mm PN 16 atm	2710	619	23%	924	34%	305	1,100	335,028.57
22	F.v Saraçineska tip shpindel (me aks vertikal) d = 50-80 mm Pn 20 at	2	0	0%	0	0%	0	35,000	-
23	Kalim me tub celiku D = 125 / 4.0 mm	85	0	0%	278	327 %	278	350	97,300.00
24	Beton M-200 per kalimet me tub çeliku	1	0	0%	0.6	60%	1	12,000	7,200.00
25	Prova ne tubin	48	0	0%	0	0%	0	4,000	-
26	Pastrim tubi	6	0	0%	0	0%	0	3,500	-
SHUMA									5,328,733

Aneksi nr. 1.2 – Dokumentacioni vërtetues i vlerës së punimeve në datës 22.01.2021

AKT KONTROLI NR. 2

1. Emri i subjektit të mbikqyrur: "G.A.C sh.p.k & "LALA" sh.p.k
2. Objekti: "Rikonstruksion i rrjetit të ujësjes së Shkafane dhe lagjet Muzhaq-Kullas, Njesia Adm. Ishem, Bashkia Durrës"
3. Vendndodhja: Njesia Adm. Ishem, Bashkia Durrës
4. Data/ ora: 22.01.2021
5. Objektivat: Progresi i Punës nga data e fillimit të punimeve
6. Pjesëmarrësit:
 - Mbikqyrësi i punimeve: "Drikons" sh.p.k
 - Drejtuesi teknik dhe i punimeve: Ing. Miklovan Alimadhi
7. Konstatimet:

Nr.	Pershkrimi i situatës	Zbatuar nga dt.	Data e kontrollit
1	Kontrolli për kryerjen e punimeve për zerat: Lagja MUZHAQ: - Prerje asfalti - Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m², në kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk në mjet - Germim dheu me krahe - F.V. Tub PE100 RC Ø90 mm PN 20 atm Në objekt është sjellë baza materiale sipas preventivit: a) janë sjellë makineritë për kryerjen e punimeve b) aparaturat e përdorura dhe siguria në objekt duhe të jenë në përputhje me ligjet shqiptare të sigurisë në vendin e punës. c) është bërë instruktimi i punonjësve për sigurinë në objekt për parandalimin e dëmtimit të punonjësve dhe materialeve.	13.01.2021	22.01.2021
2	Gjendja e deritanishme e punimeve: Janë kryer 10% e punimeve. Punimet vazhdojnë.	13.01.2021	22.01.2021

Realizimi i punimeve deri 22.01.2021

- Një kopje Autoriteti Kontraktor: Ujësjes Kanalizime Sh.a Durrës
- Një kopje Mbikqyrësi i punimeve: "Drikons" sh.p.k
- Një kopje kontraktuesi: "G.A.C sh.p.k & "LALA" sh.p.k

Mbikqyrësi i punimeve

"Drikons" sh.p.k

Administrator:
Vladimir Topi**Kontraktuesi Punimeve**

"G.A.C sh.p.k & "LALA" sh.p.k
Perfaqësuar nga: "G.A.C" SHPK
Administrator:
Klodian Aliushaj
Drejtuesi Teknik:
Ing. Miklovan Alimadhi

Autoriteti Kontraktor
Ujësjes Kanalizime Sh.a Durrës
Administrator:
Ing. Spartak Kovaci
Person i Autorizuar Z. Kasem Bejko